

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO



RAPORT

VJETOR

2022



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR

2022

I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Mars 2023

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	5
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
1.1 TË ARRITURAT KRYESORE.....	7
2. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	8
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	8
3.1 MISIONI DHE VIZIONI.....	8
3.1.1 MISIONI	8
3.1.2 VIZIONI.....	8
3.2 KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT	9
4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA.....	9
4.1 BORDI I DREJTORËVE	10
5. DEPARTAMENTI I SHITJES	13
6. NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT.....	14
6.1. NDËRMARRJET E PRIVATIZUARA ME SPIN OFF SPECIAL	14
6.2. ADMINISTRIMI DIREKT.....	14
6.3 NDËSHKIMET FINANCIARE	16
7. DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT	16
7.1 LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE	16
7.2 NJËSIA PËR TRANZICIONIN E TREPÇËS (NJTT)	17
8. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL	18
8.1. SHITJA E ASETVE	18
8.2. ADMINISTRIMI I ASETVE	18
8.3. KTHIMI I PRONAVE NË PRONËSI TË NSH-VE.....	19
8.4. IDENTIFIKIMI I ASETVE TË REJA	20
8.5. IDENTIFIKIMI I NDRYSHIMEVE TË GJENDJES NGA VIZITAT NË TEREN/NDËRMARRJA E VEPRIMEVE	20

8.6. PËRCAKTIMI STATUSIT TË NSH-ve	23
8.7. IDENTIFIKIMI I ASETVE TË MBETURA ME PROBLEME	23
8.8. MENAXHIMI I ASETVE TË MBETURA.....	23
8.9. QIRADHËNIA E ASETVE TË NSH-ve.....	24
8.10. PUNË TJERA	24
8.11. SFIDAT	25
9. DEPARTAMENTI LIGJOR	26
9.1 ARBITRAZHET	26
9.2 NJËSIA E OPINIONEVE LIGJORE DHE SHQYRTIMIT TË KONTRATAVE TË SHITJES	27
9.3 NJËSIA PËR PËRFAQËSIME LIGJORE	28
9.4 NJËSIA PËR TRAJTIMIN E ASETVE JASHTË VENDIT	28
9.5 NJËSIA E SHKRESAVE GJYQËSORE	29
10. DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT	30
11. DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE	32
12. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	33
13. DEPARTAMENTI I FINANCIVE DHE BUXHETIT	36
13.1 FINANCIMI I AKTIVITETEVE OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-së	36
13.2 PROCESI I FONDEVE NË MIRËBESIM – NDËRMARRJET SHOQËRORE	36
14. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT	37
15. DEPARTAMENTI I KOMISIONEVE PROFESIONALE	38
16. NJËSIA E NEGOCIMIT DIREKT (NJND)	38
17. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)	39
18. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	42
19. SHTOJCAT E RAPORTIT VJETOR TË AKP-së	43

FJALA HYRËSE E ZËVENDËS KRYESUESES SË BORDIT TË DREJTORËVE

Agjencia Kosovare e Privatizimit, si Agjenci e pavarur e themeluar nga Kuvendi i Kosovës, është një ndër institucionet më të rëndësishme të strukturës ekonomike në vend. Mandati i saj kryesor është që përmes transformimit të pronës shoqërore ta fuqizojë sektorin privat, si bartës kryesor i zhvillimit ekonomik. Në të njëjtën kohë Agjencia, si organ publik, bashkërendon zbatimin e mandatit të saj me institucionet tjera qendrore Republikës së Kosovës gjithmonë duke ruajtur pavarësinë e saj funksionale.

Agjencia gjatë vitit 2022 ka arritur që të administrojë dhe të ruajë asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore nën administrim sipas autorizimeve ligjore.

Agjencia gjatë vitit 2022 pas ndërveprimit me faktorët relevant sikurse janë Qeveria dhe Kuvendi, ka rifilluar shitjet e aseteve në likuidim përmes tenderit publik ku janë realizuar 7 valë të shitjeve dhe të hyrat nga shitja e aseteve në likuidim gjatë këtij viti kanë arritur në 5,209,848.00 €. Agjencia ka vazhduar qiradhëniet sipas ligjit në fuqi dhe gjatë këtij viti ka inkasuar gjithsej 4,842,279 € nga qiradhëniet e aseteve në pronësi shoqërore.

Disa të dhëna të tjera:

- Të hyrat nga shitja e aseteve (shitje në likuidim, banesa të NSH-ve, pagesa të shitjeve me negociim direkt nga vitet paraprake), janë 6,152,060.00 €;
- Pagesat ndaj kreditorëve të NSH-ve 15,070,985.00 €;
- Pagesa e 20% të punëtorëve transferuar në BSPK 6,673,827.00 €.

Ndër çështjet më të rëndësishme që janë trajtuar gjatë vitit janë: i) Futja e ndërmarrjes Inex Sharr Planina Brezovicë nën administrim direkt të AKP-së, ku është emëruar bordi i përkohshëm i ndërmarrjes dhe poashtu është emëruar drejtori menaxhues i ndërmarrjes në fjalë; dhe ii) Është bërë kthimi i aksioneve për Ndërmarrjen e Re Agrokosova Holding e cila pas ankesës së Blerësit gjendet në procedurë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Poashtu vlen të ceket se gjatë vitit 2022 është aprovuar Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKP, e cila është paraparë të hyjë në fuqi me datë 1 qershor 2023. Bordi i AKP-së ka aprovuar Rregulloren e re për pagat e zyrtarëve të Agjencisë me zbritje të pagave rreth 30%, por kjo zbritje ka hyrë në fuqi nga data 1 Janar 2023 pas përfundimit të procedurave ankimore të punonjësve.

Angazhimi në përmbushjen e objektivave ka rezultuar në realizimin e pjesshëm të planit të shitjes së aseteve në periudha mujore, pagesa nga shitjet me negociim direkt të viteve të kaluara, inkasimin e të hyrave nga qiratë mujore të aseteve të NSH-ve, shpërndarjen e mjeteve për kreditorët dhe shpërndarjen e 20% për punëtorët, vendosjen e ndërmarrjeve në likuidim dhe vendimet për bartje pronësore të aseteve të NSH-ve pas vendimeve përfundimtare për shpronësim nga institucionet relevante.

Agjencia ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet qendrore në funksion të strategjive të reja për zhvillim ekonomik siç janë themelimi i Fondit Sovran, lehtësimi i procedurave për marrjen me qira të aseteve nga investitorë të rëndësishëm, ofrimin e bashkëpunimit lidhur me shpronësimet dhe realizimin e interesit publik.

Agjencia falënderon të gjitha institucionet në nivelin qendror dhe lokal për bashkëpunimin dhe mbështetjen e dhënë në përmbushjen e objektivave të përbashkëta dhe shpreson që ky bashkëpunim të vazhdojë dhe të rritet edhe më shumë në të ardhmen me qëllim të realizimit të synimit të përbashkët, i cili është transformimi i pronës shoqërore me qëllim të zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Raporti që po ju paraqesim paraqet rezultatet e punës për vitin 2022. Si Agjenci jemi të përkushtuar të vazhdojmë angazhimin maksimal në përmbushjen e objektivave për përmbylljen e suksesshme të mandatit të Agjencisë në një periudhë optimale.

Sinqerisht,



Syzana Dautaj Surdulli
Zëvendës Kryesuese e Bordit të Drejtorëve,
Agjencia Kosovare e Privatizimit

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë raport është paraqitur një përmbledhje e shkurtër e punës së AKP-së për periudhën deri më 31 Dhjetor 2022. Raporti më i detajuar për punën e Bordit të Drejtorëve, departamenteve dhe njësive të AKP-së do të paraqitet në raportin vjetor që do të dorëzohet në Kuvendin e Kosovës. Çështjet financiare janë të prezantuara dhe shpalosura në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim dhe Të Hyrat e Dedikuara.

Në vijim janë paraqitur në pika të shkurtëra fushat e veçanta:

- Të arriturat kryesore;
- Administrimi dhe Shitja e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Pagesat për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (20%);
- Shpërndarja e mjeteve ndaj kreditorëve për Ndërmarrjet Shoqërore;
- Aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së;
- Përmbledhje lidhur me financat.

1.1 TË ARRITURAT KRYESORE

- Gjatë vitit 2022 janë realizuar 7 valë të shitjeve dhe të hyrat nga shitja e aseteve në likuidim është shuma prej **EUR 5,209,848.00**.
- Gjatë vitit 2021 kanë filluar procedurat e likuidimit dhe janë emëruar Autoritetet e Likuidimit për 5 Ndërmarrje Shoqërore gjegjësisht asete.
- Ndërmarrja e veprimeve nga AKP lidhur me aktivizimin e veprimtarisë së **NSH "Inex Sharr Planina"**.
- Gjatë vitit 2022 shuma e fondeve të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së për shpërndarje tek kreditorët e ligjshëm është **EUR 15,264,462**.

- Gjatë vitit 2022 janë shpallur gjithsej 10 lista fillestare për 20% e punëtorëve, 15 lista finale me përfitues gjithsej 8877 punëtorë. Bilanci i pagesave për shpërndarjen e 20% për vitin 2022 është shpërndarë gjithsej **EUR 6,673,827**.
- Gjatë vitit 2022 AKP ka arritur që në bazë të vendimeve të gjykatës të kthej pronat në emër NSH-ve, si rezultat AKP ka arritur të kthej **603,604 m²** tokë dhe **25 m²** lokal, në emër NSH-ve.
- Janë vënë nën administrim të AKP-së 13 asete të reja, që më herët nuk i kishim në regjistër të Agjencisë.
- Gjatë këtij viti janë dërguar në përmbarrim gjithsej 54 raste të qiramarrëseve që kanë qenë pagues të parregullt.
- Gjatë vitit 2022 janë procesuar gjithsej **18** Kërkesa për Asistencë të Policisë për lirim të aseteve nga uzurpatorët dhe qiramarrësit e parregullt.
- Dhe poashtu zyrtarët ligjor në zyret rajonale kanë ushtruar 30 padi në gjykatat komunale.
- Përgatitja e Fletëinformacioneve me të gjitha të dhënat në lidhje me 84 asetet me Vlerë më të theksuar.
- Përgatitja e Fletëinformacioneve me të gjitha të dhënat në lidhje tokat me hapësirë mbi 10 HA hapësirë kompakte ku gjithsej janë të përfshira 168 asete.
- Ndërmerrja e veprimeve ligjore si: kërkesa në urbanizëm, kërkesë në Inspektoriatin e ndërtimit dhe stacioneve policore. Në rastet kur janë zhvilluar punime atëherë AKP ka parashtruar kërkesa për masë të përkohshme dhe kthim në gjendje të mëparshme. Veç këtyre veprimeve janë ndërmarr edhe veprime tjera si kallëzime penale për uzurpime/ndërtime ilegale, kallëzime penale për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit

zyrtar për raste ku pa pasur bartje të pronave në pronësinë private për 25 raste.

- Në përputhje me Planin e Punës si dhe Strategjinë Përmbyllëse të AKP-së për periudhën janar 2022-dhjetor 2024, lidhur me realizimin e ristrukturimit të AKP-së, Drejtori Menaxhues i AKP-së ka themeluar grupin punues për harmonizimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKP. Kjo

rregullore pas përmbushjes së procedurave ligjore të pranimit të mendimit këshillmor nga organet përkatëse, është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve i AKP-së. Ky ristrukturim do të zbatohet në AKP nga data 1 qershor 2023.

Raportet financiare për të hyrat e realizuara nga shitja e aseteve, shpronësimet, qiraja dhe tarifatat për pjesëmarrje në tender, për vitin 2022 (si dhe krahasimet me vitet paraprake) janë paraqitur në detaje në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

2. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Rregulloret dhe procedurat e aprovuara dhe amadamentimet gjatë vitit 2022 nga AKP:

- Amandamenti i Rregullores së pagave, Rreg. 02/2021 - 29 Tetor 2021. E njëjta hynë ne fuqi me 01 Prill 2022;
- Rregullore nr. 01 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit dhe Procedurat e Shitjes – 28 Shkurt 2022;
- Strategjia për komunikim me publikun – 30 Mars 2022;
- Rregullore nr. 02 për përcaktim të kufinjve të NSH-ve – 28 Prill 2022;
- BD-166-53 Amadamentimi i Statutit të Bordit – 04 Korrik 2022;
- Rregullore nr. 03. për Rregullimin e Lëndës Arkivore, digjitalizimin dhe dorëzimin në Arkivin kompetent për Ndërmarrjet Shoqërore në Likuidim – 28 Korrik 2022;
- Plotësim/ndryshimi i Shtojcës: Metodologjia e Përcaktimit të Çmimit mesatar – pjesë e Procedurave të Shitjes (sipas pikave të veprimit të mbledhjes 28 korrik 2022) – 31 Gusht 2022;
- Rregullore nr. 04 për qiradhënien e aseteve të NSH-ve – 31 Gusht 2022;
- Rregullore nr. 05 për përgjegjësitë e Bordit të Përkohshëm dhe Drejtorit Menaxhues të NSH Inex Sharr Planina, Brezovicë – 31 Gusht 2022;
- Rregullore nr. 06-2022 për Shitjen Direkte të Aseteve të Caktuara të NSH-ve – 17 Tetor 2022.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1 MISIONI DHE VIZIONI

3.1.1 MISIONI

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore. Për realizimin e këtij misioni, Agjencia mban dhe

administron secilën ndërmarrje (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, si dhe shet ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin.

3.1.2 VIZIONI

Agjencia është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet pozitive për ekonominë si dhe

nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjera publike administrative që i ka mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa të panevojshme, në përputhje me Ligjin e AKP-së, aktet nënligjore të AKP-së dhe legjislacionin në fuqi.

3.2 KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me Ligjin nr. 04/L-034, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në Korrik të vitit 2008 si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 "Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit", dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit të Kosovës në baza vjetore. Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme

të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues, Zëvendës Drejtori Menaxhues-Shitje dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues-Likuidim.

Brenda Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë edhe departamentet dhe njësitë e veçanta si në vijim:

- Departamenti i Shitjes;
- Departamenti i Likuidimit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Burimeve Njerëzore;
- Departamenti i Administratës;
- Departamenti i Prokurimit;
- Departamenti i Komisioneve Profesionale;
- Njësia e Negocimit Direkt;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm; dhe
- Njësia e Monitorimit, Kontrollës dhe Administrimit Direkt.

4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA

Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) kanë funksionuar në sektorë të ndryshëm duke përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotelieri, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë.

NSH-të zënë rreth 90% të industrisë dhe minierave në Kosovës, 50% të hapësirës për shitje

komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe shumicën e pjesës malore të Kosovës.

Shumica e pronës industriale e Kosovës, toka bujqësore, pyje, tokë urbane komerciale dhe pronë komerciale janë pronë e NSH-së. Privatizimi i këtyre aseteve dhe tërheqja e investitorëve të huaj si dhe atyre nga diaspora, rajoni dhe Kosova

pritet që të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Aktualisht janë **599** Ndërmarrje/njësi punuese të cilat janë nën administrimin e Agjencisë dhe atë:

516 janë gjithsej Ndërmarrje Shoqërore, Trepçës* dhe Ndërmarrjeve të Reja prej; dhe

83 janë gjithsej asete/njësi punuese në Kosovë, ku selitë e NSH-ve janë jashtë Kosovës.

* azhurnuar pas miratimit të Statutit të Trepçës nga Kuvendi i Kosovës më 3 Shkurt 2019. NSH Trepça vendoset në likuidim si 1 (një) subjekt juridik, ndërsa numri i njësi punuese të Trepçës që kanë mbetur nën mandat të AKP-së është 9 (nëntë).

Këto 599 ndërmarrje kanë statusin e mëposhtëm:

Numri i Ndërmarrjeve/aseteve aktualisht nën administrimin e Agjencisë	595
Vendosur në likuidim	584
Numri i NSH-ve në likuidim të përmbyllura me vendim të Dhomes së Posaçme	(41)
Ende në proces të likuidimit	543
Kosovatransat dhe Ekonomitë Pyjore që nuk do të vendosen në likuidim	8
Nuk janë vendosur ende në likuidim*	17

4.1 BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetenca të plota për Agjencinë. Bordi i Drejtorëve i AKP-së takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit¹. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë duke përfshirë një anëtarë të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi është emëruar me datë 06 Gusht 2021. Mandati i Bordit të Drejtorëve është 4 (katër) vjeçar për të gjithë anëtarët e Bordit.

Gjatë vitit 2022, Bordi ka mbajtur 18 mbledhje (prej të cilave 6 mbledhje kanë qenë të jashtëzakonshme), ku janë marrë gjithsej 636 vendime formale dhe shumë udhëzime për veprim për Menaxhmentin. Në vijim, në mënyrë përmbledhëse janë të paraqitura aktivitetet e Bordit për këtë periudhë:

1. Janë aprovuar për shpallje shtatë (7) valët e privatizimit SHAL 55 deri SHAL 61. Rezultatet e këtyre valëve janë: aprovime të shitjeve nga Bordi: 52 asete, refuzime të shitjeve nga Bordi: 81 asete, nuk kanë pranuar asnjë ofertë: 79 asete.
2. Janë bërë shpërndarjet në likuidim për kreditorët e 52 Ndërmarrjeve Shoqërore;
3. Janë aprovuar 157 raporte të Komisionit për Shitjen e Banesave në Pronësi Shoqërore;
4. Është aprovuar bartja nga AKP te "Trepça" SH.A. për ato banesa, të cilat janë ndarë në shfrytëzim nga njësitë e Ndërmarrjes "Trepça" të cilat sipas Ligjit për Trepçën dhe sipas Statusit të ndërmarrjes publike "Trepça" SH.A. kanë kaluar në pronësi të ndërmarrjes Publike "Trepça" SH.A.;
5. Janë bërë shpërndarjet për ish-punëtorët e 15 Ndërmarrjeve Shoqërore nga 20% i shitjeve;
6. Janë aprovuar shumë qiradhënie të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
7. Është aprovuar fillimi i likuidimit për 3 ndërmarrje;
8. Janë aprovuar raportet për heqje dorë nga asetet për 79 asete;
9. Është aprovuar rritja e buxhetit të nevojshëm për finalizim të procedurave të likuidimit për 7 Ndërmarrje Shoqërore;
10. Janë aprovuar 4 raporte për përcaktimin e statusit të Ndërmarrjeve Shoqërore;
11. Janë paraqitur për njoftim 10 Raporte Përfundimtare për NSH-të/asetet në likuidim për tu dërguar në DhPGJ-së për përmbyllje të ndërmarrjes/asetit;
12. Është emëruar Bordi i Përkohshëm i Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina

¹ Përbërja, procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve janë të paraqitura në nenet 12, 13, 14 dhe 15 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi

Agjencinë Kosovare të Privatizimit (të ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 04/L-115).

Brezovicë dhe poashtu Drejtori Menaxhues i ndërmarrjes në fjalë;

13. Janë marr dy (2) vendime me 31 janar 2022 për tërheqjen e aksioneve dhe vendosjen e ndërmarrjes Agrokosova nën Administrim Direkt të AKP-së në përputhje të plotë me ligjin dhe bazuar në 5 (pesë) auditimet e jashtme të pavarura, të cilat auditime kanë vërtetuar përtej çdo dyshimi se brenda tërë periudhës sa ka zgjatë afati për përmbushjen e zotimeve për investime dhe punësime nga viti 2007 deri prill 2017, ish blerësi nuk i ka përmbushur zotimet sipas kontratës së shitblerjes së kësaj ndërmarrje. Investimet e zotuar janë përmbushur 85.6%, ndërsa punësimet e zotuar janë realizuar vetëm 24.5%. Me tërheqjen e aksioneve të kësaj ndërmarrjeje, AKP e ka mbrojtur interesin publik të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për më tepër, përveç shkeljeve të kontratës të cilat janë konstatuar me anë të raporteve të jashtme të auditimit, pas vendosjes nën administrim direkt të AKP-së dhe pas verifikimit të dokumentacioneve, është vërtetuar se ish-blerësi ka bërë shkelje tjera shumë serioze të kontratës për shkak se ka dhënë me qira hapësira të tokës mbi 500 hektarë, në periudha deri njëzet (20) vjet palëve tjera private pa lejen e AKP-së. Sipas kontratës së shitjes, asnjë prej asetëve të ndërmarrjes nuk mund të jepet me qira pa lejen e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, përderisa kontrata ka qenë nën monitorim të AKP-së. Më 24 maj 2022, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka pranuar Aktvendimin nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në të cilën cilën me shumicë votash është vendosur masë e përkohshme ndaj vendimit të Bordit të AKP-së për tërheqjen e aksioneve dhe vendosjen e Ndërmarrjes së Re Agrosova nën Administrim Direkt të AKP-së deri në vendimin përfundimtar të shqyrtimit të padisë së ish-blerësit të Agrokosovës;
14. Është aprovuar propozimi i Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxhmentit të AKP-së që të anulohen veprimet të ndërmarrja, të bëhet lirimi nga njerëzit dhe gjësendet, dorëzim-pranimi dhe fshirja e asetit nga lista/evidenca e asetëve/pronave nën mandatin e AKP-së apo largimi i autorizimeve administrative dhe kompetencave të AKP-së mbi asetin/pronën

pronën respektivisht ngastrat nr. 5913/1 dhe 5913/2 si dhe objektin e Kino Rinia 1 në lagjen "Qafa" të NSH "Genci" Prishtinë - PRN066 në Prishtinë dhe është bërë dorëzim-pranimi i pronës nga Komuna e Prishtinës;

15. Janë aprovuar nëntë (9) transferet pronësore për institucionet e ndryshme sikurse në vijim:

- 15.1 Transferimi i pronës në emër të Komunës së Prishtinës, në përputhje me Vendimin Përfundimtar të Qeverisë së Kosovës për shpronësim me numër 15-62, të datës 28 gusht 2018, me detajet e pronave të paluajtshme:

- a) Ndërtesa "Shtëpia e re e Mallrave"- NSH Gërmia (PRN093); dhe

- b) Një pjese e tokës së NSH Silloga (PRN192) përkatësisht ngastrës kadastrale nr. 5998-3, me sipërfaqe të shpronësuar prej 170 m² (pjesa e mbetur e pa shpronësuar është 1,767 m²).

- 15.2 Transferimi i pronës në emër të Komunës së Prishtinës, në përputhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 03/130 të datës 16 qershor 2010, vendimin e Kuvendit të Kosovës nr. 03-V-360 për shpalljen e pronës së IMN Kosova si Zonë e Interesit të Veçantë si dhe Vendimin Përfundimtar të Qeverisë së Kosovës për shpronësim nr. 07/34 të datës 07 tetor 2020, me detajet e pronës së paluajtshme:

- a) ngastrat kadastrale 3114-1, 3115-0, 3116-0, 3117-0, 3118-0, 3119-0, 3120-0, 3121-0, 3122-0, 3123-0, 3124-0 dhe 3125-2, Zona Kadastrale në Prishtinë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 90,736 m² në pronësi të NSH IMN Prishtinë (PRN029).

- 15.3 Transferimi i pronës me detajet e pronës: Prona e paluajtshme nr. 9013-2 ZK Prizren NSH Ndërmarrja e Pyjeve (PRZ023), Prizren në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për ndërtimin e Objektivit të ri të Gjykatës Themelore në Prizren në përputhje me

- Vendimin Përfundimtar për Shpronësim nr. 20/67, të datës 09.03.2022;
- 15.4 Transferimi i pronës me detajet e pronës: Prona e paluajtshme parcelat (tokat dhe objekti) nr. 608-1 dhe nr. 610-1 ZK Mitrovicë e NSH Jugobanka (MIT101), Mitrovicë në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për nevoja të Gjykatës Themelore në Mitrovicë në përputhje me Vendimin Përfundimtar për Shpronësim nr. 20/67, të datës 09.03.2022;
- 15.5 Transferimi i pronës me detajet e pronës: Prona e paluajtshme parcela nr. 7495-2 ZK Prishtinë e NSH Jugopetrol (PRN170), Prishtinë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në përputhje me Vendimin Përfundimtar për Shpronësim nr. 09/29, të datës 03 Gusht 2011;
- 15.6 Transferimi i pronave në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në përputhje me Vendimin Përfundimtar për Shpronësim nr. 08/189, të datës 23 Maj 2014, me detajet e pronave të paluajtshme:
- a) Objektet me numër të pronës 6191-2, së NSH “Pallati i Mediave” – Rilindja; dhe
 - b) Tokë me numër të pronës 7161-2, së NSH “Drithnaja” Prishtinë (PRN090).
- 15.7 Transferimi i pronës me detajet e pronës së paluajtshme: Objekti Afarist - Përdhesë ish-Barnatorja e Qytetit Prishtinë (Numri i pronës 5798-0), Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në përputhje me Vendimin Përfundimtar për Shpronësim nr. 14/68, të datës 09 tetor 2018.
- 15.8 Transferimi i pronave në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në përputhje me Vendimin Përfundimtar për Shpronësim nr. 06/104, të datës 10 Gusht 2016, me detajet e pronave të paluajtshme:
- a) Toka me numër të pronës 6035-0 pronë e NSH “Banka e Lubjanës” (PRN133); dhe
 - b) Objekti/Ndërtesa me numra të pronave 293-1 dhe 293-2 bashkëpronësi e NSH “Banka e Lubjanës” (PRN133) dhe NSH “Metal Holding” (PRN044), Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë.
- 15.9 Transferimi i pronës me detajet e pronës: Prona e paluajtshme parcela nr. 501-34 me sipërfaqe prej 2,263 m2, ZK Malishevë e NSH OPB Mirusha (PRZ008), Malishevë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në përputhje me Vendimin Përfundimtar për Shpronësim nr. 16/89, të datës 20 Korrik 2022.
16. Është aprovuar plani i punës dhe performancës për vitin 2023 dhe buxheti për vitin 2023 si dhe raporte tjera që u përcillen institucioneve qendrore sipas ligjit në fuqi;
17. Është finalizuar procedura e rekrutimit të Drejtorit Menaxhues (DM) dhe z. Arben Limani është emëruar në atë pozitë;
18. Komiteti i Auditimit ka vazhduar punën e tij dhe Komisioni i Vlerësimit të Performancës ka rifilluar punën në mars 2022 pas pezullimit disa muajsh;
19. Është aprovuar Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKP, ku riorganizimi i Agjencisë dhe Rregullorja hyn në fuqi me datë 1 qershor 2023.
20. Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2022 ka mbajtur 4 takime formale dhe 3 të tjera joformale, ndërsa Komisioni për Vlerësim të Performancës së Menaxhmentit gjatë vitit 2022 ka mbajtur 7 takime.

5. DEPARTAMENTI I SHITJES

Një ndër objektivat kryesore të AKP-së është ruajtja dhe rritja e vlerës të aseteve të NSh-ve.. Pra strategjia është sfiduese e cila kërkon ruajtjen e balancit mes shitjes dhe vlerës sa më të mirë e cila kryesisht varet nga faktorët e jashtëm dhe situatat e mëposhtme:

- **Fuqia blerëse** – absorbimin e ofertave kundrejt vëllimit të shitjeve;
- **Menaxhimin efikas dhe efektiv të aseteve** – p.sh. afatet kohore të marrëveshjeve të qirave dhe vënia në dispozicion për shitje tek blerësit;
- Koordinim me institucionet relevante të tilla si: objektet e shfrytëzuara nga institucionet, ngritjen e kapaciteteve në Dhomën e Posaçme

të Gjykatës Supreme, komunitat, bashkëpunimi me ATK-në rreth barrës tatimore etj.;

- Trajtimin e ndërtimeve ilegale të aseteve të NSh-ve; dhe
- Kompletimin e dokumentacionit (regjistrave kadastral).

Në pjesën e parë të vitit 2022 është bërë përgatitja e Rregullave të reja të Tenderit si dhe Procedurave të Shitjes, e të cilat dokumente e rregullojnë në tërësi procesin e shitjeve përmes tenderit publik. Gjatë vitit 2022 janë mbajtur gjithsej 7 shitje të aseteve në likuidim përmes tenderit publik, sipas planit vjetor të punës për vitin 2022 dhe objektive të parapara me Strategjinë Përmbyllëse të AKP-së për periudhën janar 2022-dhjetor 2024.

Shitja përmes Likuidimit	Nr. i Aseteve	Nr. i Ofertave të Pranuara	Gjithsej Vlera e Ofertave Fituese	Tërheqjet, Anulimet	Gjithsej Vlera	Nr. i Aseteve të anuluar nga BiD, tërheqjet	Kontratat e realizuara	Shitjet e përealizuara – në proces
SHAL 55	35	135	3,317,710	1,203,131	2,114,579	14	16	01 ¹
SHAL 56	15	25	618,367	111,745	506,622	05	04	01 ²
SHAL 57	27	54	907,620	401,384	506,236	05	05	02 ³
SHAL 58	39	82	1,414,754	670,395	744,359	15	09	02 ⁴
SHAL 59	31	36	969,696	414,053	555,643	09	04	03 ⁵
SHAL 60	36	52	586,678	459,269	127,409	16	01	03 ⁶
SHAL 61	31	46	1,727,208	1,072,208	655,000	17	00	01 ⁷
Totali: 07	214	430	9,542,033	4,332,185	5,209,848	81	39	13

¹ Njësia 38 në SHAL 55: “Jugoplastika Shitorja Ferizaj” dështim në pagesa, konfiskim depoziti.

² Njësia 11 në SHAL 56: “NSH “Sharrprodhimi” - Shitorja në fshatin Baçkë, Dragash” dështim në pagesa, konfiskim depoziti.

³ Njësia 21 në SHAL 57: “Investbanka Lokali në Mitrovicë” Masë e Përkohshme Ndalese nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme. Njësia 32 në SHAL 57: “NSH Zhupa Reçane - Prona në Reçan” ofertuesi më i lartë nuk e ka kaluar verifikimin e historikut për shkak të kontestit në Gjykatë me AKP-në.

⁴ Njësia 14 në SHAL 58: “Inkol Lokali në Mitrovicën Veriore” dështim në pagesa, konfiskim depoziti. Njësia 32 në SHAL 58: “NSH Zhupa Reçane-Prona në Lubinje e Epërme 1” është pezulluar vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së për shkak të kërkesës së komunës së Prizrenit.

⁵ Njësia 03, 07 dhe 25 në SHAL 59 afatin e pagesave e kanë deri më 12 janar 2023.

⁶ Njësia 01, 03 dhe 04 në SHAL 60 afatin e pagesave e kanë me 13 shkurt 2023.

⁷ Njësia 07 në SHAL 61 afatin e pagesave e ka deri më 16 mars 2023.

6. NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT

NJMKAD merret me administrimin e ndërmarrjeve të cilat kanë vështirësi financiare dhe biznese, prandaj me qëllim të rritjes së kontrollit dhe efikasitetit të këto ndërmarrje Bordi i Drejtorëve i AKP-së ka vendosur për futjen e këtyre ndërmarrjeve në Administrim Direkt. Njësia për Monitorim, Kontroll dhe Administrim Direkt gjatë vitit 2022 gjithashtu ka pasur për detyrë që për ndërmarrjet që nuk janë liruar nga marrëveshja e zotimeve t'i monitorojë si dhe të raportojë për gjendjen në këto ndërmarrje. Tani në monitorim nuk ka asnjë ndërmarrje, kurse në Administrim Direkt janë 5 ndërmarrje.

Të hyrat e përgjithshme vjetore për vitin 2022 të kalkuluara nga faturimet, që iu janë bërë qiramarrësve të aseteve nën Administrim Direkt janë në vlerën prej 513,477.06 Euro.

6.1. NDËRMARRJET E PRIVATIZUARA ME SPIN OFF SPECIAL

Ndërmarrja e Re "Agrokosova Holding" Suharekë

Ndërmarrjes së Re "Agrokosova Holding" i janë tërhequr aksionet me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e 31 janarit 2022 për shkak të mos përmbushjes së marrëveshjes së zotimeve.

Pas marrjes së aksioneve, ndërmarrja është vendosur në Administrim Direkt të AKP-së dhe është zgjedhur Bordi i Përkohshëm Menaxhues dhe Drejtori Menaxhues si dhe janë punësuar punëtorët bazuar në kërkesat e paraqitura nga Bordi dhe menaxhmenti i ndërmarrjes.

Gjatë periudhës së menaxhimit të ndërmarrjes nga AKP janë zhvilluar një numër i madh aktivitetesh që janë ndërlidhur me mbrojtjen e verës e cila ka qenë në rezervar si dhe aktivitetet që janë ndërlidhur me kultivimin dhe mbrojtjen e kulturave të vreshtave dhe kulturave tjera pemëtarë dhe bimore.

Blerësi ka bërë ankesë/padi në vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së në DHPGJS dhe ka kërkuar vendosjen e masës së sigurisë ku në shkallë të parë i është refuzuar ankesa, pas kësaj blerësi ka bërë ankesë në shkallën tjetër dhe ku nga shkalla

e dytë e DHPGJS është aprovuar masa e sigurisë për këtë ndërmarrje sipas të cilës masë deri në vendimin përfundimtar kjo ndërmarrje do të menaxhohet nga blerësit.

Nga momenti i vendosjes së masës së sigurisë në maj të vitit 2022 ndërmarrja më nuk administrohet dhe monitorohet nga AKP-ja.

6.2. ADMINISTRIMI DIREKT

NSH "Jatex" Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt.

Aktualisht ndërmarrja nuk është duke operuar me aktivitetin e saj primar, për shkak të gjendjes së vështirë financiare. Ndërmarrja realizon të hyrat nga dhënia e aseteve me qira. Aktualisht, Ndërmarrja ka 34 kontrata të qirasë dhe të hyrat neto mujore nga qiraja janë në vlerë prej EUR 20,976.34. Numri i punëtorëve aktiv në Ndërmarrje janë pesëmbëdhjetë (15), të cilët paguhën nga të hyrat të cilat Ndërmarrja i realizon nga dhënia e aseteve me qira.

NSH "Metaliku" Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt pasi që deri në futjen e ndërmarrjes në Administrim Direkt, Ndërmarrja nuk ka pasur asnjë të hyrë të realizuar nga qiraja apo ndonjë aktivitet tjetër.

AKP me kërkesë të Bordit të Përkohshëm Menaxhues të NSH-së dhe me qëllim të rritjes së të hyrave të ndërmarrjes gjatë vitit 2022 ka lëshuar 22 asete me qira ku vlera mujore e qirave ka qenë 11,229.48€. Në ndërmarrje janë të angazhuar 6 punëtor prej të cilëve dy janë në Bord të Përkohshëm Menaxhues dhe 4 në ruajtjen e objekteve të ndërmarrjes.

NSH “Fabrika e Enëve” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Ndërmarrja deri në futjen në Administrim Direkt nuk ka realizuar asnjë të hyrë dhe nuk ka pasur asnjë të punësuar.

Ndërmarrja ka një aset të lëshuar me qira. Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur në korrik ka marr vendim për lidhjen e kontratës së re me qiramarrësin Viva Fresh shpk, dhe realizon shumën prej 14,846.71€ nga qiraja mujore. Përveç qirasë mujore, qiramarrësi ka dorëzuar edhe garancionin bankar si masë sigurie në vlerë prej 186,522.00 Euro.

Qiramarrësi përveç qirasë mujore duhet të paguaj edhe borxhet që ka lidhur me kontratën bazë dhe deri më tani qiramarrësi është duke paguar çdo muaj nga një qira mujore dhe një pjesë të borxhit të mbetur.

Në ndërmarrje janë të punësuar dy ofrues të shërbimeve si roje, një arkiviste dhe një koordinator.

NSH “Iliria” Pejë

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30/31 mars 2017 ka marrë vendim për vendosjen e NSH “Iliria” në Administrim Direkt të AKP-së.

Ndërmarrja gjatë vitit 2022 ka pasur të lëshuara me qira dy asete. Aseti në Obiliq me qira mujore prej 100.00€ si dhe zyrat e ndërmarrjes në Pejë me qira mujore prej 287.00€. Për këtë aset gjatë vitit 2022 qiramarrësi ka qenë i obliguar që përpos qirasë mujore prej 287.00€ të paguaj edhe tri qira të mbetura nga vitet paraprake që gjithsej për periudhën një vjeçare çdo muaj duhet të paguaj nga 1148.00€. Deri më tani qiramarrësi ka bërë pagesën për 11 muaj.

Në ndërmarrje si punëtor është i angazhuar vetëm koordinatori.

Ndërmarrja Shoqërore “Inex Sharr Planina”

Ndërmarrja Shoqërore “Inex Sharr Planina” me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së numër BD-144-13, të datës 22.12.2020 është futur në Administrim Direkt të AKP-së. Lidhur me vendimin e Bordit të Drejtoreve të AKP-së, Agjencia Kosovare e Privatizimit më 6 janar 2021 ka njoftuar Komunën e Shtërpçës, Administratën Tatimore të Kosovës, Sindikatën e Punëtorëve të NSH “Inex Sharr Planina Brezovicë”, dhe ish Menaxhmentin e Ndërmarrjes, ku nga Sindikata dhe Menaxhmenti ka kërkuar bashkëpunim me AKP-në por që ky bashkëpunim deri në fillim të vitit 2022 ka munguar.

Me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së më 13 janar 2022 është emëruar Bordi i Ri i Ndërmarrjes prej 6 anëtarëve dhe 119 punëtorë të ndërmarrjes kanë nënshkruar kontratat e punës dhe ndërmarrja ka filluar të zhvilloj aktivitetin në Qendrën e Skijimit në Brezovicë dhe të krijoj të hyra nga shfrytëzimi i teleferikut, nga mysafirët në Hotel Molika si dhe nga qiratë.

Të hyrat kryesore ndërmarrja i ka realizuar gjatë sezonit dimëror janar/mars 2022, pastaj nga lëshimi i sallës të Hoteli Narcis për mbajtje të dasmave dhe ahengjeve gjatë sezonit të verës si dhe nga lëshimi i aseteve me qira kryesisht në qendrën turistike në Brezovicë.

Momentalisht ndërmarrja ka 15 asetet të lëshuara me qira me vlerë mujore prej 5,760.53€ nga qiratë.

Për shkak të numrit të madh të punëtorëve ndërmarrja nuk ka arritur që nga të hyrat e tyre të paguaj pagat e punëtorëve dhe një pjesë të shpenzimeve tjera operative, prandaj i janë huazuar mjetet nga tarifa administrative për ti mbuluar këto shpenzime dhe të cilat mjete do të kthehen kur ndërmarrja të krijoj të hyra vetanake që mbulojnë shpenzimet operative.

Me qëllim të përgatitjes më të mirë për sezonin dimëror janë bërë një numër riparimesh si në incizimin dhe përmirësimet e teleferikut me qëllim të rritjes së sigurisë për shfrytëzuesit e tij, pastaj është vendosur sistemi elektronik i pagesave që mundëson një kontroll më të mirë të

hyrave të ndërmarrjes, janë bërë blerjet e nevojshme të derivateve dhe vajrave që shfrytëzohen për makinerinë e ndërmarrjes, janë duke u riparuar makinat për trasimin e borës në mënyrë që të jenë funksionale në tërësi gjatë sezonit.

Për shkak të kushteve klimatike, mungesës së borës, edhe pse parashikimet kanë qenë që sezoni turistik të fillon më 15 dhjetor 2022 ajo nuk ka mundur të filloj me kohë e cila gjë do të ketë ndikim edhe në të hyrat që do të krijoj ndërmarrja gjatë sezonit dimëror.

6.3 NDËSHKIMET FINANCIARE

Gjatë vitit 2022 nuk janë aplikuar ndëshkime financiare por janë duke u zhvilluar procedura përmbartimore nga Departamenti Ligjor për të shikuar mundësinë e inkasimit të tyre.

Më poshtë paraqesim tabelën e ndëshkimeve financiare.

Ndërmarrja	Vlera e ndëshkimeve deri më 31 dhjetor 2021
Ndërmarrja e Re "Grand Hotel"	8,822,314.97
Ndërmarrja e Re "Xim Strezoc"	7,298,170.76
Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"	8,447,812.27
Ndërmarrja e Re "Agrokosova Holding"	3,579,997.53
Ndërmarrja e Re "Famipa"	1,170,000.00
Totali i ndëshkimeve financiare	29,318,295.53

Për ndërmarrjet të cilave u janë tërheq aksionet siç janë: "Grand Hotel" Prishtinë; "Mim" Golesh dhe "Xim" Strezoc si dhe për ndërmarrjen "Famipa" nga Departamenti ligjor janë duke u ndërmarr hapat për inkasimin e tyre, kurse për Ndërmarrjen e Re "AgroKosova Holding" rasti është në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Lidhur me Ndërmarrjen e Re "Sharrcem" Hani i Elezit, rasti ka qenë në arbitrazh nga janari 2019, pasi që Blerësi nuk është pajtuar me vlerën e ndëshkimeve të aplikuara dhe në fillim të vitit 2022 kemi pranuar vendimin e arbitrazhit ku pranohet ankesa e blerësit kundër ndëshkimeve të aplikuara.

7. DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT

7.1 LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Gjatë vitit 2022 kanë filluar procedurat e likuidimit dhe janë emëruar Autoritetet e Likuidimit për 5 Ndërmarrje Shoqërore gjegjësisht asete. Sipas procedurave të parapara me Ligj dhe konform Aktvendimit të DHPGJSK-së janë bërë publikimet e njoftimeve për kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjeve në RTK1 dhe RTK2 si dhe në tri portale online në Republikën e Kosovës, sepse si rezultat i pandemisë globale Covid 19, gazetatat nuk janë shtypur prej muajit mars 2020. Brenda afatit të paraparë ligjor për parashtrimin e kërkesave për këto ndërmarrje deri më 31 dhjetor 2022 janë pranuar 4 kërkesa kreditore në Zyrat Rajonale përkatëse të AKP-së.

Në total, nga fillimi i tërë procesit deri në datën e raportimit janë gjithsej 584 Ndërmarrje Shoqërore për të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit. Këto Ndërmarrje Shoqërore në likuidim janë administruar nga Autoritetet e Likuidimit (OSHP me AKP-në) për NSH-të të cilat kanë asete sipas shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 - Ofruesin e Shërbimeve Profesionale. Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar implementimi i kontratës ndërmjet AKP-së dhe OSHP-së (Curtis, Mallet-Prevost, Colt&Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton LLC), e cila ka filluar me 1 korrik 2019.

Në muajin qershor 2019 ndërmjet AKP-së dhe OSHP-së (Curtis, Mallet-Prevost, Colt&Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton LLC) është nënshkruar kontrata për likuidimin e

Ndërmarrjeve Shoqërore/aseteve nën administrimin e AKP-së, e njëjta ka filluar me datë 1 korrik 2019 me kohëzgjatje deri me 30 qershor 2024. Si rezultat i nënshkrimit të kontratës së lartpërmenduar janë emëruar Autoritetet e Likuidimit nga personeli i OSHP-së dhe AKP-së, për të gjitha NSH-të në likuidim dhe që janë nën

kompetencën e OSHP-së. Gjatë vitit 2022 janë realizuar pagesa në vlerë 429,900 euro për OSHP-në sipas kontratës për ofrimin e shërbimeve profesionale.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë përmbledhëse disa nga aktivitetet e likuidimit:

PËRSHKRIMI	JANAR-DHJETOR 2022	TËRË PROCESI 31 dhjetor 2022
Numri i NSH-ve në likuidim	5	584
Numri i kërkesave të parashtruara të kreditorëve	4	94,643
Numri i kërkesave të shqyrtuara	1,192	92,421
Numri i NSH-ve të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK)	4	41
Numri i raporteve të shpërndarjes së përkohshme, të shpërndarjes përfundimtare apo raporte përfundimtare të aprovuara nga Bordi	49	299
Shuma e fondeve të aprovuara nga Bordi i Agjencisë për shpërndarje tek kreditorët e ligjshëm	€ 15,264,463	€ 59,967,695

Nga numri prej 94,643 të kërkesave kreditore, deri në datën e raportimit për 92,418 janë lëshuar vendimet për parashtruesit e kërkesave kreditore nga Autoritetet e Likuidimit.

Janë gjithsej 9 raporte përfundimtare për lejimin e përmbylljes së procesit të likuidimit të dorëzuara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) për shqyrtim, prej të cilave për periudhën raportuese janar-dhjetor 2022 janë 7 raporte përfundimtare, për të cilat pritet vendim nga DHPGJSK.

Sa i përket, realizueshmërisë së objektivave të AKP-së të parapara me Plan të Punës 2022 dhe Strategji Përmbyllëse të AKP-së, lidhur me çështjet që ndërlidhen me likuidim, në vijim është paraqitur një përmbledhje e këtyre të dhënave deri në dhjetor 2022:

- Nga numri prej 584 NSH që janë në likuidim kanë mbetur edhe 17 NSH që ende nuk janë vendosur në procedurë të likuidimit. Rrjedhimisht, kanë mbetur 3% e NSH-ve që ende nuk janë vendosur në procedurë të likuidimit.
- Janë shqyrtuar 67% e kërkesave kreditore të mbetura të trashëguara ende të pavendosura.

Kanë mbetur edhe 23% e kërkesave kreditore për shqyrtim.

- Nga gjithsej 584 NSH që janë në likuidim deri në dhjetor 2022 janë dorëzuar 298 raporte të shpërndarjes për kreditorët për 274 NSH apo 47% e NSH-ve.
- Nga gjithsej 191 parcela/asete në shqyrtim për heqje dorë në procesin e likuidimit deri në dhjetor 2022 janë dorëzuar në DHPGJSK 81 raporte me gjithsej 96 parcela për heqje dorë apo 50%.
- Nga gjithsej 584 NSH që janë në likuidim deri në dhjetor 2022 janë dorëzuar në DHPGJSK 51 raporte për mbylljen e NSH-ve (8.7%), ndërsa janë përmbyllur 42 NSH (7.2%).

7.2 NJËSIA PËR TRANZICIONIN E TREPÇËS (NJTT)

Gjatë vitit 2022, NJTT ka administruar me çështjet rreth kërkesave të ndryshme të njërive joesenciale të Trepçës. NJTT ka kryer punë tranzitore, duke bartur edhe asete të njërive esenciale të Trepçës, të administruara në të kaluarën nga AKP-ja. Kështu, pas vendimit të BiD të AKP-së, për bartjen e kërkesave për blerjen e banesave nga njësitë ish NSH Trepça, që me ligj

dhe statut janë bartur tek N.P. Trepça ShA, Njësia e Trepçës së bashku me Njësine për Banesa në AKP, ka organizuar dhe koordinuar procesin e tërheqjes së këtyre lëndëve nga Njësia për Banesa AKP, tek Njësia analoge e Trepça ShA. Procesi i pranim dorëzimit të lëndëve është realizuar me sukses me datë 22/07/2022.

Në prill 2022, Komisioni për Ekonomi i Kuvendit të Kosovës ka ftuar AKP-në në takim për të raportuar për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Trepçës, dhe përgjegjësi që ka pasur dhe ka AKP-ja për asetet e Trepçës. Takimi me Komision, u mbajt me 22/04, në të cilin takim, AKP-ja u përfaqësua nga Kryesuesi i NjTT. Pas takimit, AKP-ja pranoi pyetje me shkrim, përgjigjet e së cilave u draftuan nga Kryesuesi i Njësise së Trepçës, dhe pas miratimit nga Menaxhmenti, iu dorëzuan Komisionit brenda afatit.

NjTT gjatë vitit 2022 ka asistuar Departamentin Ligjor në përfaqësimin gjyqësor për rastet e adresuara drejt njësive të Trepçës që administrohen nga AKP-ja, bazuar në Ligjin e Trepçës. NjTT është përgjigjur në kërkesa për informata nga parashtruesit e kërkesave kreditore të afateve ligjore të kaluara në rastin e Trepçës, si dhe ka plotësuar dhe përditësuar dokumentacion për procesin që pritet të ndodh edhe për ndërmarrjet tjera të Trepçës, pas shpalljes së inicimit të procesit të likuidimit.

Edhe gjatë vitit 2022, NjTT ka propozuar të shqyrtohet kërkesa e NjTT për të hyrë në agjendë të mbledhjes së Bordit, çështja e inicimit të procesit të Likuidimit, si dhe çështja e fillimit të shqyrtimit të kërkesave kreditore kundër Trepçës.

8. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL

Departamenti i Koordinimit Rajonal bën mbikëqyrjen dhe Koordinimin e punës së Zyrrave Rajonale të AKP-së. AKP-ja ka pesë Zyrra Rajonale (ZR) në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiçan dhe Mitrovicë që përfshijnë të gjithë territorin e Kosovës dhe zyrën satelitore në Shtëpiçë, të cilat përgjegjësi kryesore kanë grumbullimin e informative lidhur me NSh-të në rajonet përkatëse si dhe implementimin e privatizimit, likuidimit dhe aktivitetet e qeverisjes korporative.

8.1. SHITJA E ASETEVE

Zyrrat Rajonale kanë përgatitur për shitje të aseteve në Likuidim 282 asete për shtatë (7) shitje përmes Likuidimit, shitje këto të cilat ishin paraparë në Planin e Punës 2022 dhe Strategjinë Përmbyllëse të AKP-së.

Përgatitja e shitjeve nënkupton edhe përgatitjen e të gjitha dokumenteve përcjellëse të cilat kalojnë nëpër shqyrtim kadastral dhe ligjor, duke filluar nga:

- Raporti i Vizitave në Teren,
- Memorandumet e Informimit për Bord,

- Të Dhënat për Ndërmarrjen në Likuidim,
- Përshkrimet e Shkurta,
- Memorandumet e Informimit,
- Dokumente të Caktuara Ligjore dhe Rrethet Tjera si dhe
- Bazën e të Dhënave për propozimet e mundshme të investimeve.

Po ashtu në zyret rajonale janë organizuar dy (2) shpallje për tender për asete të luajtshme dhe i gjithë procesi nga përgatitja e deri tek nënshkrimi i kontratave është organizuar dhe menaxhuar nga AL/ZR.

Gjatë vitit 2022 poashtu janë dorëzuar edhe 43 kontrata të shitjeve përmes likuidimit.

8.2. ADMINISTRIMI I ASETEVE

Agjencia sipas mandatit të saj, nga viti 2002 deri më 31 dhjetor 2022 ka administruar dhe kërkon të administroj (duke përfshirë asetet jashtë territorit të Kosovës) me gjithsej 4,930 asete të Ndërmarrjeve Shoqërore. Ky numër paraqet

numrin e të gjitha aseteve të shitura dhe të pashitura të cilat janë identifikuar nga ana e Agjencisë brenda Republikës së Kosovës dhe jashtë Republikës së Kosovës. Më poshtë janë paraqitur të dhënat në mënyrë tabelare të aseteve sipas territorit apo llojit të tyre nga viti deri më 31 dhjetor 2022.

Asetet e mbetura (të pashitura) me të cilat ende administrojnë AKP-ja janë gjithsej 2,446 ndërsa asetet jashtë Kosovës janë 169 asete të Ndërmarrjeve Shoqërore pa e përfshirë asetet e Trepçës. Gjithsesi, ky numër mund të ndryshojë në periudhat pasuese, varësisht në ndërrimin e statuseve të NSh-ve apo identifikimit të aseteve të NSh-ve përkatëse.

RAPORTI PËRMBLEDHËS I ASETEVE TË PASHITURA BRENDË KOSOVËS

Tabela 1 - Numri i aseteve të pashitura sipas kategorisë dhe rajonit

	1	2	3	4=sum(1:3)	=4/total
Rajoni	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	Gjithsej	%
Prishtina	225	251	71	547	22%
Peja	220	272	142	634	26%
Prizren	212	406	22	640	26%
Gjilan	50	171	31	252	10%
Mitrovica	178	168	27	373	15%
Gjithsej	885	1268	293	2446	100%

Tabela 2 - Numri i aseteve të pashitura jashtë Kosovës

Shteti	Numri i Aseteve	%
Bosna dhe Hercegovina	17	10%
Kroaci	5	3%
Mali i Zi	35	21%
Maqedoni	7	4%
Serbi	104	62%
Slloveni	1	1%
Gjithsej	169	

Gjatë kësaj periudhe lidhur me këto asete, AKP-ja kryesisht ka administruar lidhur me: përgatitjen e aseteve për shitje, administrimin e qirave, në koordinim me institucionet – shpalljen e interesit publik, kontestet gjyqësore dhe të tjera.

8.3. KTHIMI I PRONAVE NË PRONËSI TË NSH-VE

Gjatë vitit 2022 është arritur që në bazë vendimeve të gjykatës AKP të kthejë pronat në emër NSH-ve, ku gjithsej është arritur të kthehen **603,604 m²** tokë dhe **25 m²** lokal, në emër NSH:

- **RTP-së (PRN050)** Ngastra nr. 1781/2 ZK Veternik sipërfaqja 7,768m² toke bujqësore, Aktgjykimi i DHPGJS – anulimi i ujdise gjyqësore – kthimi i pronës.

- **RTP-së (PRN050)** - Ngastrat nr.7347/2 sipërfaqja 81m² shtëpi me tokë ndërtimore, dhe ngastra nr.7347 sipërfaqja **25m²** shtëpi me toke ndërtimore Sipas ankesës se ushtruar kundër Aktvendimit të Drejtorisë kadastrale të Komunës së Prishtinës.

- **PRN115 NSH “Ratar”** (KBI Kosova-Export) ngastrat kadastrale me nr. P-1787-3 sipërfaqja **5766m²** dhe 1787-5 sipërfaqja **5606m²** kërkesë Drejtorisë kadastrale të Komunës së Graçanicës për kthim në gjendje të mëparshme të titullarit nga personat privat tek KBI Kosova-Export-Ratar në bazë të Aktvendimit nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës datë 15.07.2015 nr. AC-I-13-0126 me të cilin vendos:

- Aprovohet ankesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe
- Shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë me shenjë C.nr.1908/06 i datës 06.06.2007.

- **KB Bec parcelat 731, 7322 dhe 734 në sipërfaqe 35 ari 19 m² në ZK Brekoc,** (prona ka qenë në emër të KB Bec është shitur nga ish Menaxhmenti palës private, është ushtruar

padi për anulim të Kontratës dhe Gjykata ka vendos në favor të NSH-së).

- **NT 17 Nëntori parcelat 252/2 dhe 252/3 në ZK Pejë në sipërfaqe 3 ari 8 m²**, (këto parcela nuk kanë qenë në emër të NSH-së është ushtru padi për vërtetim pronësie dhe Gjykata ka marr vendim në favor të NSH-së).
- **KB Ponoshec parcela nr. 465 ZK Rracaj në sipërfaqe prej 20 ari 32 m²**, në ZK Rracaj (këto parcela me vendim të Gjykatës iu janë bart palës private, është bërë kërkesë për përsëritje të procedurës ku Gjykata e Apelit ka anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë).
- **PRZ009 DLB ngastra 158-3, në sipërfaqe prej 2300m²** - Konform vendimt/aktgjykimin C.nr. 205/16, të dt. 28/12/2017 dhe vertetuar me Aktvendimin të Gjykatës se Apelit AC.nr. 879/18 të dt. 29/06/22 është kthyer një parcelë në emër të ndërmarrjes.
- **PRZ009 DLB ngastra 158-4 zona kadastrale Dushanovë, në sipërfaqe prej 2,000 m²** (C.nr. 694/13); PRZ0009.
- **PRZ009 DLB ngastra 159-9 Zona Kadastrale Dushanovë, në sipërfaqe prej, sip. 1000 m²** (C.nr. 148/16); PRZ0009 DLB Prizren
- **PSH KIB Progres- Vreshtaria Prizren ngastra kadastrale 90-0 me sipërfaqe prej 575524m²** - me Aktvendim të ZKK Prizren C.nr.204/16, me datën 15.04.2022 është bërë bartja e posedimit të saj prej PSH KK Prizren në emër të NSH-së. (Një pjesë e saj prej **9.5 ha** është e rrethuar dhe rregulluar infrastruktura për varreza nga Komuna e Prizrenit.

8.4. IDENTIFIKIMI I ASETEVE TË REJA

Vetëm këtë vit kemi identifikuar dhe kemi vënë nën administrim të AKP-së **13 asete** të reja, që më herët nuk i kishim në regjistër të Agjencisë.

- NSH Sirovinabanat - **1 aset** është përgatitur SDR/KPS;
- NSH Borba Plasman - **1 aset**-ne proces të përgatitjes së (SDR/KPS);

- NSH IMB lokali në Tunelin e parë;
- NSH Univerzal lokali nr. 37 në Leposaviq.
- Automakedonija - 1 Aset - SDR/KPS është përgatitur dhe dërguar për shqyrtim;
- Borba Plasman - 1 Aset - SDR/KPS është përgatitur dhe dërguar për shqyrtim;
- Trans-Shped Vojvodinë- 1 Aset - SDR/KPS është përgatitur dhe dërguar për shqyrtim;
- Stacioni i Veterinës Prishtinës – 1 Aset - SDR/KPS është përgatitur dhe dërguar për shqyrtim;
- PRN035 NSH Ramiz Sadiku - 1 Aset -Toke ne Obiliq tenderuar në SHAL59 por që Komuna e Obiliqit ka kërkuar të tërhiqet nga shitja shkaku i interesit publik – e evidentuar ne kadastrë si KN Jabllanica D.S.G.P Jabllanica (R. Sadiku);
- PRN130 Turist Kosova- 1 Aset - lokali në Mitrovicë – Tenderuar në SHAL 60;
- GJI004 NSH KBI Agrokultura: Parcela P-72403002-01070-0, ZK Bostan, Komuna e Novobërdës, në sipërfaqe prej 509 m², me kulturë shtëpi/ndertës dhe oborr (kjo pronë nuk ka qenë e prezantuar asnjëherë nga Menaxhmenti i NSH-së);
- GJI174 KIS Kaçanik –1 aset (ngastrat 150/0 dhe 151/0, zona kadastrale Kaçanik). Më datë 04/07/2022 është aprovuar KPS1530 qe prona bie nën administrimin e AKP-së. Likuidimi ka filluar me datë 14/12/2022;
- NSH Deva prona prej 17 ha 80 ari 24 m² (më kulturë minierë, jopjellore dhe kullosë, kjo pronë nuk ka qenë e prezantuar asnjëherë nga Menaxhmenti i NSH-së).

8.5. IDENTIFIKIMI I NDRYSHIMEVE TË GJENDJES NGA VIZITAT NË TEREN/NDËRMARRJA E VEPRIMEVE

Ndërmarrja e veprimeve ligjore si: kërkesa në urbanizëm, kërkesë në Inspektoriatin e ndërtimit dhe stacioneve policore ndërsa në rastet kur

zhvillohen punime atëherë parashtrohet kërkesë për masë të përkohshme dhe kthim në gjendje të mëparshme. Përveç këtyre veprimeve janë ndërmarr edhe veprime tjera si kallzime penale për uzurpime/ndërtime ilegale, kallzime penale për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar për raste ku pa pasur bartje të pronave në pronësinë private.

Rastet e ndërmarrjes së veprimeve në lidhje me ndryshimet e gjendjes nga vizitat në teren dhe ndërmarrja e veprimeve për rastet:

- **GJI035 NSH Agromorava, Viti**—Ndërtimet në ngastrën kadastrale 01330-0 ZK Stubell e Epërme nga M. U. dhe D. T., ndërtime jo-ligjore në pronën shoqërore, janë ndërmarr veprimet e nevojshme ligjore/administrative, kërkesa për Drejtorinë e Inspekcioni, Urbanizimit, Masën e përkohshme në DHPGJSK e përgatitur nga DL dhe dorëzuar ne DHPGJSK. Drejtoria Inspekcioni ka ndaluar punimet.
- **GJI035 NSH Agromorava, Viti** – Ndërtimet në ngastrën kadastrale 02484-11 dhe 02484-12, ndërtime jo-ligjore në pronën shoqërore ndërtimi i Sallës Sporteve- si objekt ndihmës i Shkollës Fillore Dëshmoret e Kombit në Viti, janë ndërmarr veprimet e nevojshme ligjore/administrative, kërkesa për MASHT, kërkesa për Komunën, Drejtorinë e Inspekcioni, Urbanizimit, Masën e përkohshme ne DHPGJSK e përgatitur nga DL dhe dorëzuar ne DHPGJSK.
- **GJI012 Plantacioni:** Djegia e objektit të NSH Plantacionit – Shkresa drejtuar Policisë së Kosovës dhe Zjarrfikësve,
- **GJI012 Plantacioni:** Vendosja e objektit prej druri në pronën e NSH Plantacionit – Dy shkresa të dëguara për drejtorinë e Inspekcioni dhe shkresë personit të panjohur i cili e ka vendosur objektin në pronën e NSH-së (objekti i mbyllur),
- **GJI110 Tefik Çanga:** Betonimi në një pjesë të pronës së NSH Tefik Canga - Shkresë për drejtorinë e Inspekcioni dhe personit për ndërprerje të punimeve, padi në DHPGJSK për lirim të pronës dhe kthim të gjendjes së mëparshme,
- **GJI110 Tefik Çanga:** Vendosja e rrethojës me tela në pronën e NSH Tefik Canga - Shkresë për drejtorinë e Inspekcioni dhe personit për ndërprerje të punimeve (janë larguar rrethojat me tela).
- **GJI004 NSH KBI Agrokultura, Gjilan:** Janë dërguar 2 kërkesa Urbanizmit/Inspektoratit për ndërtime ilegale lidhur me uzurpimin/ndërtime ilegale në parcelën nr. 01376-1 në Zonën Kadastrale Gjilan. Urbanizmi/Inspektorati në të dy rastet ka ndërmarrë masa dhe ka rrënuar strukturat/objektet e ndërtuara.
- **GJI027 KB Zhivko Vasiq, Ranillug:** Është dërguar kërkesa urgjente Inspekcioni për ndërtime ilegale dhe drejtorisë se urbanizmit KK Gjilan për ndalimin e punimeve dhe marrjen e masave adekuata dhe veprimeve të mëtutjeshme në ngastrën kadastrale 00146-0, Zona Kadastrale Dobërqan (Mireshe), pronë shoqërore pa lejen, pëlqimin dhe njoftimin tonë në mënyrë ilegale është ndërtuar një objekt me material të fortë i pa përfunduar i cili sipas informatave të personave të rastit është ndërtuar nga KK Gjilan. Poashtu, vendosur edhe rrjeti elektrik, përkatësisht shtyllat elektrike prej betoni.
- **PRN011 NSHBQ Drenica** – Janë ushtruar dy kallëzime penale, për uzurpim të tokës bujqësore në ZK Glloba (pas asistencës së Hetuesisë së Policisë) dhe një kundër një ish-qiramarrësi.
- **PRN011 NSHBQ Drenica** – është dorëzuar Padia dhe Propozimi për Masë të Përkohshme ndaj veprimeve të një ndërtimi të ri mbi një aset që është kontest pronësorë pranë Gjykatës për Çështje Administrative. Aseti ka qenë pronë e PRN011 NSHBQ Drenica në ZK Korroticë e Epërme, por me vendimin e atakuar të AKK-së ka kaluar në pronësi private. DHPGJS e ka refuzuar propozimin për masë të përkohshme, vijon ankesa në Apel.
- **MIT018 NSH Përparimi, Skenderaj**—Ndërtime nga Komuna e Skenderajt mbi ngastrat kadastrale 00111-0 dhe 00112-0 ZK Skenderaj,

ndërtime jo-ligjore në pronën shoqërore ndërtimi i garazhës nëntokësore dhe objekteve përcjellës e cila është ndërprerë pasi janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore/administrative: Padia dhe propozimi për masën e përkohshme nga AL, kallëzimi penal, Vendimi për masën e përkohshme është aprovuar në favor të AKP-së.

- **MIT120 NSH Urbanizmi, Mitrovicë** – Ndërtim jo-ligjor nga Kisha Ortodokse mbi ngastrën kadastrale 02729-0 ZK Mitrovicë veriore. Kisha pretendon se ka dokumente që i është ndarë parcela përkatëse. Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore: Padia për lirim të pronës nga AL.
- **MIT101 NSH Jugobanka, Mitrovicë** – Tjetërsimi i një pjese të ndërtesës administrative nr. 2 (e njohur si ish-Bankosi) nga Komuna e Mitrovicës e cila është procedurë gjyqësore dhe penale në vazhdim kundër ish-zyrtarëve të lartë të Komunës ku janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore/administrative: është përgatitur padia dhe propozimi për masën e përkohshme nga AL, kallëzimi penal, kërkesa Komunës për anulimin e vendimit për tjetërsimin, kërkesa Komunës për lirim të tërë ndërtesës, janë dhënë deklarata në Njësinë e Krimeve të Rënda të PK në Prishtinë për veprimet e Komunës. Vendimi për masën e përkohshme është aprovuar në favor të AKP-së.
- **PEJ055 NSH Bujqësia, Pejë** – Ndërtim në ngastrën kadastrale 5-75 ZK Dollovë nga familja Avdyli nga fshati Dollovë, janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore/administrative, kërkesa për Drejtorinë e Inspekcioni, Urbanizimit si dhe Policisë, si dhe është ushtruar kallëzim penal. Drejtoria për punë Inspekcioni ka ndaluar punimet. Me datë 06 Nëntor 2022, zyrtarët kanë dalë prapë në vend ngjarje për verifikim të gjendjes ku është vërejtë që uzurpatori ka larguar shiritat dhe ka vazhduar punën dhe për këtë është njoftuar prapë Drejtoria për Punë Inspektuese e KK Klinë dhe Policia e Kosovës, ku uzurpatori është gjobitë me gjobë prej 1000 €, dhe Policia e ka dërgu rastin në Prokurori. Drejtoria për punë inspektim prapë ia ka ndaluar punimet.
- **PEJ055 NSH Bujqësia, Pejë** – Ndërtim në ngastrën kadastrale 354-51 dhe 354-54 ZK Grabanicë nga N. Th. dhe J. K., janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore/administrative, kërkesa për Drejtorinë e Inspekcioni, Urbanizimit si dhe Policisë, si dhe është ushtruar kallëzim penal. Drejtoria për punë inspektuese ka ndaluar punimet.
- **PEJ021 KB Rogova** - Shkresë Drejtorisë për punë inspektuese në Gjakovë për ndalim të punimeve në parcelën nr 55-0 dhe 59-0 në ZK Gërquinë. Në proces të ndërmarrjes së veprimeve të mëtejme;
- **PEJ029 NSH Ereniku Pordhimitaria Primare** - kallëzim penal për keqpërdorim të detyrës zyrtare lidhur me bartjen e parcelës nr. 4614-1 dhe 4612-0 ZK Gjakovë Jashtë Qytet në sipërfaqe 2 ha 32 ari 16 m², në emër të personit privat.
- **PRN104 Tregu** – 25.02.2022 – Kërkesë Inspekcioni në Prishtinë për ndalimin e ndërtimeve ilegale në zonën industriale dhe kthim në gjendje të mëparshme. Një pjesë e ndërtimit ka zënë vend por pjesa tjetër është stopuar dhe rasti është me Inspekcionin e Komunës.
- **PRN198 Jugostroj** – 14.04.2022 – Kërkesë për lirim të lokalit (Banesë). Banesa e regjistruar në emër të personit privat. Shitur viteve të '90-ta. Shqyrtim ligjor.
- **PRN104 Tregu** – 25.05.2022 – Kërkesë Inspekcioni në Prishtinë për parandalimin e ndërtimit ilegal në zonën industriale. Nisja e punimeve është stopuar.
- **PRN104 Tregu** – 14.07.2022 – Kërkesë Inspekcioni në Prishtinë për parandalimin e ndërtimit ilegal në zonën industriale. Nisja e punimeve është stopuar.
- **PRN115 NSH Ratar** – 07.10.2022 - Tentim ndërtimi në parcelën nr. 1887/3, ZK Llapnasellë, Graçanicë – Shkresë Drejtorisë së Inspekcioni të Komunës së Graçanicës. Ndërtimi është evituar.

- **PRN204 Gazela** – 18.11.2022 - lokali afarist nën Grand Hotel – shkresë Inspektoratit dhe Urbanizmit të Komunës së Prishtinës për kthim në gjendje të mëparshme (integrimi i sipërfaqes së lokalit me lokalitetin tjetër privat). Statusi i pazgjidhur. Nuk janë ndërmarrë veprime konkrete nga Inspekcioni ende.
- **PRN104 Tregu** - 29.11.2022 – Kërkesë Inspekcioni në Prishtinë për parandalimin e ndërtimit ilegal në zonën industriale. Nisja e punimeve është stopuar.
- **PRZ006 NBI Suhareka** - Prona në ZK Sopi Suharekë parcela 189-0 ka identifikuar gjatë vizitës në teren se në këtë ngastër ka aktivitet/ndërtim të objektit, edhe pse për të njëjtën pronë më datë 09/03 dhe 16/03/2021 i kemi bërë shkresë për ndalim ndërtimit. Gjatë vizitës në teren më datë 08/07/2022 është vërejtë se ka është filluar ndërtim ilegal. Dhe

me këtë rast me datë 12/07/2022 është dërguar shkresë inspektoratit të KK Suharekë që të kthejë pronën në gjendje të mëparshme para ndërtimit.

8.6. PËRCAKTIMI STATUSIT TË NSH-ve

Gjatë këtij viti janë procesuar katër (4) Kërkesa për Përcaktimin e Statusit (SDR) për Asetet e NSH-ve me seli jashtë Kosovës për të cilat është siguruar dokumentacion, për shqyrtim nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Përcaktimin e Statusit të NSH-ve.

8.7. IDENTIFIKIMI I ASETVE TË MBETURA ME PROBLEME

Gjatë këtij viti në sistemin e menaxhimit të aseteve ku janë të identifikuar asetet e mbetura, për secilin aset është bërë identifikimi i problemeve dhe përmbledhja është paraqitur si në vijim:

Rajoni	Prishtina	Peja	Prizren	Gjilan	Mitrovica	Gjithsej	%
Masë të Përkohshme	24	27	12	14	3	80	2.2%
Asete të mundshme për Shpronësim	16	-	-	1	-	17	0.5%
Asete me Vlerë	61	10	11	4	9	95	2.6%
Aset për Akomodim të Qeverisë	18	-	1	-	4	23	0.6%
Mungesë e dokumentacionit	1	9	-	27	23	60	1.6%
Parcelim	18	81	24	34	40	197	5.3%
Ndërtime Joligjore	60	87	59	50	43	299	8.1%
Problem Kadastral	65	-	52	28	8	153	4.1%
Problem Pronësor	262	185	134	40	200	821	22.2%
Heqje Dorë	48	65	39	29	10	191	5.2%
Komasacion	3	32	6	5	34	80	2.2%
Trashëgimi Kulturore	1	-	3	1	1	6	0.2%
Fond Sovran	412	413	439	206	204	1,674	45.3%
Gjithsej	989	909	780	439	579	3,696	100.0%

*një aset mund të ketë dy (2) e më shumë probleme e posaçërisht kategoria e tokave pasi që janë të grupuara në bazë të zonës kadastrale.

Janë formuar gjithsej tri (3) grupe punuese të cilat kanë për detyrë të shqyrtojnë problemet ekzistuese me asetet në portfolio dhe pritjet që pas shqyrtimeve të rekomandojnë zgjidhje në mënyrë që këto aset të përgatiten për shtije sa

me shpejtë që të jetë e mundur, pasi që mos definimi i saktë i aseteve të cilat do të kalonin në fondin sovran po e pamundëson edhe shitjen e aseteve dhe planifikimin e tyre.

8.8. MENAXHIMI I ASETVE TË MBETURA

Edhe gjatë kësaj periudhe pjesë thelbësore e strategjisë ka qenë edhe menaxhimi i aseteve.

AKP-ja menaxhon me një numër të madh të aseteve apo të NSh-ve që janë të mëdha dhe komplekse të tilla si NSh Grand Hotel, NSh Tregu dhe deri në muajin nëntor 2022 kur është bërë edhe pranim dorëzimi ka menaxhuar edhe me NSh ABC Genci. Ndikim të madh në inkasim të qiradhënies ka patur edhe pranim dorëzimi i objektit të Rilindjes me që rast u janë ndërprerë kontratat të gjithë qiramarrëseve, gjë e cila ka ndikuar edhe drejtpërdrejtë në inkasimin e të hyrave nga qiraja.

Përveç menaxhimit me NSh-të e mëdha dhe komplekse, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike si dhe atë pandemike dhe sistemin gjyqësor në Kosovë, implementimi i politikave në dhënien me qira të aseteve për AKP-në ka qenë sfidë në vete.

Gjithsesi, marrë parasysh këta faktor, AKP-ja ka inkasuar qira në nivel të kënaqshëm prej **EUR 4,842,279** dhe atë:

- Qiraja e inkasuar për NSh-të në likuidim prej **EUR 4,579,737**;
- Qiraja e inkasuar për NSh-të në tranzicion prej **EUR 262,542**.

Duhet potencuar se gjatë periudhës raportuese janë dërguar në përmbarim gjithsej **54** raste të qiramarrëseve që kanë qenë pagues të parregullt.

Gjatë vitit 2022 janë procesuar gjithsej **18**, Kërkesa për Asistencë të Policisë për lirim të aseteve nga uzurpatorët dhe qiramarrësit e parregullt.

Dhe poashtu zyrtarët ligjor në zyret rajonale kanë ushtruar **30 padi** në gjykatat komunale.

8.9. QIRADHËNIA E ASETEVE TË NSh-ve

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2022, zyret rajonale kanë përgatit dhe kanë marr aprovim nga kryesuesit e AL-ve, Menaxhmentit dhe Bordit të Drejtorëve për qiradhënie të pronave të NSh-ve në përputhje me Rregulloren e Qiradhënies, dhe janë bërë shpalljet për qiradhënie për **68 asete në likuidim**, ku afati për dorëzimin e ofertave ka qenë më 31 janar 2022. Komisionet përkatëse

kanë përgatitur raportet e vlerësimit për aprovim nga ana e menaxhmentit kurse Bordit i janë paraqitur për shqyrtim/aprovim në muajin shkurt 2022.

Gjithashtu gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022, zyret rajonale kanë përgatit dhe kanë marr aprovim nga kryesuesit e AL-ve, Menaxhmentit, dhe Bordit të Drejtorëve për qiradhënie të pronave të NSh-ve në përputhje me Rregulloren e Qiradhënies, dhe janë bërë shpalljet për qiradhënie për **30** asete në likuidim, ku afati për dorëzimin e ofertave ka qenë më 06 Korrik 2022.

Gjithashtu gjatë tremujorit të fundit të vitit 2022, zyret rajonale kanë përgatit dhe kanë marr aprovim nga kryesuesit e AL-ve, Menaxhmentit, dhe Bordit të Drejtorëve për qiradhënie të pronave të NSh-ve në përputhje me Rregulloren e Qiradhënies, dhe janë bërë shpalljet për qiradhënie për **196** asete në likuidim, ku shpallja është bërë me datë 21 dhjetor 2022 kurse afati për dorëzimin e ofertave ka qenë më 04 janar 2023.

8.10. PUNË TJERA

- Gjatë kësaj periudhe ka filluar auditimi i jashtëm në lidhje me qiradhënie të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore që përfshin periudhën 10 vjeçare: 01 janar 2012 – 31 dhjetor 2021, për shkak se auditim të tillë nuk kemi pasur ndonjëherë më parë, edhe volumi i dokumentacioni ka qenë mjaft voluminoz. Pasi që përfshihet periudha kur edhe qiradhënia është organizuar dhe udhëhequr nga vet menaxhmentet e NSh sipas politikave të NSh-ve.
- Përgatitja e raporteve të ndryshme për nevoja të menaxhmentit dhe Bordit si dhe raporteve të ndryshme për institucionet qendrore dhe lokale sipas kërkesës së menaxhmentit.
- Janë regjistruar në protokollin e zyreve rajonale gjithsej **5,982** shkresa hyrëse dhe **9,555** shkresa dalëse.
- Përgatitja e Fletëinformacioneve me të gjitha të dhënat në lidhje me 84 asetet me Vlerë më të theksuar.

- Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës të mbajtur me datë 30 prill 2022 dhe 10 gusht 2022 janë anuluar 22 vendime për Dhënie në shfrytëzim për Këmbimin e Pronave së paluajtshme me Komuna janë anuluar **22 vendime** ku janë përfshirë **736 asete/ngastra** të këtyre vendimeve dhe ka mbet vetëm një vendim i pa anuluar me numër **13/60 i datës 07 gusht 2018**. Vendimet e shfuqizuara më lartë afektojnë edhe vendimet e Bordit me të cilat disa komunave u është lejuar që të zhvillojnë projektet të parapara me vendimet e lartcekura dhe tanimë të shfuqizuara.
- Përgatitja e raportit të shitjes së tokave bujqësore sipas kërkesës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në lidhje me të dhënat për Raportin e Gjellbërt për nevoja të Ministrisë.
- Përgatitja e të dhënave për asetet që mund të përdoren si kopshte/çerdhe për Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.
- Zyret rajonale kanë përgatitur Fletëinformacionet të gjitha të dhënat në lidhje me tokat me hapësirë mbi 10 HA hapësirë kompakte ku gjithsej janë të përfshira 168 asete.
- Përfaqësues nga Departamenti i Koordinimit Rajonal është caktuar në Grupin Punues me Ministrinë e Ekonomisë, që ka për detyrë dizajnimin e një Skeme Konkurruese për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë ndërkaq roli i AKP në këtë grup ka qenë që në koordinim me Ministrinë të ofrohen të dhëna në lidhje me asetet të një hapësire prej së paku 10 hektarësh e më tepër (hapësirë kompakte) që nuk janë subjekt i procedurave kontestimore.
- Janë përgatitur gjithsej pesë (5) Njoftime për Board për shqyrtim dhe kane marr aprovim nga ana e Bordit me ç'rast kanë filluar procedurat e likuidimit për këto ndërmarrje, ku zyret rajonale janë marr me pranimin dhe regjistrimin e të gjitha ankesave sipas ligjit në fuqi.
- Është azhurnuar lista me Vendime të Shpronësimeve që përfshin gjithsej **1,374** asete, prej tyre janë **777** asete të ndërmarrjeve shoqërore dhe **597** asetet të Ekonomive Pyjore me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht **5,100 hektar** dhe ky numër pritet të rritet pasi që po vazhdohet të merren vendime për shpronësim na baza të rregullta.
- Në muajin janar ka filluar edhe auditimi i brendshëm sa i përket qirave aktive me ç'rast janë kërkuar informata dhe mostra të ndryshme për shqyrtim.
- Gjatë kësaj periudhe rëndësi të veçantë i është kushtuar vizitës së aseteve. Të gjitha asetet si objekte janë vizituar dhe raportet e vizitave janë përfunduar. Përmbledhja e tentim veprimeve të ndërmarra nga palë të ndryshme i është raportuar menaxhmentit.

8.11. SFIDAT

- Për shkak të kufizimeve të shumta që kemi deri në sqarimin e listave që janë shqyrtuar si mundësi për fond sovran, listës së aseteve për akomodim të institucioneve, mundësia për propozim të aseteve për shitjet e ardhshme është zvogëluar.
- Masat e përkohshme nga DhPGJSK/Masat e përkohshme nga Gjykatat tjera/kërkesat për masë të përkohshme ende pa vendim të DhPGJSK;
- Komasacioni;
- Mungesa e dokumentacionit të pronësisë si dhe të dhënat e vjetruara kadastrale të pronësisë në raste kur NSH-ja posedon të dhëna të gabuara sa i përket pronësisë të aseteve të caktuara. Zyrtat Komunale Kadastrale në shumë raste nuk janë shumë bashkëpunuese dhe vazhdimisht refuzojnë të azhurnojnë të dhënat kadastrale.
- Numri i madh i vendimeve të Qeverisë për shpronësimin.

9. DEPARTAMENTI LIGJOR

9.1 ARBITRAZHET

Më 9 dhjetor 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe SharrB nënshkruan Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksioneve (MSHA) të ndërmarrjes SharrCem me seli në Han të Elezit me një çmim të përgjithshëm të blerjes prej 30.1 milionë euro, dhe, me kusht që kushtet e tregut të mbeten materialisht të pandryshuara, të implementoj një "program investimi" 5-vjeçar, me një vlerë të parashikuar prej 35 milionë eurove.

Më 10 dhjetor 2015, AKP-ja i ka shkruar SharrCem-it duke e informuar se afati për përmbushjen e obligimeve investuese sipas MSHA-së kishte skaduar një ditë më parë. AKP-ja e ka përsëritur se, në përputhje me nenin 5.03 të MSHA, do të angazhonte një firmë për të kryer një auditim për të përcaktuar nëse SharrB kishte përmbushur zotimet e veta për investime në kuadër të MSHA. Agjencia ne vitin 2016 kishte angazhuar firmën Ndërkombëtare të auditimit BDO.

Më 19 dhjetor 2016, BDO publikoi raportin e auditimit ("Raporti i Parë"). Në Raportin e Parë është vënë në dukje se SharrCem kishte raportuar 35,170,654.51 euro në investime ndërmjet periudhës 9 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2015. Megjithatë, BDO ka arritur në përfundim se disa nga këto investime të raportuara nuk mund të "klasifikoheshin si investime kapitale për përmbushjen e marrëveshjes së zotimit për investime." Në veçanti, 7.891.000 euro janë paguar për blerjen e aksioneve në tri kompani, Rudmak DOOEL ("Rudmak"), MillCo DOOEL Shkup ("MillCo") dhe Cement Plus shpk ("Cement Plus"), si dhe 1,495,660 euro të "Investimet në vazhdim", u konstatuan nga BDO se nuk janë investime kapitale në kuptimin e MSHA'së. 225,757.34 euro në investime të raportuara që ishin "faturuar dhe kontraktuar" pas 9 dhjetorit 2015 deri më 31 dhjetor 2015 u përjashtuan gjithashtu nga BDO. Si e tillë, BDO i ka konstatuar "investimet kapitale të pranueshme që nga 9 dhjetori 2015" të jenë 25,558,237.17 Euro.

Në relacion me këtë Sharr B kishte ngritur shqetësimet e saj se mos përmbushja e pjesës

tjetër të investimeve kishte rezultuar si shkak i vështirësive në kushtet e tregut që kishin ndodhur në Republikën e Kosovës.

Më 31 korrik 2017, AKP-ja e ka njoftuar SharrCem-in se Bordi i Drejtorëve të AKP-së kishte vendosur të angazhojë "një firmë prestigjioze audituese ndërkombëtare" për të analizuar kushtet e tregut që mund të ndikojnë në zbatimin e programit të investimeve në kuadër të MSHA-së. Më 26 janar 2018, AKP-ja ka lidhur kontratë tjetër me BDO-në për të "konstatuar nëse ka ndonjë ndryshim të kushteve të tregut i cili mund të ketë ndikim në realizimin e investimeve kapitale nga blerësit e Ndërmarrjes së Re "Sharrcem" Hani i Elezit". Në konkluzionin e raportit të saj të përgjithshëm, BDO ka konstatuar se "nuk ka pasur ndonjë ndryshim material në kushtet e tregut që mund të ketë ndikuar në realizimin e investimeve kapitale nga blerësi i Ndërmarrjes së Re "Sharrcem" sh.p.k, Hani i Elezit".

Më 23 nëntor 2018, Bordi i Drejtorëve të AKP-së vendosi që SharrCem "të paguajë" 9,441,768,83 euro "për diferencën e mosplotësimit të investimeve" dhe caktoi afatin e pagesës "60 ditë pune pas njoftimit". Pas marrjes së vendimit nga AKP-ja, SharrCem dhe SharrB i kanë shkruar ndaras AKP-së, duke pohuar se SharrCem nuk ishte palë e MSHA-së dhe për këtë arsye nuk kishte asnjë detyrim sipas kësaj marrëveshje. AKP-ja nuk u pajtua me qëndrimet e tyre, dhe më 30 janar 2019, Bordi i Drejtorëve të AKP-së ndryshoi vendimin e mëparshëm duke theksuar se SharrB dhe SharrCem "do të paguajnë" në lidhje me mospermbushjen e investimeve.

Më 29 janar 2019, Paditësi ka dorëzuar Njoftimin për Arbitrazhin, duke u thirrur në nenin 9.04 të MSHA-së dhe nenin 3 të Rregullave të Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Tregtisë Ndërkombëtare të rishikuar në vitin 2010 ("Rregullat e UNCITRAL"). Marrëveshja për shitëblerjen e ndërmarrjes e kishte paraparë Klauzolen e Arbitrazhit si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes palëve.

Me datë 7 mars 2022 Tribunali Ndërkombëtar i Arbitrazhit me shumicë të votave dy (2) në favor

dhe një (1) kundër, kishte vendosur citojmë: Për arsyet e parashtruara më sipër, Tribunali:

- a. *Deklaron se SharrB ka përmbushur detyrimin e tij të investimit sipas Nenit 5.01(a) të MSHA;*
- b. *Urdhëron të Paditurin që ti paguajë Paditësit 406,890.58 euro, si rimbursim i shpenzimeve të Tribunalit dhe PCA-së të paguara nga Paditësi, si dhe shumën 1,350,086.42 euro si rimbursim i pjesshëm i interesit ligjor dhe shpenzimeve të tjera të paditësit të shkaktuara në normën e thjeshtë të arbitrazhit me 4 % në vit nga data e këtij Vendimi deri në pagesën e plotë.*
- c. *Hedh poshtë të gjitha pretendimet dhe kundërpaditë e tjera.*

Me datë 30 mars 2022 Bordi i Drejtorëve i AKP-së ka nxjerr vendim që të bëjë pagesën sipas vendimit të Tribunalit Ndërkombëtar të Arbitrazhit, i cili vendim është i formës së prerë dhe se mos ekzekutimi i tij do e ekspozonte AKP që të paguaj kamata shtesë prej 4%. Si rrjedhojë e kësaj AKP me datë 15 prill 2022 e ka finalizuar

transaksionin bankar në xhirollogarinë e Sharr B konform vendimit të Tribunalit Ndërkombëtar të Arbitrazhit.

Firma Ligjore që e ka përfaqësuar AKP në këtë kontest është "Squire Patton Boggs" me seli në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo firmë është angazhuar me kontratat të prokurimit (239-19-2124-215 e datës 23 dhjetor 2019 me titullin: Kontratë për angazhimin e një kompanie ligjore ndërkombëtare për përfaqësim ligjor të AKP-së në Gjykatën Permanente të Arbitrazhit në Hagë.

9.2 NJËSIA E OPINIONEVE LIGJORE DHE SHQYRTIMIT TË KONTRATAVE TË SHITJES

Njësia e Opinioneve Ligjore (NJOLSHKSH) ka zhvilluar aktivitete të ndryshme, por që kryesisht konsistojnë në dhënien e mendimeve dhe këshillave ligjore, hartimin e dokumenteve juridike rregullore apo akte tjera juridike, shqyrtimit të kontratave të shitjes si dhe pjesëmarrjen në takimet e ndryshme. Përmbledhja e aktiviteteve të NJOLSHKSH gjatë periudhës raportuese, është paraqitur më poshtë:

Përshkrimi	Gjithsej
Opinione Ligjore sipas formularit standard për OL	8
Këshilla Ligjore përmes emailit	25
Përgjigje në kërkesa të palëve	17
Përgjigje në Padi	1
Pjesëmarrje në komisionin punues	10
Pjesëmarrje në komisionin punues të Qeverisë së Kosovës në lidhje me fondin sovran	3
Përpilime i marrëveshjeve mes AKP-së dhe institucioneve tjera	3
Numri total i draft kontratave të shqyrtuara është	40

9.3 NJËSIA PËR PËRFAQËSIME LIGJORE

Në vazhdim po ju paraqesim raportin gjithëpërfshirës të lëndëve dhe veprimeve procedurale si vijon:

Përshkrimi	Gjithsej
Numri i përgjithshëm i lëndëve të reja të pranuar	94
Pjesëmarrje në seanca gjyqësore	98
Ftes për seanca gjyqësore	80
Aktgjykime të pranuar	42
Aktvendime nga gjykatat dhe organet tjera administrative të pranuar	113
Urdhra të pranuar nga Gjykatat	111
Ankesa	9
Padi	3
Përgjigje në padi	44
Kundërpërgjigje	5
Kallëzim Penal	2
Parashtesa	49
Përgjigje në urdhra	56
Përgjigje në ankesa	36
Përgjigje në masë mas të përkohshme	29
Prapësim	2
Fjala përfundimtare	2
Lëndë të pranuar për 20%	240
Ftesë për seancë	2
Pjesëmarrje në seancë	2
Aktgjykimet e pranuar ne lidhje me 20%	8
Aktvendimet e pranuar	5
Ankesa për përfshirje në listën përfundimtare për 20% të pranuar	228
Përgjigje në ankesë për përfshirje në listën përfundimtare për 20% dhe mjete tjera juridike	304
Urdhra	2
Përgjigje në urdhër	2
Parashtesa	2

9.4 NJËSIA PËR TRAJTIMIN E ASETEVE JASHTË VENDIT

Koordinimi i veprimeve dhe aktiviteteve nga sfera e aseteve jashtë Kosovës:

- Koordinimi i çështjeve nga sfera gjyqësore në Gjykatat Themelore dhe në DHPGJS për Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) të cilat kanë asete jashtë Kosovës me Autoritet e likuidimit të këtyre Ndërmarrjeve;
- Koordinimi me Kryesuesin e Likuidimit të NSH “Gërmia” me seli në Prishtinë, për iniciimin e

procedurës pranë organeve administrative dhe gjyqësore në Serbi;

- Pjesëmarrja në takime të grupit punues për draftimin e Rregullores për shitje me Negocim Direkt dhe në takimet e grupit punues me DM-në dhe Drejtorët relevant të Koordinimit Rajonal dhe Shitjes për diskutim të draftit të parë të Rregullores për shitje me negociim direkt;
- Përgatitja e përgjigjeve për Komisionit për financa dhe transfere i cili raportohet nga

- Kryesuesi i BD-it lidhur me angazhimin e Agjencisë për asetet jashtë vendit;
- Këshillime për AL-në e NSh “KosovaSirovina” me seli ne Mitrovicë lidhur me veprimet administrative ndaj palëve të treta lidhur me zbatimin e një vendimi përmbartimor të përmbartuesit privat nga Podgorica;
- Koordinimi i aktiviteteve lidhur me asetin e Nsh “Emin Duraku (Napredak)” i cili gjendet në Tuzëll të Bosnje Hercegovines me Avokatin Sanel Neziric dhe Administrimin Direkt të NSh-së;
- Koordinimi i veprime administrative me AL-në NSh KBI “Kosova Eksport” Fushë Kosovë lidhur me dëshmitë e kërkuara për statusin NSh-së në çështjen juridike cila është duke u zhvilluar në Gjykatën Ekonomike në Kraljevë në çështjen kontestimore 4.P24/2022 paditës NSh KBI “Kosova Eksport” – Mishtorja Fushë Kosovë, kundër të Paditurës Sha: Mishtorja (Klanica) Kraljevë;
- Përgatitja e përgjigjes në interesimet e Redaksisë së Gazetës “Vjesti” nga Podgorica lidhur me procedurën e cila është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Kotorr në padinë parashtruar me shenjen Posl.P.br. 1053/18/18 nga NSh Rekreaturs” në likuidim kundër DD “Rekreaturs” Budva dhe Opstina Budva; objekti i kontestit vërtetim pronësie;
- Koordinimi i veprimeve administrative me Autoritetin e Likuidimit dhe Zyrën Regjionale të Prizrenit, lidhur me angazhimin e avokatit për ofrimin e Shërbimeve Ligjore për asetin e NSh “Printeks” Prizren me sipërfaqe prej 128 m² i cili gjendet Rr. Car Urosh 6a në Beograd;
- Përgatitja e kontratës për Ofruesin e shërbimeve ligjore në vazhdimin e angazhimit të avokatit Samir Hot në çështjen kontestimore St.21/2019 paditës NSh KBI Kosova Eksport-Mishtorja Fushë Kosovë kundër të paditurës DD “Klanica” Kraljevë, padi për ndalimin e shitjes se aseteve të Nsh-së KBI Kosova Eksport-Mishtorja Fushtë Kosovë;
- Pjesëmarrje në takimin konsultativë në Zyrën e Avokaturës Shtetërore në çështjen

kontestimore sipas padisë civile të Republikës së Kosovës ndaj personave fizik dhe juridik për vërtetimin e pronësisë së Qendrës Rekreative - Edukative dhe Sportive “Ganimete Tërbesht”, Gjykata Themelore Kotorr;

- Pjesëmarrja në grupin punues qeveritar për vlerësimin e zbatimit të strategjisë për të drejtat pronësore, dhe ndërmarrja e veprimeve konkrete për zbatimin e saj;
- Koordinimi i kërkesës së Avokaturës Shtetërore me AL-në për shqyrtimin ligjor të Vendimit për shpronësimin e pronave të NSh Pllanika, MIT156), Lokalin me ndërtim të përkohshëm të NSh Trepca Hotelaria në Mitrovicë Veriore (MIT037), të Komunës së Mitrovicës Veriore.

Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë:

Përshkrimi	Gjithsej
Përgjigje në urdhër	7
Pjesëmarrje në seancë gjyqësore	19
Aktgjykim	5
Ankesa	5
Përgjigje në ankesë:	3
Parashtresa	10
Parashtresa elektronike	10
Aktvendime	5
Ushtrimi i padisë	2
Vendime administrative	2

9.5 NJËSIA E SHKRESAVE GJYQËSORE

Në vazhdim po ju paraqesim raportin gjithëpërfshirës të lëndëve dhe veprimeve procedurale si vijon:

Përshkrimi	Gjithsej
Kërkesa Pronësore	101
Kërkesa për Komision të Banesave	31
Kërkesa për paga	1
Kërkesa të tjera kreditore	29
Kërkesa për kategori të tjera	15
Kërkesa për rregullat të Tenderit	13
Kërkesa për listë të punëtorëve	314
Në total regjistrime të reja	504

10. DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT

Në përputhje me rolin që ka Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët, në vazhdimësi janë ndërmarrë veprime drejt përkrahjes së plotë në promovimin e punës së Agjencisë, informimin e publikut në lidhje me punën e Agjencisë si dhe hartimin dhe menaxhimin e fushatave specifike informuese të Agjencisë. Njëra ndër funksionet primare të Departamentit të Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët është e lidhur ngushtë me shitjen si proces, duke siguruar përkrahje e plotë për të gjitha shitjet e realizuara nga Agjencia dhe menaxhimit të raporteve të mira me investitorët potencial.

Për qëllime të raportimit, aktivitetet e realizuara të Departamentit të Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët për periudhën janar - dhjetor 2022, janë të grupuara në përputhje me objektivat e cekura në planin e punës për vitin 2022:

Përkrahja e plotë në shpallje të Shitjeve të Aseteve dhe publikime tjera të rëndësishme- Me qëllim të adresimit të kërkesës së Bordit të Drejtorëve për gjetjen e mënyrave me të cilat informatat do t'u afrohen më shumë investitorëve potencialë dhe të mbulojnë tërë hapësirën e Kosovës, është analizuar gjendja aktuale dhe janë shqyrtuar mundësitë në zgjerimin e gamës së medimeve të përdorura dhe aktivitetëve shtesë që mund të ndërmerren brenda Agjencisë. Në këtë drejtim, janë prezantuar mundësitë reale për sa i përket intensifikimit të përpjekjeve për shpërndarje më gjithëpërfshirëse të informatave relevante të Agjencisë. Në bazë të aprovimeve nga Bordi i Drejtorëve, janë përcaktuar mënyrat e publikimeve për njoftimet e rëndësishme të Agjencisë, përfshirë edhe mënyrat e marketingut të shitjeve të asetëve.

Sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për ri-fillimin e procesit të shitjeve, në aspektin e shpalljes së shitjeve janë ndërmarrë dhe zbatuar plane multimediale marketingu. Janë ndërmarrë aktivitete operacionale që përfshinë lansimin e shitjeve, realizimin e materialeve të duhura promovuese si

dhe janë ofruar shërbime këshilluese për të gjithë investitorët e interesuar të marrin pjesë në procesin e Privatizimit. Gjatët periudhës raportuese është bërë shpallja e Shitjes së Aseteve -55, Shitjes së Aseteve -56, Shitjes së Aseteve -57, Shitjes së Aseteve -58, Shitjes së Aseteve -59, Shitjes së Aseteve -60 si dhe shpallja e Shitjes së Aseteve 61. Aktivitetet e ndërmarra:

- Përmbledhja e materialeve relevante dhe koordinimi me zyret rajonale në lidhje me përgatitjen e shpalljeve për Shitje të Aseteve.
- Koordinimi me operatorët ekonomik rreth realizimit të të gjitha produkteve të marketingut, përfshirë TV dhe radio reklamat dhe TV njoftimet, broshurat dhe të gjitha materialeve tjera promovuese.
- Publikimi i shpalljeve të Shitjeve është bërë përmes transmetimit të TV Reklamës në TV publike dhe nacionale, transmetimit të radio reklamës në radio stacione lokale, në rajonet ku ka pasur më shumë prona të përfshira në shitje. Gjithashtu, reklama në gjuhën serbe është transmetuar në lokacionet e banuara me minoritete serb folëse, për shkak të asetëve që kanë qenë në shitje në këto lokacione.
- Publikimi i Shitjeve të asetëve ka përfshirë edhe postimin e materialeve relevante në mediet elektronike dhe postimit të njoftimeve dhe dokumenteve relevante në ueb faqen e Agjencisë.
- Personat e regjistruar në databazën e investitorëve potencial janë njoftuar mbi shpalljen e Shitjeve të Asetëve përmes postës elektronike dhe SMS shërbimit.
- Përgatitja e njoftimeve (ftesave) dhe komunikatave për media lidhur me lansimin e shitjeve dhe të gjitha aktivitetet tjera me interes për publikun të ndërlidhura me ditën e shitjes.

- Janë ofruar udhëzime dhe këshillime gjatë periudhës së hulumtimit paraprak për blerësit potencial. Gjatë periudhës raportuese, për shitjet e asetëve të realizuara gjatë vitit 2022, gjithsej janë nënshkruar 158 (njëqind e pesëdhjetë e tetë) marrëveshje për ruajtjen e sekretit afarist për asetet e përfshira nga gjithsej 71 (shtatëdhjetë e një) individë që kanë pranuar dosjet e tenderit.

Ngritja e vizibilitetit dhe promovimit të procesit të privatizimit - Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 është ofruar përkrahje në përmbushjen e obligimeve të Agjencisë për publikim të njoftimeve të rëndësishme në televizion dhe në portale informative, duke siguruar mbikëqyrjen e realizmit teknik të materialeve relevante të njoftimeve (listat preliminare dhe finale të punëtorëve për shpërndarjen e 20%, raportet përfundimtare të likuidimit, informata për kreditorë, shpallje të qiradhënieve si dhe informata tjera të rëndësishme), si dhe publikimin në mediumet e përzgjedhura, sipas kërkesave të Departamenteve përkatëse.

Njëkohësisht, në kuadër të Njesisë së Marketingut është bërë dizajni dhe përgatitja për shtyp për të gjitha publikimet e rëndësishme për Agjencinë, përfshirë raportin vjetor të Agjencisë, përmbledhje të rregullativës ligjore të Agjencisë dhe dokumente tjera të rëndësishme.

Ngritja e transparencës dhe nivelit të informimit - Në shërbim të ngritjes së transparencës dhe nivelit të informimit, ueb faqja e Agjencisë është azhuruar dhe populluar me informata të sakta dhe në kohë reale me të gjitha informatat publike në lidhje me procesin e privatizimit në Kosovë. Kjo ka përfshirë publikimet e listave preliminare dhe finale të punëtorëve për shpërndarjen e 20%, raportet përfundimtare të likuidimit, komunikatave për media, raportet dhe rregulloret e AKP-së, si dhe informatave të tjera të rëndësishme.

Realizimi efikas i aktiviteteve të marketingut për shitje mund të vërehet edhe nga vizitueshmëria e ueb faqes së Agjencisë me rastin e lansimit të shitjeve. Bazuar në statistikën e vizitueshmërisë gjatë periudhës kur nuk ka pasur shitje aktive, mesatarja ishte 480 vizita/ditë, ndërsa me lansimin e shitjeve, mesatarja është ngritur për 3

deri 10 herë më shumë se sa mesatarja ditore, duke arritur kështu kulminacionin më të madh deri në 4,300 vizita/ditë me rastin e lansimit të Shitjes së Asetëve në Likuidim – 55.

Gjatë periudhës raportuese është bërë harmonizimi i të dhënave në ueb faqen e Agjencisë, bazuar në udhëzuesin për përmbytjen e faqeve të internetit të institucioneve publike të AIP-s. Njëkohësisht, janë ndërmarrë veprime me qëllim të zbatimit të Udhëzuesit për Përmbytjen e Faqeve të Internetit të Institucioneve Publike dhe kërkesave ligjore në lidhje me faqen e internetit të Agjencisë, përfshirë komunikimet me institucionet relevante për zbatimin e procedurave të bartjes së hostimit dhe ndryshimit të domain-it të faqes së Agjencisë në serverët e Qendrës Shtetërore të të Dhënave të Republikës së Kosovës.

Bashkëpunimi ndërinstitutional- Departamenti ka vazhduar bashkëpunimin ndërinstitutional duke u përgjigjur në kërkesat specifike, si përgatitja e të dhënave me përgjigje për Ministrinë e Bujqësisë -Departamentin e Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore për të dhënat për privatizimin e tokave bujqësore në Kosovë deri më tani.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka koordinuar përgatitjen e katër (4) raporteve për Zyrën e Kryeministrit lidhur me zbatimin e planit kombëtar për zbatim të MSA-së ndërlidhur me procesin e privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Gjatë periudhës raportuese është asistuar në organizimin e vizitës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, së bashku me Ministren e Ekonomisë dhe Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, me qëllim të njoftimit me sfidat dhe të arriturat e AKP-së. Gjatë takimit u bisedua për Strategjinë përmbyllëse të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si dhe për rrugën përpara, drejt themelimit të Fondit Sovran.

Njësia për Media ka asistuar në organizimin e një tryezë diskutimi me Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti me qëllim diskutimi për Strategjinë Përmbyllëse të AKP-së 2022-2024, informimit rreth fondit sovran

dhe aseteve të mundshme që do t'a përbëjnë fondin sovran. Gjithashtu, lidhur me proceset e privatizimit dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndërinstitucional me komunat e Kosovës, është organizuar takim konsultativ me Kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Rritja e rrjedhës së informatave- Prezenca e aktivitetit të Agjencisë në rrjetet sociale është ngritur pas periudhës së pandemisë, këtë vit Agjencia ka realizuar 90 postime në rrjete sociale. Gjatë periudhës raportuese ka pasur interesim për informata në rrjete sociale nga 373 palë rrjedhimisht 373 përgjigje janë adresuar përmes këtij kanali të komunikimit, ndërkaq ka pranuar dhe adresuar rreth 287 pyetje dhe kërkesa në emailin zyrtar të Agjencisë.

- Hartimi i rreth 68 Komunikatave për Media për aktivitetet e ndryshme të Agjencisë, të cilat janë dërguar për publikim tek mediat dhe

përmes tyre janë shpërndarë tek opinioni i gjerë;

- Janë përgatitur rreth 82 përgjigje me shkrim dhe rreth 117 përgjigje /sqarime rreth proceseve në Agjenci përmes telefonit, të dërguara përmes emailit në pyetje të gazetarëve të mediave të ndryshme;
- Janë përgatitur 17 artikuj të sponsorizuar për shitjet e aseteve në likuidim dhe qiradhëniet;
- Janë përgatitur raporte të rregullta (çdo gjashtë muaj) dhe këto raporte i janë dërguar njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi e cila përgatit raportin gjithëpërfshirëse të institucioneve publike, për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Numri i kërkesave të pranura 2022

Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E pjesshme	Pa përgjigje	Arsye tjera
38	31	3	3	0	1 rishqyrtim

11. DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese në Departamentin e Burimeve Njerëzore janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

PAGAT

- Janë përgatitur dhe dërguar për ekzekutim në baza mujore Listat e Pagave (Payrollit) për muajt janar-dhjetor 2022.
- Pas marrjes së vendimit të BD 174/5 për zbritje të pagave, janë përgatitur të gjitha akt emërimet e reja për dyqind e tridhjetë (230) zyrtarë të AKP-së me efekt nga data 01 janar 2023;
- Është përgatitur Korniza afatmesme e shpenzimeve (KASH) për periudhën 2023-2025 (në bashkëpunim me Departamentin e Financave dhe Buxhetit);

LËVIZJET E STAFIT:

REKRUTIMET: Gjatë kësaj periudhe, DBNJ ka udhëhequr me gjashtë (6) procedura të rekrutimit, prej tyre një (1) e dështuar.

DORËHEQJE: Për arsye personale dymbëdhjetë (12) punonjës kanë ofruar dorëheqje.

TRANSFERET: Tridhjetë (30) punonjës janë transferuar në mënyrë të përkohshme dhe një (1) punonjës është transferuar në mënyrë të përhershme.

PEZULLIM I DAKORDUAR: Shtatë (7) punonjësve u është lejuar pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës sipas Ligjit në fuqi.

PUSHIM LEHONIE: Bazuar në Ligjin aktual në fuqi, (pesë) 5 zyrtarë kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë.

ZËVENDËSIMET: Gjatë vitit 2022, (tetë) 8 zyrtar janë caktuar në zëvendësim të pozitave tjera në periudha të ndryshme.

TË TJERA:

- Komisioni Disiplinor ka trajtuar tre (3) raste disiplinore, me ç' rast janë shqiptuara masa disiplinore "vërejtje me shkrim" për dy (2) zyrtarë si dhe një rast me masë disiplinore "Ndalimi prej 25% të pagës për periudhën prej pesë (5) muaj".
- Janë realizuar gjithsej shtatë (7) trajnime me ç' rast nga këto trajnim kanë përfituar gjashtëmbëdhjetë (16) punonjës;

- Mbledhja e informacioneve dhe përpilimi i raportit vjetor të Vlerësimit të Performancës për vitin 2021;
- Mbledhja e informacioneve dhe përpilimi i raportit vjetor të Trajnimeve për vitin 2022;
- Pasi që vlerësimi i performancës për periudhën janar – dhjetor 2022 dhe caktimi i objektivave për periudhën janar – dhjetor 2023 do të bëhet online përmes sistemit HRMIS, DBNJ ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme teknike për qasje të të gjithë zyrtarëve në këtë sistem;

12. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i Administratës ka për detyrë të ofroj kushte sa më të mira infrastrukturore dhe logjistike për arritjen e objektivave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në kuadër të Departamentit të Administratës bëjnë pjesë këto njësi: Njësia e Përkthimeve, Njësia e Protokollit, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Arkivit, Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njësia e Transportit.

Aktivitetet kryesore për këtë periudhë të raportimit për njësitë përkatëse, paraqiten si më poshtë:

Njësia e Përkthimeve:

Njësia e Përkthimeve ka përkthyer **283 dokumente** me **1,978 faqe** dhe ka siguruar përkthyesit për **8 takime**.

Njësia e Protokollit:

Gjatë kësaj periudhe, në këtë njësi janë pranuar/dërguar dhe proceduar dokumentet si në vijim:

- Të regjistruara në sistem hyrje/dalje janë 5787 shkresa;
- Dokumente dhe shkresa hyrëse 3282;

- Shkresa dalëse nga kjo zyrë janë regjistruar 2505;
- Të skanuara 5787;
- Pranimi me Postë 695;
- Dërgimi me Postë 708;
- Dërgimi me libër të ekspedicionit brenda AKP-së 3282;
- Dërgimi me Libër jashtë AKP-së 182;
- Shkresa të Dhomës së Posaçme të identifikuar për Autoritetin e Likuidimit 4160.

Njësia e Teknologjisë Informative:

- Mirëmbajtja e tërë infrastrukturës së TI-së si: sistemi i ofrimit të shërbimeve, sistemit virtual i serverëve, sistemi për ruajtje dhe rikthim të shënimeve, sistemi i arkivimit të SAN sistemeve;
- Mbrojtja dhe siguria e sistemit të TI-së, si mbrojtja nga sulmet nga jashtë me Fireëall, mbrojtja nga viruset, mbrojtja nga humbja e

shënimeve, mbrojtja dhe përditësimi i klientëve dhe serverëve me Ëindoës updates dhe me ËSUS, mbrojtja e sistemit të email-ave me Baracuda Mail Archiver, Sistemi Antispam etj;

- Instalimi i sëitchave VOIP për komunikim të sistemit telefonik VOIP (Voice Over IP);
- Krijimi i rangjeve të reja IP të rrjetit për ndarjen e sistemeve komunikuese, video kamerave, sistemit RFID, telefonisë VOIP, kontraktorit GrandThornton, si dhe hotspot-ave ëireless;
- Instalimi i telefonave VOIP (Voice Over IP);
- Përditësimi i të gjithë sistemeve operative për klientë nga Ëindoës 7 në Ëindoës 10 (Rreth 5% që kanë mbetur nga viti I kaluar);
- Mirëmbajtja e sistemit telefonik VOIP, si dhe gjenerimi i faturave mujore të sistemit telefonik;
- Ofrimi i përkrahjes teknike ditore për klientë nga tavolina ndihmese;
- Përmirësim i sistemit për rikthim të shënimeve dhe serverëve virtualë;
- Instalimi dhe konfigurimi i pajisjes së re Dell EMC Unity XT 380 për ngritjen e kapacitetit të hapësirës në disqe;
- Instalimi dhe konfigurimi i pajisjes Quantum Superloader 3 LTO8 1/16 për ruajtjen dhe rikthimin e shënimeve përmes kasetave (Tape backup and restore).

Njësia e Arkivit:

- Regjistrimi dhe arkivimi i dokumentacionit të Departamenteve dhe Njësive të ndryshme të AKP-së, gjithsej **2374** regjistratorë;
- Futja e të dhënave në softuerin e Arkivit për regjistratorët e skanuar, regjistruar dhe arkivuar;
- Arkivimi elektronik i **171** vendimeve të DM-së;

- Regjistrimi dhe arkivimi i **21** kontratave të Shitjes;
- Kërkesat për sigurimin e kopjes së kontratës (të noterizuar) të Privatizimit, gjithsej 6 kërkesa;
- Regjistrimi, skanimi dhe arkivimi i **3** librave të Protokollit;
- Ofrim i ekzaminimit të dokumentacionit arkivor, Departamenteve/Njësive të AKP-së, gjithsej **83** kërkesa;
- Përgatitja e projektit për “Rregullimin e Lëndës Arkivore dhe dorëzimin në Arkivin kompetent “për Ndërmarrjet Shoqërore në Likuidim;
- Fillimi i projektit në Regionin e Prishtinës, Mitrovicës dhe pjesërisht në Prizren;
- Realizimi i rreth 35% të punëve të projektit për “Rregullimin e lëndës arkivore dhe përgatitjen për dorëzimin në Arkivin kompetent” për Ndërmarrjet Shoqërore në Likuidim të ZR Prishtinë;
- Realizimi i rreth 30% të punëve të projektit për “Rregullimin e lëndës arkivore dhe përgatitjen për dorëzimin në Arkivin kompetent” për Ndërmarrjet Shoqërore në Likuidim të ZR Mitrovicë;
- Realizimi i rreth 15% të punëve të projektit për “Rregullimin e lëndës arkivore dhe përgatitjen për dorëzimin në Arkivin kompetent “për Ndërmarrjet Shoqërore në Likuidim të ZR Prizren.

Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme:

- Kemi bërë të gjitha riparimet e kërkuara si brava, cilindra, rregullime të dyerve dhe dritareve, riparimet sanitare, si dhe riparimet e vogla elektrike, varësisht ku është shfaqur nevoja si në Zyrën Qendrore, po ashtu edhe në Zyrat Rajonale të AKP-së, që në total janë 227 aktivitete të ndërmarra të asaj natyre;
- Lëvizje dhe rimodelim të zyrave sipas nevojave të paraqitura, gjithsej 45 raste;

- Janë protokolluar 519 fatura, të cilat janë përcjellë në Departamentin e Financave, prej tyre janë futur në SIMFK 350 Raporte;
- Kemi mbuluar 474 kërkesa për furnizim me material administrativ dhe higjienik;
- Kemi iniciuar deklarata të nevojave sipas planifikimeve të bëra, si dhe kërkesave për nevoja të ndryshme të AKP-së në përmbushjen e objektivave logjistike dhe atyre të shërbimeve;
- Kemi organizuar përgatitjet logjistike dhe teknike për të gjitha takimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së;
- Asistimi dhe mbështetja në të gjitha valët e Shitjes-Privatizimit;
- Kemi pasur disa takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe me operatorë ekonomikë që kanë kryer punët në objektin e ri për problemet e shfaqura rreth punëve të kryera dhe rregullimet e tyre sipas kontratës dhe garancionit, të cilat edhe janë realizuar.

Njësia e Transportit:

- Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 693 kërkesa për shërbime të rregullta të transportit dhe 1083 shërbime-kërkesa tjera, të cilat janë mbuluar po ashtu, duke përfshirë larjen e veturave, rimbushja, kontrollimi i tyre, dërgimi i stafit me kërkesa dhe kërkesa urgjente sipas nevojës në vende të ndryshme dhe neper zyra rajonale, si dhe dërgimi dhe sjellja e drejtorëve të Bordit në takimet e ndryshme, dërgimi i dokumenteve në shtëpitë e tyre etj;
- Gjatë kësaj periudhe janë servisuar 29 vetura dhe është bërë ndërrimi i gomave dhe regjistrimi i tyre;
- Angazhim në valët e shitjes dhe rastet e intervenimeve në lirim të aseteve;
- Janë iniciuar 2 deklarata të nevojave pas analizave, hulumtimeve dhe kërkesave për nevoja të Njesisë së Transportit.

13. DEPARTAMENTI I FINANCEVE DHE BUXHETIT

Tabelat e paraqitura më poshtë janë një ekstrat i raporteve që janë marrë nga pasqyrat financiare për Buxhetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Fondeve në Mirëbesim. Pasqyrat financiare së bashku me shënimet shpjeguese janë në shtojcën e këtij raporti. Pasqyrat financiare për Buxhetin e AKP'së të dorëzuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve janë sipas formatit të përcaktuar me rregulloren në fuqi të

Departamenti i Thesarit, MFPT. Ndërsa pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim janë në pajtim me rregulloren e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Të gjitha aktivitetet e Departamentit të Financave dhe Buxhetit janë shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për Buxhetin e AKP-së dhe Fondet në Mirëbesim.

13.1 FINANCIMI I AKTIVITETEVE OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-së

Buxheti i AKP'së për vitin 2022 është financuar nga granti i përgjithshëm qeveritar.

Përshkrimi	Buxheti Origjinal (Ligji Nr. 08/L-066)	Buxheti i Rishikuar Gjysmë-vjetor	Buxheti përfundimtar pas shkurtesave nga Qeveria	Pagesat	%	%
	A	b	c	d	e=d/a	f=d/c
Gjithsej	5,533,002	5,533,002	6,237,675	5,944,598	107%	95%
Pagat dhe mëditjet	4,190,798	4,190,798	4,930,471	4,926,016	118%	100%
Mallrat dhe Shërbimet	1,169,204	1,169,204	1,144,204	883,787	76%	77%
Shpenzimet Komunale	98,000	98,000	123,000	100,680	103%	82%
Subvencione dhe Transferet	5,000	5,000	5,000	-	0.00%	0.00%
Investimet Kapitale	70,000	70,000	35,000	34,115	49%	97%

13.2 PROCESI I FONDEVE NË MIRËBESIM – NDËRMARRJET SHOQËRORE

	2003 deri me 31 dhjetor 2021	Periudha 1 janar 31 dhjetor 2022	2003 deri me 31 dhjetor 2022
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE			
Të hyrat nga shitjet	777,571,140	6,152,060	783,723,200
Të hyrat nga qiraja	52,630,084	4,842,279	57,472,363
Interesi i fituar	34,844,700	-	34,844,700
Tarifa për pjesëmarrje në tenderët e shitjes dhe konfiskimet e BID depozitave	8,880,964	111,501	8,992,465
BID depozitat e ofertuesve	-	211,000	211,000
Të hyra të tjera	7,600,934	181,834	7,782,768
Kapitali themeltar i Agjencisë	1,013,200	-	1,013,200
GJITHSEJ PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	882,541,022	11,498,674	894,039,696

PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË				
20% i punëtorëve transferuar në BSPK		153,553,607	6,673,827	160,227,434
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)		16,976,357	429,900	17,406,257
Mallra dhe shërbime		22,359,173	1,800,553	24,159,726
Shërbime publike		3,054,983	206,836	3,261,819
Tatimet		11,157,824	819,098	11,976,922
Taksa/depozita të Gjykatave dhe vendimet e gjykatave/përmbauesve		3,123,978	5,366,632	8,490,610
Transferimi i mjeteve 5% për aktivitetet e AKP-së		45,777,947	-	45,777,947
Shpenzimet tjera		858,303	13,478	871,781
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-ve		42,708,400	15,070,985	57,779,385
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës		398,233,741	-	398,233,741
GJITHSEJ PAGESAT/SHPERNDARJA		697,804,313	30,381,309	728,185,622
<i>gjendja në llogaritë bankare</i>		<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>2022</u> <u>Hyrje/Dalje</u>	<u>31 dhjetor 2022</u>
BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE		184,736,709	(18,882,635)	165,854,074

Të dhënat të paraqitura më lartë, paraqesin rezultat e pranimeve dhe pagesave në llogaritë

bankare të NSh've, të cilat AKP-ja i administron në Bankën Qendrore të Kosovës.

14. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Në Departamentin e Prokurimit gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2022 janë nënshkruar 28 kontrata duke përdorur procedurat e prokurimit në vijim:

- Procedurë e hapur- janë zhvilluar gjithsej 7 aktivitete të prokurimit dhe vlera e tyre arrin shumën: 195,406.58€
- Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë - janë zhvilluar gjithsej 10 aktivitete të prokurimit dhe vlera e tyre arrin shumën: 323,510.00€
- Procedurë e kuotimit të çmimeve- janë zhvilluar gjithsej 9 aktivitete të prokurimit dhe vlera e tyre arrin shumën: 23,980.39€

Procedurë për kontrata me vlerë minimale - janë zhvilluar 2 procedura dhe vlera e tyre arrin shumën: 1,305.00€.

Me poshtë gjeni ndarjen e kontratave sipas kategorive:

- **Kontratë për shërbime** - janë realizuar gjithsej 12 kontrata.
- **Kontratë për furnizime** - janë realizuar gjithsej 14 kontrata.
- **Kontrate për punë** - janë realizuar gjithsej 2 kontrata.

15. DEPARTAMENTI I KOMISIONEVE PROFESIONALE

Gjatë periudhës raportuese Janar - Dhjetor 2022, aktivitetet e Komisionit kanë qenë si në vijim:

Përshkrimi	Janar-Dhjetor 2022
Numri i Listave Fillestare	10
Numri i Listave Finale	15
Numri i përfituesve të 20%	8877
Vlera e përfituar	6,675,867.98
Numri i vendimeve të DHPGJSK	3
Numri i ankesave të shqyrtuara	520
Ankesa të aprovuara	233
Numri i kërkesave të shqyrtuara në Komisionin e Banesave	187
Numri i kërkesave të aprovuara në KB	161
Numri i kërkesave të refuzuara në KB	12
Numri i kërkesave për të cilat KB nuk është kompetente	14
Kontrata për shitjen e Banesave të nënshkruara	84
Numri i kërkesave të dorëzuara tek SHA Trepça	190
SDR të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve	5
Bilanci i pagesave	6,673,827

16. NJËSIA E NEGOCIMIT DIREKT (NJND)

- Gjatë periudhës raportuese NJND ka pezulluar veprimtarin e vet me vendim të Bordit të Drejtorëve, me qëllim të krijimit të strukturës të re të akteve nënligjore të Agjencisë të cilat ndërliken me procedurat e negociimit direkt;
- Janë mbajtur takimet vazhdueshme të grupit punues brenda Agjencisë me qëllim të ndryshimit dhe të plotësimit të Rregullores për Shitjen direkte të Aseteve me karakter specifik;
- Janë pranuar 67 lëndë për shitje me negociim direkt.

	Treguesit [veprimet]	ZR Prishtinë	ZR Pejë	ZR Prizren	ZR Mitro	ZR Gjilan	Numri i përgjith.
1	TË REGJISTRUARA Numri i përgjithshëm i kërkesave të regjistruara	615	384	745	159	264	2,167
2	TË SHQYRTUARA Numri i përgjithshëm i Raporteve Referuese, të shqyrtuara	310	114	127	57	98	706
3	TË APROVUARA Numri i përgjithshëm i Kërkesave të miratuara në BiD [Raportet Rekomanduese - Baza juridike e negociimit]	178	105	77	57	57	474

4	TË APROVUARA Numri i Rasteve [Kërkesave] të miratuara në Bord [Raportet Përfundimtare - Aprovimi i shitjes]	158	95	60	37	17	367
5	Numri i Kontratave të dorëzuara total	142	83	49	34	16	324
6	Numri i Kontratave në Proces (në pritje të pagesës ose proces të draftimit)	21	16	12	4	1	54
7	Numri i Rasteve [Kërkesave] të Refuzuara në BiD	3	1	/	0	/	4
8	Numri i Rasteve [Kërkesave] të Refuzuara në NND	125	46	25	0	17	213
Të hyrat e përgjithshme të realizuara nga shitjet me negociim direkt		Rreth 9,800,000.00					

17. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën Janar - Dhjetor 2022. Për periudhën raportuese, NJAB ka arritur ti finalizoj 9 auditime të brendshme, duke i ofruar Menaxhmentit rekomandime konkrete.

Në vazhdimësi paraqiten aktivitetet e NJAB-së për periudhën në fjalë:

- Auditimi i Procesit të Qiradhënies së Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore:** Objektivi e këtij auditimi ishin që t'i ofroj Bordit/Menaxhmentit siguri të arsyeshme, se Menaxhimi dhe administrimi i procesit të qiradhënies së asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore bëhet në pajtueshmëri me kërkesat e kornizës ligjore në fuqi. Bazuar në vlerësimin e rrezikut fushat e fokusuar për këtë auditim ishin: vlerësimi i pajtueshmërisë së tenderëve për qiradhënie, pajtueshmëria e kontratave, faturimi, arkëtimi si dhe aktivitetet e kontrollit të pajtueshmërisë. Janë dhënë gjithsejtë 4 rekomandime konkrete për proceset e Qiradhënies së Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;
- Auditimi i Departamentit të Administratës – Njësia e Transportit (NJT):** Objektivi primare e këtij auditimi ishin që t'i ofroj Bordit/Menaxhmentit siguri të arsyeshme, se Menaxhimi me automjetet si dhe shfrytëzimi i tyre bëhet në një ambient të kontrolluar dhe sipas nevojave zyrtare, auditimi është përqendruar në testimin e procedurave rreth kërkesave për automjete, fletudhëtimet mujore, raportet mbi kilometrat e kaluara, kuponët (faturat) e karburanteve dhe dokumentet e nevojshme për verifikimin e servisimit. Janë dhënë gjithsejtë 2 rekomandime konkrete për NJT dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;
- Auditimi i Departamentit të Administratës - Inventarizimi i pasurisë:** Objektivi e këtij auditimi ishin që t'i ofroj Bordit/Menaxhmentit siguri të arsyeshme se Inventarizimi i pasurisë së AKP-së bëhet në pajtueshmëri të plotë me rregullativën ligjore; Inventarizimi si mjet kontrolli për menaxhimin e pasurive jo financiare bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Janë dhënë gjithsejtë 4 rekomandime konkrete për proceset e Inventarizimit të pasurisë dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;
- Auditimi i Departamentit të Administratës – Njësia e Teknologjisë Informative (NjTI):** Objektivat e këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të ndërlidhur me funksionin e Menaxhimit dhe administrimit me infrastrukturën e Teknologjisë Informative. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të përgjithshëm, EA-ja është fokusuar në

auditimin e proceseve si në vijim: sigurinë fizike të softuerit; monitorimin e sigurisë së sistemit; sistemin e backup-it dhe procedurave për restore (kthim); mbarëvajtjen e sistemit dhe vazhdimësisë së punës. Janë dhënë gjithsejtë 4 rekomandime konkrete për NjTI dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;

5. **Auditimi i Njesisë së Negocimit Direkt (NjND):** Qëllimi i këtij auditimi ishte që t'i ofroj Bordit dhe Menaxhmentit siguri të arsyeshme, nëse NjND-ja ka zhvilluar aktivitetin e vet konform legjislacionit dhe procedurave që mbulojnë fushën e shitjes me negociim direkt. Objektivat e këtij auditimi janë bazuar në sistemin e kontrollit të brendshëm se është funksional dhe mbulon mjaftueshëm rrezikun në raport me objektivat e vendosura; Menaxhimi dhe implementimi i procedurave të shitjes përmes negocimit direkt është në pajtueshmëri me kërkesat e kornizës ligjore; Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimet paraprake. Janë dhënë gjithsejtë 3 rekomandime konkrete për NjND dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;
6. **Auditimi i Njesisë Zbatuese të Projektit të Likuidimit (NjZPL):** Qëllimi i këtij auditimi ishte që t'i ofroj Bordit dhe Menaxhmentit siguri të arsyeshme, nëse NjZPL ka zhvilluar aktivitetin e vet konform legjislacionit dhe procedurave që mbulojnë procesin e likuidimit. Përderisa. Objektivat e auditimit kanë për qëllim të ofrojnë siguri të arsyeshme se: Zbatimi i kontratës në mes AKP-së dhe OSHP-së bëhet sipas kushteve të parapara; Puna e Komitetit Drejtues të Likuidimit bazohet në politika dhe procedura të shkruara; Menaxhimi i kontratës bëhet sipas planit; Kontrollat e brendshme janë funksionale dhe mbulojnë mjaftueshëm rreziqet rreth aktiviteteve të NjZPL. Janë dhënë gjithsejtë 4 rekomandime konkrete për NjZPL dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;
7. **Auditimi i Departamentit të Shitjes dhe njësitë përbërëse (Raport me kërkesë të KA/BD):** Qëllimi i këtij auditimi ishte t'i ofroj Bordit siguri të arsyeshme se implementimi i

procedurave të shitjes me tender janë konform legjislacionit dhe procedurave që mbulojnë këtë fushë. Objektiva kryesore e auditimit ka për qëllim të ofrojë siguri të arsyeshme se: Menaxhimi dhe implementimi i procedurave të shitjes, konkretisht metodologjia e përcaktimit të çmimit orientues është në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe objektivat e Agjencisë. Nuk ka rekomandime konkrete për Departamentin e Shitjeve, sepse janë në pajtueshmëri me kërkesat e parapara në procedurat e tenderimit tek neni 5 pika 1. Pra, të gjitha raportet e vizitave në teren të përpiluara nga zyrtarët e rastit me zyrtarin e kadastrit paraqesin gjendjen reale dhe faktike të njësisë-aseteve;

8. **Auditimi i Departamentit të Prokurimit (DP):** Qëllimi i këtij auditimi ishte që t'i ofrojë Bordit/Menaxhmentit siguri të arsyeshme se aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 Nr. 05/L-068, pastaj Rregullores dhe Udhëzuesin Operativ i Prokurimit Publik (janar, 2021) si dhe në interes të përmbushjes së objektivave të përgjithshme të Agjencisë. Objektivat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë, se: Planifikimi i aktiviteteve të prokurimit (inicimi), Zbatimi i procedurave të prokurimit, si dhe Menaxhimi i kontratave janë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Janë dhënë gjithsejtë 3 rekomandime konkrete për DP dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;
9. **Auditimi i Departamentit të Financave dhe Buxhetit (DFB):** Objektivat e këtij auditimi ishin: Planifikimi i Buxhetit është bërë duke u bazuar në kërkesat e njësive organizative të AKP-së (Divizioneve, Departamenteve dhe Zyrrave Rajonale); Shpenzimi i parasë publike është bërë konform Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe Rregullave të Thesarit; Të dhënat financiare, sistemet, transaksionet janë të besueshme dhe në pajtim me ligjet në fuqi. Janë dhënë gjithsejtë 3 rekomandime konkrete për DFB dhe të njëjtat i janë kumtuar edhe Menaxhmentit;

10. Mbajtja e takimeve të Komitetit të Auditimit:


Gjatë periudhës raportuese Komiteti i Auditimit ka mbajtur katër takime, ku janë diskutuar raportet mbi aktivitetet e NjAB-së për periudhën Janar-dhjetor 2022, është aprovuar plani strategjik për vitet 2023-2025 dhe plani i punës së NjAB-së për vitin 2022, ka pasur diskutime mbi numrin e auditimeve dhe përcjelljen e implementimit të rekomandimeve të NjAB-it nga Menaxhmenti, si dhe janë diskutuar çështje tjera që ndërlidhen me kontrollin e brendshëm të Agjencisë;

11. Përgatitja e planit strategjik dhe vjetor të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023: Gjatë periudhës raportuese janë përgatitur Planit strategjik dhe vjetor i punës së NjAB-së për vitin 2023. Ky dokumente, sipas procedurave është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve dhe i është dërguar NJQH në kuadër të MFPT-së;**12. Përgatitja e raporteve mbi aktivitetet e NjAB-it për Njësinë Qendrore Harmonizuese (NJQH):** Duke iu referuar kërkesave ligjore, në

muajin Janar, NjAB ka përgatitur dhe dorëzuar tek NJQH-ja raportet mbi aktivitetet e saj për vitin 2022;

13. Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) për AKP-në nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA): Gjatë periudhës raportuese, Ekipi i Auditimit të ZKA-së ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të AKP-së për vitin 2021. Në muajin Qershor, nga ZKA-ja kemi pranuar raportet finale të auditimit të PVF-ve të AKP-së për vitin 2021. Opinioni i auditorëve është i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore të AKP-së;**14. Përgatitja e Planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2021:** Duke iu referuar kërkesave ligjore, pas pranimi të raportit të auditimit nga ZKA-ja, në bashkëpunim me Menaxhmentin është përgatitur Planit i veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2021. Ky plan, konform procedurave është dorëzuar tek ZKA-ja brenda afateve të përcaktuara ligjore.

18. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT



19. SHTOJCAT E RAPORTIT VJETOR 2022

19.1. LISTA E NDËRMARRJEVE NËN ADMINISTRIM DIREKT;

19.2. LISTA E NDËRMARRJEVE TË LIKUIDUARA;

19.3. PJESA TEKSTUALE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA TË KUVENDIT TË KOSOVËS;

19.4. PJESA TABELARE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCIVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS;

19.5. PASQYRAT FINANCIARE TË BUXHETIT VJETOR TË AGJENCISË;

19.6. PASQYRAT FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM.

19.1. LISTA E NDËRMARRJEVE NËN ADMINISTRIM DIREKT

Nr.	Emri i Ndërmarrjes	Vendi
1	Ndërmarrja Shoqërore “Jatex”	Gjakovë
2	Ndërmarrja Shoqërore “Metaliku-Fabrika e Enëve”	Gjakovë
3	Ndërmarrja Shoqërore “Metaliku”	Gjakovë
4	Ndërmarrja Shoqërore “Inex Sharr Planina Brezovicë”	Brezovicë, Shtërpcë
5	Ndërmarrja Shoqërore “Iliria” ish Izgradnja	Pejë

19.2. LISTA E NDËRMARRJEVE TË LIKUIDUARA GJATË PERIUDHËS JANAR-DHJETOR 2022

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Selia e NSh-së apo asetit në Kosovë	Rajoni AKP	A është NSh (selia në Kosovë) apo aset (selia jashtë Kosovës)	Data e vendosjes në likuidim	Data e pranimit të vendimit të DHP për mbyllje të NSh-së	Numri i vendimit të DHP për mbyllje të NSh-së
1	GJI074	Barnatorja Gjilan (pharmacy)	Gjilan	Gjilan	NSH	16-Nov-07	1-Jul-22	C-IV-18-0076
2	MIT004	KB Bujku	Mitrovicë	Skenderaj	NSH	04-Aug-10	24-Mar-22	C-IV-21-0225
3	MIT164	Ndërmarrja Ndërtimore Ndërtimtari	Mitrovicë	Glogoc	NSH	26-Feb-20	3-Aug-22	C-IV-22-0215
4	PEJ145	Dardania	Pejë	Pejë	NSH	18-Sep-07	15-Apr-22	C-IV-21-0234

19.3. PJESA TEKSTUALE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA TË KUVENDIT TË KOSOVËS



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

- Raporti Financiar për vitin 2022 -

Kodi i Organizatës Buxhetore: 239

Informatat kontaktuese:

Zyrtari Kryesor Administrativ: Aarben Limani - Drejtor Menaxhues
Rr. Dritan Hoxha Nr. 55, 10000 Prishtinë , Tel, 038 500 400 E-mail: Arben.Limani@pak-ks.org

Zyrtari Kryesor Financiar: Adem Selishta, Drejtor i Financave dhe Buxhetit,
Rr. Dritan Hoxha Nr. 55, 10000 Prishtinë , Tel, 038 500 400 E-mail: adem.selishta@pak-ks.org

Data: 27.02.2023

1) Hyrje:

Në mungesë të mjeteve nga tarifa e të Hyrave të Dedikuara buxheti i AKP-së për vitin 2022 është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Buxheti fillestar i AKP-së për vitin fiskal 2022, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, është në vlerën prej EUR 5,533,002.00, ndërsa buxheti përfundimtar, pas kursimeve dhe ndërrimeve në buxhet që kemi pasur në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe buxhetit shtesë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve është në vlerën prej EUR 6,237,675.

Realizimi përfundimtar i buxhetit të vitit 2022 është gjithsej 95.30 %.

Teprica e buxhetit të pa shpenzuar është EUR 293,076.87 dhe kryesisht i dedikohet linjave të mëposhtme:

1. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda dhe jashtë institucionit;
2. Shërbimet e arsimit dhe trajnimit;
3. Derivate dhe lëndë djegëse (naftë për ngrohje qendrore, derivate për gjenerator, karburant dhe vaj për vetura;
4. Sigurimi i ndërtesave dhe tjera (bombolat e zjarrit, rrufeja, vërshimet, kutitë e ndihmës së parë, shenjat e të tjera);
5. Shpenzimet për informim publik;
6. Shërbime Kontraktuese Tjera - Ofrues të shërbimeve profesionale për Trepçën (Për NSH-të që janë nën Administrim Direkt).

2) Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve:**a) Të hyrat:**

Buxheti përfundimtar i AKP-së (pas kursimeve buxhetore nga AKP-ja dhe vendimeve të Qeveria) për vitin fiskal 2022 është gjithsej EUR 6,237,674.75 dhe është financuar vetëm nga Granti Qeveritar.

Gjatë vitit fiskal 2022 nuk ka pasur proces të rishikimit të buxhetit gjysmë-vjetor përmes së cilit do të kishim evidentuar kursimet buxhetore, megjithatë duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) për përmbylljen e vitit fiskal 2022, në muajin tetor, AKP ka identifikuar kursime në vlerë prej EUR 169,811, ku përmes shkresës zyrtare ka njoftuar MFPT duke kërkuar që shuma e kursimeve të reduktohet nga buxheti i Agjencisë, mirëpo pavarësisht kërkesës së AKP-së, nga MFPT është reduktuar vetëm buxheti për kursimet e shpenzimeve kapitale në vlerë prej EUR 35,000, ndërsa shuma e mbetur nga kursimet e prezantuara prej EUR 134,881 nuk është reduktuar nga buxheti i AKP-së

Nevojë për buxhet shtesë kemi pasur në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në vlerë prej EUR 739,673.00.

Ky buxhet është aprovuar me dy vendime të Qeverisë në muajin nëntor dhe dhjetor 2022.

1. Sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 05/110 të datës 29.11.2022, shuma prej EUR 315,068.
2. Sipas Vendimit të Qeverisë 04/115 të datës 23 dhjetor 2022, shuma prej EUR 424,605.

b) Pagat dhe mëditjet:

Numri i punëtorëve dhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve i aprovuar sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2022 është 257.

Në numrin e përgjithshëm sipas Ligjit të buxhetit janë të përfshirë edhe tetë (8) Anëtarë të Bordit të Drejtorëve.

Kompensimi i Anëtareve të Bordit të AKP-së, Tatimet dhe Kontributet e këtyre pagesave realizohen nga kodi ekonomik punëtoret me kontratë jo në listën e pagave (11400).

Buxheti i shpenzuar për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për vitin 2022 është në vlerën EUR 215,669.

Nga numri i përgjithshëm në listën e pagave në fund të vitit fiskal 2022 janë 230 nëpunës. 12 nëpunës kanë dhënë dorëheqje dhe këto pozita ende nuk janë mbuluar, ndërsa për 7 nëpunës është lejuar pezullim i dakorduar i marrëdhënies së punës.

Pagat dhe mëditjet e zyrtareve të AKP-së sipas listës së pagave procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë Divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

Shpenzimet për Pagat Bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së për vitin 2022 janë gjithsej EUR 4,926,016.48.

Në Pagat Bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së është e përfshirë edhe shuma prej EUR 93,295 e cila i dedikohet Vendimeve Gjyqësore-të formës së prerë.

Më datën 4 shkurt 2022, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar aktvendimin të formë së prerë me nr. PKR. 51/20 nga Gjykata Themelore për parashkrim absolut të rastit/lëndës.

Sipas këtij aktvendimi, kërkohet kompensimi i pagave prej 50% për të cilat është bërë ndalesë në pagë përderisa ishin në procedurë gjyqësore.

Ndalesat në pagë prej 50% janë bërë nga muaji prill 2014 deri në pagat e muajit 31 mars 2022 sipas nenit 69 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-149 të Ligjit për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës dhe sipas vendimit të AKP-së me datën 06 maj 2014 është shqiptuar masa e pezullimit parandalues me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbyesit Civil dhe bazuar në nenin 58 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publik si dhe në zbatim të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e obliguar të bëjë kompensimin e rrogës së pezulluar prej 50% për zyrtarin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit z. A. K. nga data 30 prill 2014 – 31 mars 2022 në shumën prej EUR 93,295.74.

Këto obligime kanë qenë të paraqitura edhe në detyrimet kontingjente në pasqyrat financiare 2021.

Realizimi i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 99.91%.

c) Mallra dhe Shërbime:

Buxheti i aprovuar fillestar nga Granti Qeveritar (GQ) për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” ka qenë EUR 1,169,204.00, ndërsa buxheti përfundimtar i AKP-së për kategorinë Mallra dhe Shërbime për vitin fiskal 2022 është gjithsej EUR 1,144,204.00.

Fondet e aprovuara në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime kanë qenë të destinuara për:

- Për të mbuluar shpenzimet për shërbimet operative dhe administrative, që të arrihen objektivat e parapara të Agjencisë sipas Ligjit.
- Mbulimin e shpenzimeve të procesit të Privatizimit dhe Likuidimit.
- Për të mbështetur në aspektin ligjor procesin e privatizimit dhe likuidimit.

Gjatë implementimit të buxhetit nga kjo kategori kemi pasur transfer të mjeteve në vlerë prej EUR 25,000 në kategorinë ekonomike të Shërbimeve komunale.

Realizimi i buxhetit për kategorinë mallra dhe shërbime është gjithsej 77%. Në përgjithësi për kategorinë mallra dhe shërbime, sikur kërkesa e AKP-së për kursimet e identifikuar dhe të deklaruara me shkresë në Departamentin e Buxhetit, MFPT të ishte marr në konsideratë, përqindja e në këtë kategori do të ishte më e lartë 89%.

d) Shpenzime komunale:

Për periudhën raportuese, buxheti fillestar i aprovuar për shërbime komunale ka qenë EUR 98,000.00 ndërsa buxheti final është EUR 123,000.00 dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Dallimi në mes këtyre dy shumave vjen si rezultat i transferit të shumës prej EUR 25,000 nga kategoria Mallra dhe Shërbime.

Transferi sipas kërkesës së AKP-së është aprovuar nga MFPT gjatë përmbylljes së vitit fiskal në muajin nëntor.

Arsyeja e kërkesës ka qenë se me kalimin e AKP-së në objektin e ri janë rritur shpenzimet komunale duke shfrytëzuar për herën e parë edhe shërbimet e Termokosit.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 81.85%.

e) Investimet Kapitale:

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar fillestar për shpenzime kapitale ka qenë EUR 70,000.00 ndërsa buxheti final është EUR 35,000.00, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Mjetet kanë qenë të destinuara për dy projekte kapitale:

1. Blerja e pajisjeve të TI-së për ngritjen e cilësisë të shërbimeve, vlera EUR 35,000.
2. Data baza (Softuer) për menaxhimin e lëndëve gjyqësore të Departamentit Ligjor, vlera EUR 35,000.

Dallimi në mes buxhetit fillestar dhe atij final është rezultat i kursimit buxhetor të shumës prej EUR 35,000 për projektin kapital Data baza (Softuer) për menaxhimin e lëndëve gjyqësore të Departamentit Ligjor.

Arsyeja e anulimit të projektit është sepse AKP ka vendosur që data baza aktuale të mirëmbahet dhe të mos investohet në projekt të ri kapital.

Kursimi është prezantuar pranë MFPT gjatë përmbylljes së vitit fiskal në muajin tetor 2022 dhe si i tillë është reduktuar nga Buxheti i Agjencisë.

Projekti për blerjen e pajisjeve të TI-së për ngritjen e cilësisë të shërbimeve është realizuar dhe mbetja e buxhetit të pa shpenzuar është EUR 885.00.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 97.47%.

f) Subvencionet dhe Transferet:

Për periudhën raportuese, buxheti i fillestar për subvencione dhe transfere është EUR 5,000.00, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Buxheti ka qenë i planifikuar për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit.

Edhe këtë vit fiskal AKP për të mos shfrytëzuar buxhetin e Kosovës për çështje të NSh-ve, ka shfrytëzuar mjetet të cilat janë akumuluar në llogaritë e këtyre NSh-ve apo për ato NSh që nuk kanë të hyra është shfrytëzuar përkohësisht mjetet nga llogaria e Tarifës Administrative.

Andaj, buxheti i aprovuar nuk ka mundur të shpenzohet dhe si i tillë është identifikuar si kursim buxhetor ku gjatë përmbylljes së vitit fiskal në muajin tetor kemi kërkuar nga MFPT të reduktohet nga buxheti i Agjencisë, mirëpo pavarësisht kërkesës, kursimi nuk është zbritur nga buxheti.

3) Përmbledhje:

Buxheti fillestar i AKP-së për vitin fiskal 2022, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, është në vlerën prej EUR 5,533,002.00, ndërsa buxheti përfundimtar pas ndërrimeve në buxhet është në vlerën prej EUR 6,237,675. Për arsye të mungesës së mjeteve në tarifën e të Hyrave të Dedikuara është kërkuar që buxheti të financohet vetëm nga Granti Qeveritar.

Realizimi përfundimtar i buxhetit është gjithsej 95.30%.

Gjatë implementimit të buxhetit kemi pasur nevojë për buxhet shtesë në kategorinë e pagave e cila ka ardhur si rrjedhojë e arsyeve më poshtë të llastuara:

Kërkesa buxhetore në kategorinë e pagave për vitin 2022, e dërguar në Ministrinë e Financave për aprovim ka qenë e planifikuar për realizimin e pagave të stafit të AKP-së me zbritje të pagave deri në 30%.

Kërkesa është planifikuar ashtu për arsye se Bordi i Drejtorëve të AKP-së me vendimin nr. BD-153/9 të datës 29.10.2021, ka marrë vendim për zbritje të pagave të stafit të AKP-së deri në 30% të buxhetit me efekt nga data 01.04.2022 dhe është bërë plotësim/ ndryshimi i Rregullores së Pagave.

Pas këtij vendimi një pjese e stafit është ankuar në Këshillin i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK). Po ashtu nga një pjesë e stafit, ankesë kishte dorëzuar edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës – tutje DHPGJSK.

Andaj, duke pasur parasysh këtë situatë Bordi i Drejtorëve të AKP-së mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2022 ka pezulluar Implementimin e pagave me zbritje deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga KPMSHCK. Rrethanat e reja të krijuara kanë rezultuar me mungesën e mjeteve në kategorinë e pagave dhe për realizimin e pagave sipas kontratave ekzistuese të stafit të AKP-së deri në fund të vitit fiskal 2022, AKP ka parashtruar kërkesë për mjete shtesë të cilat MFPT i ka aprovuar dhe alokuar në dy pjesë për ti mbuluar pagat e muajit nëntor dhe dhjetor 2022.

Shuma e mjeteve shtesë e aprovuar/alokuar nga MFPT është EUR 739,673.00.

Vlen të theksohet se bazuar në Vendimet e fundit të KPMSHCK sipas të cilave “refuzohen si të pabazuara ankesat e punonjësve të Agjencisë dhe mbetet në fuqi Vendimi Nr. Ref. BD-153/9 i datës 29 Tetor 2021”. Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur më datë 23 dhjetor 2022 ka marrë Vendim për hyrjen në fuqi të Rregullores Nr. 2/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së pagave të nëpunësve të Agjencisë nga data 1 Janar 2023.

Pagat e stafit të AKP-së nga data 1 janar 2023 realizohen me zbritje deri në 30%.

Arben Limani, Drejtor Menaxhues

Agjencia Kosovare e Privatizimit

PJESA TABELARE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

4) TABELAT

a) Të hyrat

Kodi ekonomik	Emri i kategorisë ekonomike	Të hyrat e planifikuara/parashikuara për vitin 2022	Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2021	Të hyrat aktuale në vitin 2022
1	2	3	4	5
11000	Pagat dhe meditet	4,926,016	-	4,926,016
13000	Mallrat dhe Sherbimet	883,787	-	883,787
13200	Sherbimet publike	100,680	-	100,680
21000	Transferet dhe Subvencionet	-	-	-
30000	Shpenzimet kapitale	34,115	-	34,115
	GJITHSEJ	5,944,598	-	5,944,598

Buxheti i paraqitur më lartë është ndarja buxhetore për shpenzim për vitin 2022 dhe i cili është financuar nga Granti Qeveritar.

Agjencia Kosovare e Privatizimit financohet nga të hyrat e dedikuara që ka realizuar nga shitja e aseteve të NSh-ve si dhe të hyrat e tjera. Kjo në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011.

Të hyrat për Agjencinë janë kumulative nga viti 2003 deri në dhjetor 2022. Gjithsej të hyrat janë **EUR 50,249,121**. Nga këto të hyra janë mbuluar shpenzimet si me poshtë:

- për mbulimin e shpenzimeve operative dhe administrative të AKP nga viti 2012. Gjithsej mjetet e transferuara në Qeveri për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe operative deri më 31 dhjetor 2022 janë **EUR 45,777,947**; dhe
- shpenzimet për NSh-të që kanë mungesë të likuiditetit bankar.

AKP-ja **NUK** planifikon të hyra të cilat buxhetohen me kërkesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. AKP-ja planifikon vetëm shpenzimet, të cilat janë prezentuar në tabelën më lartë. Pra, të hyrat nuk planifikohen si në rastin e komunave, meqenëse siç kemi shpalosur në shpjegimin më lartë, të hyrat e AKP-së janë kumulative nga viti 2003 e tutje sipas nenit 21 të Ligjit të AKP-së, i cili ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011.

Të hyrat e realizuara gjatë vitit 2022 janë **EUR 2,307,205** nga shitjet e aseteve të NSh-ve përmes valëve të privatizimit, 5% e të hyrave nga qiraja dhe të hyrave tjera të tilla si: tarifa për pjesëmarrje në tender si dhe konfiskimet e BID depozitave për ofertuesit të cilët nuk kanë përmbushur kushtet e përcaktuara.

Agjencia Kosovare e Privatizimit

b) Shpenzimet

Kodi ekonomik	Kategoria ekonomike	Buxheti dhe shpenzimet 2021			Buxheti vjetor me ligjin e buxhetit 2022	Buxheti Janar - Dhjetor 2022	Shpenzimet deri me 31 Dhjetor 2022	Zotimet deri më 31 Dhjetor 2022	Buxheti i zotuar (%)	Buxheti i shpenzuar (%)	Buxheti i pa shpenzuar (%)
		Buxheti 2021	Shpenzimet 2021	% e shpenzi meve							
1	2	3			4	6	7	8	9=8/6	10=7/6	11
11000	Pagat dhe mëditjet	5,350,209	5,348,022	99.96%	4,190,798	4,930,471	4,926,016	4,926,020	99.91%	99.91%	0.09%
13000	Mallra dhe shërbime	1,176,426	1,079,742	91.78%	1,169,204	1,144,204	883,787	940,092	82.16%	77.24%	22.76%
13200	Shërbimet publike	64,974	61,419	94.53%	98,000	123,000	100,680	116,122	94.41%	81.85%	18.15%
21000	Subvencione dhe transfere	-	-	0.00%	5,000	5,000	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
30000	Shpenzimet kapitale	43,974	42,749	97.21%	70,000	35,000	34,115	34,115	97.47%	97.47%	2.53%
	GJITHSEJT	6,635,583	6,531,932	98.44%	5,533,002	6,237,675	5,944,598	6,016,349	96.45%	95.30%	4.70%

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Mallra dhe Shërbime

4c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2020			Buxheti 2021		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2020	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2020	% e shpenzim eve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2021	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2021	% e shpenzim eve
	Gjithsej	1,514,760	1,367,926	90%	1,176,426	1,079,742	92%

1310	SHPENZIMET E UDHËTIMIT (NËNTOTALI)	-	-	0%	-	-	0%
13130	Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13131	Meditja e udhimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13132	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13133	Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13140	Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar jasht vendit	-	-	-	-	-	-
13141	Meditja e udhimit zyrtar jasht vendit	-	-	-	-	-	-
13142	Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jasht vendit	-	-	-	-	-	-
13143	Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jasht vendit	-	-	-	-	-	-

1330	SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT (NËNTOTALI)	42,800	37,545	88%	31,886	30,598	96%
13310	Shpenzimet per internet	19,300	19,286	100%	16,000	15,789	99%
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	17,500	17,442	100%	15,366	14,294	93%
13330	Shpenzimet postare	6,000	817	14%	520	515	99%
13340	Shpenzimet e përdorimit të kabllit optik	-	-	-	-	-	-

1340	SHPENZIMET PER SHËRBIME (NËNTOTALI)	740,720	664,932	90%	342,460	337,745	99%
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	100	100	100%	1,250	1,234	99%
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures	100	100	100%	-	-	-
13430	Shërbime te ndryshme shendetësore	-	-	-	-	-	-
13440	Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	420	322	77%	-	-	-
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	1,000	974	97%	1,390	1,384	100%
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	725,600	659,385	91%	327,350	327,302	100%
13470	Shërbime Teknike	13,500	4,051	30%	12,470	7,825	63%
13480	Shpenzimet për Antarësim	-	-	-	-	-	-

1350	BLERJE E MOBILIEVE DHE PAISJEVE (ME PAK SE 1000 EURO) (NËNTOTALI)	23,700	22,207	94%	155,750	143,236	92%
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	-	-	-	120,150	120,111	100%
13502	Telefona (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13503	Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	12,700	12,650	100%	-	-	-
13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	7,300	7,209	99%	35,000	22,535	64%
13505	Makina fotokopjuese (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13506	Pajisje speciale mjeksore (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13507	Pajisje te shërbimit policor (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13508	Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	3,700	2,348	63%	600	590	98%

1360	BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHËRBIME (NËNTOTALI)	33,000	29,385	89%	25,450	24,575	97%
13610	Furnizime për zyrë	15,000	13,523	90%	8,850	8,085	91%
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	8,000	7,598	95%	7,900	7,869	100%
13630	Furnizime mjekësore	3,000	1,560	52%	-	-	-
13640	Furnizime pastrimi	7,000	6,704	96%	4,800	4,796	100%
13650	Furnizim me veshmbathje	-	-	-	3,900	3,825	98%
13660	Akomodimi	-	-	-	-	-	-
13670	Municion dhe armë zjarri	-	-	-	-	-	-
13680	Tiketatat siguruese(banderollat)	-	-	-	-	-	-
13681	Blloqat	-	-	-	-	-	-

1370	DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE (NËNTOTALI)	54,340	54,286	100%	60,050	52,048	87%
13710	Vaj	-	-	-	-	-	-
13720	Nafte për ngrohje qendrore	36,740	36,701	100%	44,000	35,998	82%
13730	Vaj për ngrohje	-	-	-	-	-	-
13740	Mazut	-	-	-	-	-	-
13750	Qymyr	-	-	-	-	-	-
13760	Dru	-	-	-	-	-	-
13770	Derivate për gjenerator	820	820	100%	-	-	-
13780	Karburant për vetura	16,780	16,765	100%	16,050	16,050	100%

Agjencia Kosovare e Privatizimit

4.d) SHPENZIMET KOMUNALE: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2021			Buxheti 2022		
		Planifi- kimi Janar - Dhjetor 2021	Shpenzi- met Janar - Dhjetor 2021	% e shpenzi- meve	Planifi- kimi Janar - Dhjetor 2022	Shpen- zimet Janar - Dhjetor 2022	% e shpenzi- meve
	Gjithsej	64,974	61,419	95%	123,000	100,680	82%
1320	SHPENZIME KOMUNALE (NENTOTALI)	64,974	61,419	95%	123,000	100,680	82%
13210	Rryma	52,805	50,172	95%	51,300	46,404	90%
13220	Uji	2,722	2,122	78%	3,600	1,290	36%
13230	Mbeturinat	3,316	2,994	90%	3,500	2,817	80%
13240	Ngrohja qendrore	-	-	0%	57,600	44,326	77%
13250	Shpenzimet telefonike	6,131	6,131	100%	7,000	5,843	83%

Agjencia Kosovare e Privatizimit

4.e) INVESTIMET KAPITALE: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

30000	INVESTIMET KAPITALE	Buxheti 2021			Buxheti 2020		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2020	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2020	% e shpenzi meve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2021	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2021	% e shpenzi- meve
	Gjithsej	43,974	42,749	97%	35,000	34,115	97%
3110	NDËRTESAT (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31110	Ndertesat e banimit	-	-		-	-	
31120	Ndertesat administrative afariste	-	-		-	-	
31121	Objektet arsimore	-	-		-	-	
31122	Objektet shendetesore	-	-		-	-	
31123	Objektet kulturore	-	-		-	-	
31124	Objektet sportive	-	-		-	-	
3120	NDËRTIMI I RRUGËVE (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31210	Ndërtimi i auto rrugëve	-	-		-	-	
31220	Ndërtimi i rrugëve regionale	-	-		-	-	
31230	Ndërtimi i rrugëve lokale	-	-		-	-	
31240	Trotualet	-	-		-	-	
31250	Kanalizimi	-	-		-	-	
31260	Ujësjellësi	-	-		-	-	
3150	FURN.ME RRYME, GJENERIMI (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31510	Furnizim me rrymë gjenerim dhe transmision	-	-		-	-	
3160	PAISJE (SIST.VLERA MBI 1000 EURO) (NENTOTALI)	43,974	42,749	97%	35,000	34,115	97%
31600	Pajisje të Teknologjise Informative(ne vlere mbi 1000 euro)	-	-		-	-	
31610	Pajisje të Teknologjise Informative	43,974	42,749	97%	35,000	34,115	97%
31620	Mobilje	-	-		-	-	
31630	Telefona	-	-		-	-	
31640	Kompjuter	-	-		-	-	
31650	Makina Fotokopjuese	-	-		-	-	
31660	Pajisje Speciale Mjeksores	-	-		-	-	
31670	Pajisje te Shërbimeve Policore	-	-		-	-	
31680	Softver	-	-		-	-	
31690	Pajisje Tjera	-	-		-	-	

3170	AUTOMJETE TRANSPORTI (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31700	Vetura zyrtare	-	-		-	-	
31701	Kamionë	-	-		-	-	
31702	Xhip dhe kombibusë	-	-		-	-	
31703	Vetura të ndihmës së shpejtë	-	-		-	-	
31704	Veturat e shërbimit policor	-	-		-	-	
31705	Motorë	-	-		-	-	
31706	Automjete transporti tjera	-	-		-	-	

3180	MAKINERIA (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31800	Makineria	-	-		-	-	

3190	KAPITAL TJETËR (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31900	Kapital tjetër	-	-		-	-	
31910	Avans për investime	-	-		-	-	

3200	INVESTIMET NË VIJIM	-	-		-	-	
32000	Investimet në vijim	-	-		-	-	

3210	TOKA (NENTOTALI)	-	-		-	-	
32100	Toka	-	-		-	-	

3220	PASURITË E PAPREKSHME (NENTOTALI)	-	-		-	-	
32200	Pasuri e paprekshme	-	-		-	-	

3310	TRANSF.KAPITALE-ENTITETE (NENTOTALI)	-	-		-	-	
33100	Trans.kap.-entitetet publike	-	-		-	-	

Agjencia Kosovare e Privatizimit

4.f) SUBVENCIONET DHE TRANSFERET: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

21000	Subvencione dhe Transfere Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2021			Buxheti 2022		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2020	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2020	% e shpenzi- meve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2021	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2021	% e shpenzi- meve
	Gjithsej	-	-	#DIV/0!	-	-	

2100	SUBVENCIONET	-	-		-	-	
21110	Subvencionet per Etnitete Publike	-	-		-	-	
21120	Subvencionet per Etnitete Publike (Teatri Kombëtar)	-	-		-	-	
21200	Subvencionet per Etnitete Jopublike	-	-		-	-	

2200	TRANSFERET	-	-		-	-	
22100	Transfere per qeveri tjera	-	-		-	-	
22110	Unops-projekti i administrates- Agjensioni Kosovar I Pronave	-	-		-	-	
22200	Pagesat për perfitues individual	-	-		-	-	
22210	Pensionet bazë	-	-		-	-	
22220	Pensionet për persona me aftësi te kufizuar	-	-		-	-	
22230	Pensionet e ndihmës sociale	-	-		-	-	
22235	Pensionet e Trupat Mbrojtëse te Kosoves	-	-		-	-	
22240	Pensionet-Kategoria I (për anëtarët e familjeve)	-	-		-	-	
22250	Pensionet-Kategoria II (për anëtarët e familjeve)	-	-		-	-	
22260	Pagesat për Invalidët e luftes	-	-		-	-	
22270	Pagesat për invalidët civilë	-	-		-	-	
22280	Pagesat e familjeve të të rënëve ne luftë	-	-		-	-	
22300	Pagesa-vendime gjyqesore	-	-		-	-	

Agjencia Kosovare e Privatizimit

4.g) PERSONELI DHE STRUKTURA E PAGAVE

Niveli	Pozitat e aprovuara me Ligjin për Buxhet	Pozitat e plotësuara	Buxheti i aprovuar me ligjin për paga dhe meditje	Buxheti i shpenzuar për paga deri më 31 Dhjetor 2022	Totali i pagesave shtesë	Numri i përgjithshëm i të punësuarve që pranojnë pagesa shtesë	a) Orari i punës (orari i plotë/gjysëm orari) dhe b) Të specifikohet lloji i pagesës shtesë
1	2	3	4	5	6	6	8
*Niveli i Bordit	8	8	220,000	215,669	-	-	1 mbledhje në muaj
*pagesat neto ndaj bordit janë EUR 185,454 dhe pjesa tjetër prej EUR 30,215 janë kontribute dhe tatime. Në total EUR 215,669.							
Niveli i menaxhmentit të lartë	3	3	154,357	154,357	-	-	Me orar të plotë
Niveli i menaxhmentit	57	55	1,600,669	1,600,669	-	-	Me orar të plotë
Niveli profesional	172	155	2,853,239	2,853,239	-	-	Me orar të plotë
Niveli mbështetës	17	17	102,083	102,083	-	-	Me orar të plotë
TOTALI	249	230	4,710,348	4,710,348	-	-	Me orar të plotë

1. PERSONELI

Pagesat e realizuara për personelin përfshijnë pagën bruto duke përfshirë edhe 5% e punëdhënësit dhe në total janë EUR 4,710,344.

Nga numri i përgjithshëm në listën e pagave në fund të vitit fiskal 2022 në listën e pagave kanë qenë 230 nëpunës, gjatëviti fiskal kemi pasur nevojë për buxhet shtesë në kategorinë e pagave, kërkesa buxhetore në kategorinë e pagave për vitin 2022 e dërguar në Ministrinë e Financave për aprovim ka qenë e planifikuar për realizimin e pagave të stafit të AKP-së me zbritje të pagave deri në 30%.

Kërkesa buxhetore është planifikuar ashtu për arsye se Bordi i Drejtorëve të AKP-së me vendimin nr. BD-153/9 të datës 29.10.2021, ka marrë vendim për zbritje të pagave të stafit të AKP-së deri në 30% të buxhetit me efekt nga data 01.04.2022 dhe është bërë plotësim/ ndryshimi i Rregullores së Pagave.

Pas këtij vendimi një numër i madh i nëpunësve ka bërë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMISHCK). Po ashtu disa nga nëpunës, ankesë kanë bërë dhe kanë dorëzuar edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës – tutje DHPGJSK.

Andaj, duke pasur parasysh këtë situatë Bordi i Drejtorëve të AKP-së mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2022 ka pezulluar Implementimin e pagave me zbritje deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga KPMISHCK. Rrethanat e reja të krijuara kanë rezultuar me mungesën e mjeteve në kategorinë e pagave dhe për realizimin e pagave

sipas kontratave ekzistuese të stafit të AKP-së deri në fund të vitit fiskal 2022, AKP ka parashtruar kërkesë për mjete shtesë të cilat MFPT i ka aprovuar dhe alokuar në dy pjesë për ti mbuluar pagat e muajit nëntor dhe dhjetor 2022.

Shuma e mjeteve shtesë e aprovuar/alokuar nga MFPT është EUR 739,673.00, sipas Nenit 15.4 të Ligjit të Buxhetit për vitin 2022 e përcakton që: “Në tremujorin e fundit të vitit fiskal Thesari autorizohet të bëjë harmonizimet e nevojshme në kategorinë “Paga dhe Shtesa” në kuadër të OB-ve”.

2. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve mban mbledhje të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit. Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 8 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080;

Kompensimi ndaj Bordit të Drejtorëve të AKP-së janë për gjithsej 18 mbledhje . Gjithsej pagesat për mbledhje të Bordit të Drejtorëve janë EUR 214,767 (përfshirë tatimet dhe kontributet pensionale);

Kompensimi për Komitete të Auditimit janë për katër mbledhje në vlerën e tërësishme prej EUR 9,502 (përfshirë tatimet dhe kontributet pensionale)

3. PAGESA PËR VENDIME GJYQËSORE-TË FORMËS SË PRERË

Po ashtu vlen të përmendet që me vendim të formës së presë të Gjykatës Themelore në Prishtinë janë paguar gjithsej EUR 93,295 për një rast për zyrtarin e AKP-së që kanë qenë në procedurë gjyqësore. Pagesat janë 50% e pagës si kompensim ndaj të cilit është bërë ndalesë mujore për periudhën maj 2014 - mars 2022, periudhë e cila kanë qenë në procedurë gjyqësore. Të gjitha detajet lidhur me këtë rast janë paraqitur në raportin narrativ.

Vlen të theksohet se bazuar në Vendimet e fundit të KPMSHCK sipas të cilave “refuzohen si të pabazuara ankesat e punonjësve të Agjencisë dhe mbetet në fuqi Vendimi Nr. Ref. BD-153/9 i datës 29 Tetor 2021”. Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur më datë 23 dhjetor 2022 ka marrë Vendim për hyrjen në fuqi të Rregullores Nr. 2/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së pagave të nëpunësve të Agjencisë nga data 1 Janar 2023.

Pagat e stafit të AKP-së nga data 1 janar 2023 realizohen me zbritje deri në 30%.

Agjencia Kosovare e Privatizimit

4b2) SHPENZIMET E PAGAVE DHE MEDITJEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

Kodi ekonomik	PAGAT DHE MEDITJET	Shpenzimet në periudhën paraprake 2021	Buxheti deri me 31 Dhjetor 2022	Shpenzimet deri me 31 Dhjetor 2022	Përdindja e shpenzimit ndaj buxhetit [%]
11110	Pagat Neto	4,018,248	3,819,742	3,819,742	100.00%
11500	Tatimi në të ardhurat personale	376,601	357,588	357,588	100.00%
11600	Kontributi Pensional i Punëtorit	231,196	219,861	219,861	100.00%
11700	Kontributi Pensional i Punëdhënësit	231,196	219,861	219,861	100.00%
11400	Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave)	214,737	220,123	215,669	97.98%
11900	Pagesa për Vendime Gjyqësore-të formës së prerë	276,043	93,296	93,296	100.00%
GJITHSEJ PAGAT DHE MEDITJET		5,348,022	4,930,471	4,926,016	99.91%

4b3) PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE SIPAS GRUPEVE TË KODEVE

Kodi ekonomik	MALLERAT DHE SHERBIMET EMRI I GRUPIMEVE TE KODEVE	Shpenzimet në periudhën paraprake 2021	Buxheti deri me 31 Dhjetor 2022	Shpenzimet deri me 31 Dhjetor 2022	Përdindja e shpenzimit ndaj buxhetit [%]
1310	Shpenzimet e udhëtimit	-	9,000	-	
1320	Shpenzime komunale	61,419	123,000	100,680	82%
1330	Shërbimet e telekomunikimit	30,598	44,000	33,716	77%
1340	Shpenzimet për shërbime	337,745	367,000	277,529	76%
1350	Blerje e mobiljeve dhe paisjeve (me pak se 1000 euro)	143,236	29,000	23,815	82%
1360	Blerje tjera - mallra dhe shërbime	24,575	40,000	39,747	99%
1370	Derivatet dhe lëndët djegëse	52,048	64,000	50,982	80%
1380	Llogarite e avansit	1,000	3,000	1,266	42%
1390	Shërbimet financiare	-	-	-	
1395	Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	11,266	12,300	11,238	91%
1400	Mirëmbajtja	44,916	78,000	54,799	70%
1410	Qiraja	408,120	323,000	307,447	95%
1420	Shpenzimet e marketingut	23,659	170,000	78,914	46%
1430	Shpenzimet e përfaqësimit	2,580	5,000	4,323	86%
1440	Shpenzime-vendimet e gjykatave	-	-	-	
1700	Servisimi i borgjit	-	-	-	
GJITHSEJ MALLËRAT DHE SHËRBIMET		1,141,161	1,267,300	984,454	77.68%



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kosovska Agencija za Privatizaciju

RAPORTI VJETOR FINANCIAR

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE	4
RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	6
1.1. POLITIKAT KONTABËL.....	8
1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE.....	8
1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA.....	9
1.4. SHUMAT RAPORTUESE.....	9
1.5. VALUTA RAPORTUESE	9
1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	9
SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT	10
SHËNIMI 2 PAGA DHE SHITESAT	14
2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË.....	15
2.2 SHPALOSJE E PAGESAVE NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË AKP-SË Kodi: “PUNËTORËT ME KONTRATË JO NË LISTËN E PAGAVE”	17
SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME.....	19
3.1 SHPJEGJIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINE MALLRA DHE SHËRBIME DHE KRAHASIME ME VITET PARAPRAKE	21
3.2. SHPALOSJE PËR PAGESAT E REALIZUARA PËR SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA (KODI 13460)	22
SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE.....	23
SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	24
SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE.....	25
SHËNIMI 7 TJERA	26
SHËNIMI 8 TË HYRAT TATIMORE.....	26
SHËNIMI 9 TË HYRAT JO TATIMORE	27
SHËNIMI 10 TË ARDHURAT E DEDIKUARA.....	29
10.1. TË ARDHURAT E DEDIKUARA PËR TË MBULUAR SHPENZIMET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-SË.....	30
SHËNIMI 11 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE	31
SHËNIME TJERA 12	31
SHËNIME 13 PAGESA NGA PALËT E TRETA.....	32
SHËNIMI 16 TË ARKËTUESHMET	32
SHËNIMI 17 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA	33
SHËNIMI 18 DETYRIMET KONTINGJENTE	34
SHËNIMI 19 RAPORT PËR PASURINË JO FINANCIARE.....	38
19.3.1 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)	38
19.3.2 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO)	39

19.3.3 STOQET.....	40
SHËNIMI 20 RAPORT PËR AVANCE E PAARSYETUARA.....	41
SHËNIMI 21 RAPORT PËR TË HYRAT VETANAKE TË PASHPENZUARA.....	41
SHËNIMI 22 RAPORT PËR BILANCET E PASHPENZUARA TË FONDIT ZHVILLIMOR NË MIRËBESIM	42
SHËNIMI 23 RAPORT PËR TË ARDHURAT E DEDIKUARA.....	42
SHËNIMI 24 RAPORT PËR FONDET E DONATORËVE TË PASHPENZUARA	43
SHËNIMI 25 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE.....	43
SHËNIMI 26 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE JASHTË LISTËS SË PAGAVE	44
SHËNIMI 27 RAPORT PËR NUMRIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË VEÇANTA PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE.....	45
SHËNIMI 28 RAPORT PËR GIENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA).....	45

SHËNIMET SHPIJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE

Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në para të gatshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

		2022	2021	2020
	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
	BKK '000	BKK '000	BKK '000	BKK '000
SHËNIME				
BURIMET E FONDEVE - Pranimet				
Granti Qeveritar		5,945	6,532	6,833
Të hyrat vetanake		-	-	-
Të hyrat e dedikuara		-	-	-
Të hyrat nga AKP		-	-	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve		-	-	-
Klauzola e investimeve		-	-	-
Fondi zhvillimor në mirëbesim		-	-	-
GIITHSEJ		5,945	6,532	6,833
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - Pagesat				
Operacionet				
Paga dhe Shtesa	2	4,926	5,348	5,348
Mallra dhe Shërbime	3	884	1,080	1,368
Shpenzime Komunale	4	101	61	50
GIITHSEJ		5,911	6,489	6,766
Transferet				
Transfere dhe Subvencione	5	-	-	33
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	34	43	34
Pagesa tjera	7	-	-	-
GIITHSEJ		5,945	6,532	6,833

SHËNIMET SHPIJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

		Janar – Dhjetor 2022			2021	2020
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi
Shënime		A '000	B '000	C '000	D=B-A '000	F '000
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit						
	8	-	-	-	-	-
	9	1	-	-	-	-
	10	-	-	-	-	-
	11	-	-	-	-	-
	12	-	-	-	-	-
Gjithsej		1	-	-	-	-
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit						
	2	4,926	4,930	4,191	4	5,348
	3	884	1,144	1,169	260	1,368
	4	101	123	98	22	50
	5	-	5	5	5	33
	6	34	35	70	1	34
	7	-	-	-	-	-
Gjithsej		5,945	6,237	5,533	292	6,833

*AKP nuk planifikon të hyra. AKP vetëm depoziton mjetet (Të Hyrat e Dedikuara) në Buxhetin e Përgjithshëm të Kosovës për të mbuluar buxhetin e aprovuar me Ligjin e Buxhetit. AKP, nuk planifikon të hyrat si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Departamenti i Thesarit, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve është kërkuar që të raportohet në këtë mënyrë. Detajet janë të shpalosura në shënimin nr. 10 dhe nr. 23.

1.1. POLITIKAT KONTABËL

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik si dhe rregullores të Ministrisë së Financave të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Rregullorja i përmbush të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës bëhen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit, MFPT.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është një organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit Nr. 04/L-034, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05-/L-080, ligjin Nr. 04/L-115 për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës si dhe ndryshim plotësimin me ligjin Nr. 06/L-023.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t’i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit. Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 8 të ligjit nr. 06/L -023.

Bordi i Drejtorëve ka iniciuar procedurën për konkursin për emërimin e Drejtorit Menaxhues sipas procedurave dhe Ligjit nr. 06/114 për Zyrtarët Publik. Nga ky konkurs me datën 5 Korrik 2022, zgjedh dhe emëron Z. Arben Limanin Drejtor Menaxhues të AKP-së.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura. Raporti vjetor paraqet të gjitha detajet e aktiviteteve dhe informatave financiare dhe jo financiare për vitin fiskal 2022.

Aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh-ve). Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe riorganizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore aty ku paraqitet nevoja deri në përmbylljen e procesit të likuidimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit administron Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në mirëbesim. Si administruese e besuar, AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës të NSh-ve.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Periodha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej **1 janar deri më 31 dhjetor 2022**. Buxheti i AKP-së gjatë periudhës raportuese është financuar nga **Granti Qeveritar (GQ)**.

Të hyrat e Dedikuara (THD) - Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, **janë: Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuarat si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë.**

Granti Qeveritar (GQ) është fondi i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e Agjencisë, nga Granti Qeveritar janë financuar të gjitha aktivitetet administrative dhe operative për vitin fiskal 2022.

1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA

Në zbatim të SNKSP pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.4. SHUMAT RAPORTUESE

Shumat raportuese nga formati i pasqyrave financiare nga shënimin nr. 2 deri te shënimin nr. 15 janë në `000 (mijë) Euro (€) dhe nga shënimin 16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.5. VALUTA RAPORTUESE

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€).

1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare autorizohen në datën e nënshkrimit të deklaratës së Pasqyrave Financiare nga Arben Limani, Drejtor Menaxhues, AKP (Zyrtari Kryesore Administrativ) dhe Adem Selishta, Drejtor i Financave dhe Buxhetit, AKP (Zyrtari Kryesore Financiar).

SHËNIMET SHPIJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT

Ndryshimet e autorizuar nga LMFPP

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuar nga LMFPP						Grand et e donat orëve	Burime tjera të finansi mit	Buxheti përfundimtar SIMFK
	Buxheti Fillestar (Ligji Nr. 08/L-066)	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 05/110	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 03/110	Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 04/115	Të hyrat vetanake	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Hyrrjet									
Të hyrat tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Grandet e përcaktuara të donatorëve	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrjet	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjera	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Daljet									
Paga dhe shtesat	4,191	315	-	424	-	-	-	-	4,930
Mallra dhe shërbime	1,169	-	(25)	-	-	-	-	-	1,144
Shpenzime komunale	98	-	25	-	-	-	-	-	123
Transfere dhe subvencione	5	-	-	-	-	-	-	-	5
Shpenzime kapitale	70	-	(35)*	-	-	-	-	-	35
Kthimi i huamarrjeve	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjerat	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	5,533	315	(35)	424	-	-	-	-	6,237

Më poshtë do paraqesim një shpalosje lidhur me shkurtimet buxhetore dhe kërkesat shtesë nga AKP-ja dhe vendimet e qeverisë përkatësisht vendimi nr. **03/110,05/110 dhe 04/115** lidhur me kërkesat e parashtruara nga AKP-ja.

Vlera që AKP ka deklaruar për kursime pran MFPT është shuma prej EUR 169,811, nga kjo vlerë janë marrë si kursime vetëm vlera prej EUR 35,000 * nga kategoria e ekonomike kapitale dhe lëvizjet tjera në buxhet janë si më poshtë:

Mallra dhe Shërbime:

Përkundër kërkesës së AKP-së që shuma për kursimet nga Kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve që mund të tërhiqen ishte 134,811, lëvizja e bërë nga kjo kategori nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, është transferi i bërë në vlerën prej EUR 25,000 e cila shumë është transferuar sipas kërkesës tonë në kategorinë e shpenzimeve komunale.

Paga dhe Shtesat:

Agjencia Kosovare e Privatizimit përmes disa shkresave zyrtare ka kërkuar aprovimin e buxhetit shtesë në kategorinë e pagave në shumë prej EUR 757,802. Në shkresat kemi specifikuar se kërkesa i dedikohet realizimit të pagave të stafit të AKP-së për muajin nëntor dhe dhjetor 2022.

Para ekzekutimit të çekut të pagave, mjete të lira në freebalance kemi pasur EUR 67,508.32, prej të cilave vlera prej EUR 49,581.17 kanë qenë të ndara si nënvijë buxhetore për kompensimin ndaj Anëtarëve të Bordit të AKP-së për mbledhjet që do të mbahen për muajt nëntor dhe dhjetor, pjesa tjetër e mbetur e mjeteve në vlerë prej EUR 17,927 ka qenë si mbetje për pagat e stafit të AKP-së.

Në bazë të kësaj gjendje buxhetore, në shkresën e datës 9 nëntor 2022 dhe shkresat e mëhershme, kemi kërkuar mjetet shtesë vetëm vlerën prej EUR 757,802 për të mbuluar çekun e pagave për muajin nëntor dhe dhjetor.

Sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 05/110 të datës 29.11.2022, për AKP-në, është alokuar vetëm shuma prej EUR 315,068 dhe jo vlera që është kërkuar me çekun e pagave, andaj, për të proceduar çeku i pagave për muajin nëntor nga Thesari, janë shfrytëzuar edhe mjetet e rezervuara për Bordin e Drejtorëve prej EUR 49,581.17 si dhe tepricat mjete tjera tepriçë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në vlerën EUR 17,927.

Nga viti 2018, nga kategoria e pagave realizohet edhe kompensimi i 8 Anëtarëve të Bordit të AKP-së për mbledhjet mujore. Pagesa për Bordin e Drejtorëve procedohen përmes urdhër obligimit për pagesë nga kodi ekonomik 11400 (punëtorët me kontrata jo në listën e pagave).

Po ashtu me vendimin e Qeverisë 04/115 të datës 23 dhjetor 2022 ka ndarë buxhet shtesë në kategorinë paga dhe mëditje për çekun e pagave të muajit dhjetor të stafit të AKP-së në vlerë prej EUR 385,905 dhe kompensimin e pagave të Anëtarëve të Bordit të AKP-së në vlerë prej EUR 38,700, për muajin nëntor dhe dhjetor shumë prej EUR 424,605.00.

SHËNIMET SHPJEGJUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Kapitale:

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar fillestar për shpenzime kapitale ka qenë EUR 70,000.00 ndërsa buxheti final është EUR 35,000.00, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Mjetet kanë qenë të destinuara për dy projekte kapitale:

1. Blerja e pajisjeve të TI-së për ngritjen e cilësisë të shërbimeve, vlera EUR 35,000.
2. Data baza (Softuer) për menaxhimin e lëndëve gjyqësore të Departamentit Ligjor, vlera EUR 35,000.

Dallimi në mes buxhetit fillestar dhe atij final është rezultat i kursimit buxhetor të shumës prej EUR 35,000 për projektin kapital Data baza (Softuer) për menaxhimin e lëndëve gjyqësore të Departamentit Ligjor.

Arsyeja e anulimit të projektit është sepse AKP ka vendosur që data baza aktuale është përfunduar me rastin e angazhimit të kontratës së mirëmbajtjes së databazës aktuale dhe nuk është e nevojshme të investohet në projekt të ri kapital.

AKP-ja ka deklaruar kursim pranë MFPT gjatë përmbylljes së vitit fiskal në muajin tetor 2022 në sistemin e Freebalancit këto mjete janë zbritur nga buxheti i kategorisë së Kapitale dhe si i tillë është reduktuar edhe në Buxheti i Agjencisë.

Vlera e kursimeve dhe mjeteve të ndara shtesë nga vendimet e Qeverisë për AKP-në për vitin fiskal 2022 sipas kategorive ekonomike është paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

- Ndryshimi buxhetore I - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 03/110 të datës 29 nëntor 2022

	1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)

SHËNIMET SHPIJEGJUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

- Ndryshimi buxhetore II - sipas sistemit të Freebalancit të datës 11 nëntor 2022

	1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)	
Nr.	Përshkrimi	Adminsitrate Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe rroga	-	-	-	-	-	-	-
2	Mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-	-
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	35	-	-	-	-	-	35
	Gjithsej	35	-	-	-	-	-	35

- Ndryshimi buxhetore II - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 05/110 të datës 29 nëntor 2022

	1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)	
Nr.	Përshkrimi	Adminsitrate Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe rroga	315	-	-	-	-	-	315
2	Mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-	-
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	315	-	-	-	-	-	315

SHËNIMET SHPIJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

- Ndryshimi buxhetore III - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 04/115 të datës 23 dhjetor 2022

	1	2	3	4	5	6	7=Σ(1:6)	
Nr.	Përshkrimi	Adminsitrate Qendrore	Auditimit	Departamenti Ligjor	Riorganizimi dhe administrimi i NSh	Privatizimi	Likuidimi	Totali
1	Paga dhe rroga	424	-	-	-	-	-	424
2	Mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-	-
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		424	-	-	-	-	-	424

SHËNIMI 2 PAGA DHE SHITESAT

	2022				2021	2020
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final	Ndryshimi Buxheti - Pagesat	
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Pagat neto përmes listës së pagave	3,820	3,820	-	3,820	-	4,152
Pagesa për sindikatë	-	-	-	-	-	-
Pagesa neto për punë jashtë orarit	-	-	-	-	-	-
* Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave)	216	216	-	220	4	329
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	357	357	-	357	-	390
Kontributi pensional-punëtori	220	220	-	220	-	239
Kontributi pensional-punëdhënësi	220	220	-	220	--	239
Vendime Gjyqësore-të formës së prerë	93	93	-	93	-	
PAGA DHE RROGA -	4,926	4,926	-	4,930	4	5,349

2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË

Numri i punëtorëve edhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve i aprovuar sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2022 është 257. Nga numri i përgjithshëm në listën e pagave në fund të vitit fiskal 2022 janë 230 nëpunës dhe për 12 nëpunës kanë dhënë dorëheqje dhe nuk kemi mbuluar këto pozita të lira dhe për 7 nëpunës është lejuar pezullim i dakorduar i marrëdhënies së punës. Po ashtu në numrin e përgjithshëm i buxhetit janë të përfshirë edhe 8 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Shih edhe në shënimin shpjegues nr. 25 - 26.

Pagat dhe mëditjet procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë Divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së me vendimin nr. BD-153/9 të datës 29.10.2021, ka marrë vendim për zbritje të pagave të stafit të AKP-së deri në 30% të buxhetit me efekt nga data 01.04.2022 dhe është bërë plotësim/ ndryshimi i Rregullores së Pagave. Pas këtij vendimi një pjesë e stafit është ankuar në Këshillin i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK). Po ashtu nga një pjesë e stafit, ankesë ishte dorëzuar edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës – tutje DHPGJSK.

Andaj, duke pasur parasysh këtë situatë Bordi i Drejtorëve të AKP-së mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2022 ka pezulluar Implementimin e pagave me zbritje deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga KPMShCK. Rrethanat e reja të krijuara kanë rezultuar me mungesën e mjeteve në kategorinë e pagave dhe për realizimin e pagave sipas kontratave ekzistuese të stafit të AKP-së deri në fund të vitit fiskal 2022 AKP ka bërë kërkesën e mjeteve shtesë në këtë kategori në shumën prej EUR 739,672.11 për muajin nëntor dhe dhjetor 2022.

Bazuar në Vendimet e fundit të KPMShCK sipas të cilave “refuzohen si të pabazuara ankesat e punonjësve të Agjencisë dhe mbetet në fuqi Vendimi Nr. Ref. BD-153/9 i datës 29 Tetor 2021”. Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur më datë 23 dhjetor 2022 ka marrë Vendim për hyrjen në fuqi të Rregullores Nr. 2/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së pagave të nëpunësve të Agjencisë nga data 1 Janar 2023.

PAGAT

Janë përgatitur dhe dërguar për ekzekutim në baza mujore Listat e Pagave (Payrollit) për muajt janar-dhjetor 2022.

LËVIZIET E STAFIT:

REKRUTIMET: Gjatë kësaj periudhe, DBNJ ka udhëhequr me gjashtë (6) procedura të rekrutimit, prej tyre një (1) e dështuar.

DORËHEQJE: Për arsye personale dymbëdhjetë (12) punonjës kanë ofruar dorëheqje.

TRANSFERET: Tridhjetë (30) punonjës janë transferuar në mënyrë të përkohshme dhe një (1) punonjës është transferuar në mënyrë të përhershme.

PEZULLIM I DAKORDUAR: Shtatë (7) punonjësve u është lejuar pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës sipas Ligjit në fuqi.

PUSHIM LEHONIE: Bazuar në Ligjin aktual në fuqi, (pesë) 5 zyrtarë kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë.

ZËVENDËSIMET: Gjatë vitit 2022, (tetë) 8 zyrtar janë caktuar në zëvendësim të pozitave tjera në periudha të ndryshme.

Komisioni Disiplinor ka trajtuar tre (3) raste disiplinore, me ç ‘rast janë shqiptuara masa disiplinore “vërejtje me shkrim” për dy (2) zyrtarë si dhe një rast me masë disiplinore “Ndalimi prej 25% të pagës për periudhën prej pesë (5) muaj në vlerën totale EUR 4,942.77

Janë realizuar gjithsej shtatë (7) trajnime me ç ‘rast nga këto trajnim kanë përfutur gjashtëmbëdhjetë (16) punonjës.

Pas marrjes së vendimit të BD 174/5 për zbritje të pagave, janë përgatitur të gjitha akt emërimet e reja për dyqind e tridhjetë (230) zyrtarë të AKP-së me efekt nga data 01 janar 2023.

2.2 SHPALOSIE E PAGESAVE NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË AKP-SË Kodi: "PUNËTORËT ME KONTRATË JO NË LISTËN E PAGAVE"

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe kompensohet sipas Rregullores për Kompensimin e Drejtorëve të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Për periudhën raportuese, pagesat në vlerën neto prej EUR 215,669 të realizuara ndaj Anëtarëve të Bordit të AKP-së dhe raste tjera, pasqyrohen si më poshtë:

	1	2	3	4=1+2+3	
Nr.	Përshkrimi	Pagesat neto	Tatimet	Kontributet pensionale (5+5%)	Gjithsej
1	Për mbledhje të Bordit	177,285	16,098	12,784	206,167
2	Për komisionet e Bordit	8,169	870	463	9,502
Gjithsej		185,454	16,968	13,247	215,669

Pagesat e realizuara gjatë periudhës raportuese kanë të bëjnë me aktivitetet e mëposhtme:

- Bordi i Drejtorëve të AKP-së i ka mbajtur 18 mbledhje gjatë vitit 2022;
- Komiteti i auditimit ka mbajtur 4 takime dhe ka pas angazhime gjatë tërë vitit fiskal.

Anëtarët e Komisionit të vlerësimit të performancës ka rifilluar punën në prill 2022. Janë mbajtur 5 takime në periudhën prill-korrik 2022, pastaj është pushuar puna e tyre. Mirëpo komisioni për vlerësimin e performancës së Menaxhmentit ka rifilluar përsëri angazhimin në muajin nëntor dhe janë mbajtur 2 takime.

Buxheti i shpenzuar për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për vitin 2022 është në vlerën EUR 215,669.

SHËNIMET SHPIJGJESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

2.3 PAGESA PËR VENDIME GJYQËSORE-TË FORMËS SË PRERË

		1	2	3
		4=1+2+3		
Nr.	Përshkrimi	Pagesat neto	Tatimet	Kontributet pensionale (5+5%) Gjithsej
1	Rasti A.K	78,050	6,360	8,885
Gjithsej		78,050	6,360	8,885
				93,295
				93,295

Më datën 4 shkurt 2022, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar aktvendimin të formë së prerë me nr. PKR. 51/20 nga Gjykata Themelore për parashkrim absolut të rastit/liëndës.

Sipas këtij aktvendimi, kërkohet kompensimi i pagave prej 50% për të cilat është bërë ndalesë në pagë përderisa ishin në procedurë gjyqësore. Ndalesat në pagë prej 50% janë bërë nga muaji prill 2014 deri në pagat e muajit 31 mars 2022 sipas nenit 69 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-149 të Ligjit për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës dhe sipas vendimit të AKP-së me datën 06 maj 2014 është shqiptuar masa e pezullimit parandalues me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbyesit Civil dhe bazuar në nenin 58 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publik si dhe në zbatim të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e obliguar të bëjë kompensimin e rrogës se pezulluar prej 50% për zyrtarin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit z. A. K. nga data 30 prill 2014 – 31 mars 2022 në shumën prej EUR 93,295.74.

Këto obligime kanë qenë të paraqitura edhe në detyrimet kontingjente në pasqyrat financiare 2021.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME

Shumat e paraqitura në tabelën e mallrave dhe shërbimeve janë financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Më poshtë janë paraqitur dhe shpalosur në detaje shënimet lidhur me natyrën e shpenzimeve.

Përshkrimi	2022				Ndryshimi Buxheti - Pagesat	2021	2020
	Gjithsej Pagesat	GQ	THD	Buxheti Final			
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	9	9	-	-
Mëditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	-	-	-
Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet për internet	16	16	-	16	-	16	19
Shpenzimet e telefonisë mobile	17	17	-	20	3	14	17
Shpenzimet postare	1	1	-	11	10	-	-
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	-	-	-	3	3	1	-
Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	-	-	-	-	-	-	-
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	2	2	-	3	1	-	-
Shërbime shtypje - jo marketing	-	-	-	1	1	1	1
Shërbime Kontraktuese Tjera	274	274	-	350	76	327	659
Shërbime Teknike	-	-	-	10	10	8	4
Mobile (me pak se 1000 euro)	3	3	-	4	1	120	-
Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-	13
Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	21	21	-	25	4	23	7
Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-	3
Furnizime për zyrë	20	20	-	20	1	8	14
Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	10	10	-	10	-	8	8
Furnizime pastrimi	10	10	-	10	1	5	7
Furnizim me veshmbathje	-	-	-	-	-	4	-

SHËNIMET SHPIJEGUJESË TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Naftë për ngrohje qendrore	24	24	-	30	6	36	37
Derivate për gjenerator	4	4	-	4	-	-	-
Karburant për vetura	24	24	-	30	7	16	17
Vaj	-	-	-	-	-	-	-
*Avance	-	-	-	3	2	1	-
Regjistrimi i automjeteve	2	2	-	3	1	2	3
Sigurimi i automjeteve	9	9	-	9	-	9	8
Taksa komunale e regjistrimit të automjeteve	-	-	-	-	-	-	-
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	25	25	-	33	9	20	28
Mirëmbajtja e ndërtesave	2	2	-	2	-	-	5
Mirëmbajtja e Teknologjisë Informativë	19	19	-	26	8	15	16
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	10	10	-	18	1	10	12
Qiraja për ndërtesa	119	119	-	134	16	220	224
Qiraja për pajisje	-	-	-	-	-	-	-
Qiraja për përdorime tjera hapësinore	189	189	-	189	1	189	189
Furnizime mjekësore	-	-	-	-	-	-	2
Reklamat dhe konkurset	-	-	-	-	-	-	-
Botimet e publikimeve	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet për informim publik	79	79	-	170	92	24	72
Drekat zyrtare	4	4	-	5	1	3	3
Shpenzime-vendimet e gjykatave	-	-	-	-	-	-	-
MALLRA DHE SHËRBIME	884	884	-	1,144	260	1,080	1,368

- Avanci i buxhetor për paratë e imëta që është mbajtur në arkë. Të gjitha pagesat e bëra në vlerën prej **EUR 1,265.68**, gjatë vitit fiskal 2022, janë kategorizuar sipas planit kontabël, gjendja në fund të vitit, ashtu siç kërkohet me procedura është mbyllur dhe është zero.

3.1 SHPJEGIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINE MALLRA DHE SHËRBIME DHE KRAHASIME ME VITET PARAPRAKE

Realizimi i buxhetit për kategorinë mallra dhe shërbime është gjithsej 77%.

Në përgjithësi për kategorinë mallra dhe shërbime, sikur kërkesa e AKP-së për kursimet e identifikuar dhe të deklaruar me shkresë në Departamentin e Buxhetit, MFPT të ishte marr në konsideratë, përqindja e në këtë kategori do të ishte më e lartë 89%.

Gjithsesi, në renditjen e mëposhtme janë shpalosur disa nënvija buxhetore për performancën dhe për mos realizimin e buxhetit sipas kërkesave të planifikuara nga Mbajtësit e Buxhetit.

Shpenzimi i buxhetit më i ulët se sa planifikimi ndërlidhet me arsyen se:

Shitje ka pasur vetëm në pjesën e dytë të vitit 2022 dhe atë me kapacitetet të reduktuar sepse një numër i madh i aseteve janë vendosur në listën e aseteve për transferim në Fondin Sovran dhe si të tilla nuk kanë mundur të tenderohen. Pjesa e parë e vitit 2022 është shfrytëzuar nga Agjencia për hartimin e Rregullave të Reja të Tenderit si dhe Procedurave të Shitjes.

Të gjitha planifikimet e shpenzimeve për vitin 2022 janë bazuar në supozimin se do të realizohen 10-12 Shitje të Aseteve, ndërsa në realitet janë realizuar vetëm 7 publikime të SHA-ve (Shitja e parë për vitin 2022 është shpallur në fund të muajit maj 2022).

Mos-publikimi i shpalljeve në gazeta të shtypura, të cilat vazhdojnë të mos botohen në Kosovë, si rrjedhojë e situatës me pandemi.

Gjatë vitit fiskal 2022 nuk ka pasur proces të rishikimit të buxhetit gjysmë-vjetor përmes së cilit do të kishim evidentuar kursimet buxhetore, megjithatë duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) për përmbylljen e vitit fiskal 2022, në muajin tetor, AKP ka identifikuar kursime në vlerë prej EUR 129,881, ku përmes shkresës zyrtare ka njoftuar MFPT duke kërkuar që shuma e kursimeve të reduktohet nga buxheti i Agjencisë, mirëpo pavarësisht kërkesës nga buxheti i AKP-së nuk janë zbritur kursimet e evidentuara.

Në renditjen e mëposhtme janë shpalosur disa nga nën linja buxhetore me përqindje më të ultë të realizimit.

- **AQ7 - Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda dhe jashtë institucionit.** Gjatë vitit 2022 nuk është organizuar asnjë udhëtim jashtë vendit.
- **AQ11 - Shërbimet e arsimit dhe trajnimit.** AKP ka për çdo vit planifikon buxhet të trajnimeve për stafin e saj. Buxheti nuk është shpenzuar për arsye se për vitin 2022 janë organizuar disa trajnime pa pagesë përmes Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP).
- **AQ19 - Derivate dhe lëndë djegëse (naftë për ngrohje qendrore, derivate për gjenerator, karburant dhe vaj për vetura.** Kushtet e mira klimatike dhe reduktimet e pakta të rrymës, kane ndikuar që të kemi më pak shpenzime për lëndë djegëse të nevojshme për ngrohje dhe gjenerator.

- **AQ22 - Sigurimi i ndërtesave dhe tjera (bombolat e zjarrit, rrufeja, vërshimet, kutitë e ndihmës së parë, shenjat e të tjera).** Planifikimet janë bërë sipas gjendjes në objektin e vjetër, mirëpo me kalimin në objektin e ri, si dhe bashkimit të zyrës së Prishtinës me zyrën Qendrore, nevojat janë reduktuar, e po ashtu dallimi vjen edhe si rezultat i çmimeve në tenderin për shërbimet e tilla, i cili ka qenë me lirë se parashikimet.
- **P5 - Shpenzimet për informim publik.** Arsyeja e mos-shpenzimit në tërësi të shumës së planifikuar gjatë viti fiskal 2022 dhe planifikimi është bazuar në praktikat e mëhershme me numër më të madh të mediumeve të shfrytëzuara, ndërsa me aprovimin e “mënyrave të marketingut” nga ana e BD, shpenzimet aktuale kanë qenë më të vogla që ka rezultuar në mos shpenzimin e buxhetit për disa linja buxhetore sa i përket shpenzimeve për informim publik siç janë Privatizimit, Likuidimit.
- **T4 - Shërbime Kontraktuese Tjera - Ofrues të shërbimeve profesionale për Trepçën (Për NSH-të që janë nën Administrim Direkt).** Shpenzimi i buxhetit për vitin 2022 nuk ka mundur të realizohet për arsye se gjatë vitit 2022 nuk ka pasur vendim nga Bordi i Drejtorëve, për inicim të likuidimit të njëjse jo esenciale dhe shqyrtim të kërkesave kreditore të Trepçës. Duhet theksuar se mos shpenzimi i mjeteve buxhetore në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve nga nën linja Buxhetore Likuidimi, Privatizim dhe Administrata Qendrore është si rrjedhojë që të gjitha Ofruesit e Shërbimeve (OSH) nga 1 janar 2021 janë angazhuar dhe kompensuar nga Ndërmarrjet në Likuidim. Këto mjete janë paraqitur si kurse dhe janë bartur në buxhetin e Kosovës. Andaj, marrë parasysh që shpenzimet tani po mbulohen nga llogaria e Tarifës administrative dhe nga NSH-të përkatëse, kërkesa buxhetore për vitin fiskal për vitin 2023 është minimale në krahasim e kërkesat buxhetore të viteve paraprake.

3.2. SHPALOSJE PËR PAGESAT E REALIZUARA PËR SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA (KODI 13460)

Sa i përket pagesave, në mënyrë që lexuesi të ketë një pasqyrë më të qartë, do të pasqyrohen më në detaje në tabelat e mëposhtme, pasi që brenda një kategorie (kodit ekonomik të shpenzimeve) janë realizuar pagesa për shërbime të ndryshme dhe që kanë vlera të mëdha.

Shërbimet kontraktuese tjera në shumën prej **EUR 273,913** përfshinë pagesat si më poshtë:

PËRSHKRIMI	VLERA	% e totalit
Pagesat ndaj BSPK-së si kompensim për shpenzimet mujore lidhur me 20% e punëtorëve	37,959	13.86%
Shërbimet e sigurimit të Zyrave të AKP-së ndaj operatori ekonomik “Policia e Kosovës”	206,565	75.41%
Pagesat e për ndejën e fund vitit me stafin e AKP-së	6,800	2.48%
Shpenzime tjera kontraktuale	4,663	1.70%
Pagesat për marrje me qira të veturave për shfrytëzim për nevoja të AKP-së	17,926	6.54%
GJITHSEJ PAGESA TE REALIZUARA NË KATEGORINË “SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA”	273,913	100%

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE

Për periudhën raportuese, buxheti fillestar i aprovuar për shërbime komunale ka qenë EUR 98,000.00 ndërsa buxheti final është EUR 123,000.00 dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Dallimi në mes këtyre dy shumave vjen si rezultat i transferit të shumës prej EUR 25,000 nga kursimet buxhetore me Vendim të Qeverisë.

AKP-ja edhe në kërkesën buxhetore për vitin 2022 ka planifikua buxhet në vlerë EUR 150,000 për këtë kategori ekonomike, duke marrë parasysh hapësirat e reja, mirëpo nuk është marrë parasysh kjo kërkesa.

Transferi sipas kërkesës së AKP-së është aprovuar nga MFPT gjatë përmbylljes së vitit fiskal në muajin nëntor. Arsyeja e kërkesës ka qenë se me kalimin e AKP-së në objektin e ri janë rritur shpenzimet komunale duke shfrytëzuar për herën e parë edhe shërbimet e Termokosit.

Pagesat e shërbimeve publike përfshijnë të gjitha pagesat e bëra për zyrën Qendrore dhe zyrat regjionale të AKP-së.

		2022		2021		2020	
Përshkrimi	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THD € '000	Buxheti Final € '000	Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000	Pagesat € '000	Pagesat € '000
Rryma	46	46	-	51	5	50	40
Uji	1	1	-	4	3	2	2
Mbeturinat	3	3	-	3	-	3	3
Ngrohja Qendrore	45	45	-	58	13	-	-
Shpenzimet telefonike	6	6	-	7	1	6	5
Pagesa-vendimet gjyqësore	-	-	-	-	-	-	-
SHPENZIMET KOMUNALE	101	101	0	123	22	61	50

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Për periudhën raportuese, buxheti i fillestar për subvencione dhe transfere është **EUR 5,000.00**, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Buxheti ka qenë i planifikuar për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit.

Mjetet nga Subvencionet janë paraparë që të shfrytëzohen për pagesën e menaxhmentit dhe drejtorëve të bordeve menaxhuese të Ndërmarrjeve në Administrim Direkt, të cilat nuk kanë mundësi për të bërë pagesën nga mjetet që realizojnë ndërmarrjet.

Edhe këtë vit fiskal AKP për të mos shfrytëzuar buxhetin e Kosovës për çështje të NSh-ve, ka shfrytëzuar mjetet të cilat janë akumuluar në llogaritë e këtyre NSh-ve apo për ato NSh që nuk kanë të hyra është shfrytëzuar përkohësisht mjetet nga llogaria e Tarifës Administrative.

Andaj, buxheti i aprovuar nuk ka mundur të shpenzohet dhe si i tillë është identifikuar si kursim buxhetor ku gjatë përmbylljes së vitit fiskal në muajin tetor kemi kërkuar nga MFPT të reduktohet nga buxheti i Agjencisë, mirëpo pavarësisht kërkesës, kursimi nuk është zbritur nga buxheti.

		2022		2021		2020	
Përshkrimi	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THD € '000	Buxheti Final € '000	Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000	Pagesat € '000	Pagesat € '000
Subvencione për entitetet publike	-	-	-	5	-	-	34
Subvencionet për entitetet publike (tea.bib)	-	-	-	-	-	-	-
Subvencione për entitetet jopublike	-	-	-	-	-	-	-
Menaxhimi i burimeve të ujitjes për bujqësi	-	-	-	-	-	-	-
Diversifikimi i fermave	-	-	-	-	-	-	-
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	-	-	-	5	-	-	34

SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar fillestar për shpenzime kapitale ka qenë **EUR 70,000.00** ndërsa buxheti final është **EUR 35,000.00**, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Mjetet kanë qenë të destinuara për dy projekte kapitale:

1. Blerja e pajisjeve të TI-së për ngritjen e cilësisë të shërbimeve, vlera EUR 35,000.
2. Data baza (Softuer) për menaxhimin e lëndëve gjyqësore të Departamentit Ligjor, vlera EUR 35,000.

Dallimi në mes buxhetit fillestar dhe atij final është rezultat i kursimit buxhetor të shumës prej EUR 35,000 për projektin kapital Data baza (Softuer) për menaxhimin e lëndëve gjyqësore të Departamentit Ligjor.

Arsyeja e anulimit të projektit është sepse AKP ka vendosur që data baza aktuale të mirëmbahet dhe të mos investohet në projekt të ri kapital.

Kursimi është prezantuar pranë MFPT gjatë përmbylljes së vitit fiskal në muajin tetor 2022 dhe si i tillë është reduktuar nga Buxheti i Agjencisë.

Projekti për blerjen e pajisjeve të TI-së për ngritjen e cilësisë të shërbimeve është realizuar dhe mbetja e buxhetit të pa shpenzuar është EUR 885.00.

Përshkrimi	2022		2021		2020	
	Gjithsej Pagesat		Buxheti Final		Ndryshimi Buxheti - Pagesat	
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Pajisje të teknologjisë informative	34	34	-	35	1	34
Shpenzime kapitale	34	34	0	35	1	34

SHËNIMI 7 TJERA

AKP-ja pranon depozitat e ofertuesve për pjesëmarrje në tender si depozitë e sigurisë. Këto mjete kthehen në rastin kur këta ofertues nuk janë fitues. Rastet kur ofertuesit janë fitues të përkohshëm mirëpo nuk arrijnë t'i plotësojnë kriteret tjera si p.sh. realizimin e pagesës të shumës blerëse brenda afatit kohor, depozitat e tyre konfiskohen dhe njihen si të hyra. Rastet e tilla paraqiten si të hyra në *nr. 10 të shënimeve shpjeguese*.

Detaje lidhur më këto të Hyra janë të paraqitura në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

Natyra e pagesës	2022 € '000	2021 € '000	2020 € '000
Depozitat e lojërave të fatit	0	0	0
Depozitat e Komisionit Rregullativ	0	0	0
Depozitat e Ministrisë së Drejtësisë	0	0	0
Depozita tjera	0	0	0
Gjithsej	0	0	0

SHËNIMI 8 TË HYRAT TATIMORE

Nuk janë pjesë e pasqyrave financiare të Agjencisë.

Përshkrimi	Shënime	2022 € '000	2021 € '000	2020 € '000	% e totalit nga 2020	% e ndryshimit nga 2021
Të hyrat tatimore 1						
Të hyrat tatimore 2						
Të hyrat tatimore 3						
Të hyrat tatimore 4						
GJITHSEJ						

SHËNIMET SHPIJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 9 TË HYRAT JO TATIMORE

Përshkrimi	Shënime	2022 € '000	2021 € '000	2020 € '000	% e totalit nga 2022	% e ndryshi mit nga 2021
Të hyrat nga shitja e mbeturinave		1				
Të hyrat nga dënimet-gjoha						
Të hyrat nga licencat						
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve						
Të hyrat nga inspektimi						
Të hyrat nga interesi bankar						
Të hyrat nga ndryshimi i pozicionit të kursit						
Të hyrat nga pasuria						
GJITHSEJ		1				

Më 22.12.2021 AKP i është drejtuar Ministrisë së Punës, Financave dhe Transfereve me kërkesën për aprovimin e shlyerjeve nga freebalance dhe lejimin e asgjësimit të disa pasurive kapitale të stërvjetëruara, kryesisht vetura dhe pajisje të TI-së, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe zbatimin e plotë të RREGULLORES MF – NR. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, të cilët më datë 30.12.2021 kanë aprovuar kërkesën tonë.

Pas marrjes së aprovimit, gjithmonë në harmoni me Regullorën MF- NR. 02/2013, më 11.01.2022 i jemi drejtuar Thesarit dhe kemi kërkuar që të bëhet transferimi i pasurive kapitale (kontejnerë) te Komuna e Prishtinës, respektivisht largimi i tyre nga regjistrat tanë, si dhe disa pasurive tjera kapitale, kryesisht vetura dhe pajisje të TI-së, të listuar në kërkesë dhe bazuar në regjistrat tonë të pasurive, si dhe në të dhënat e Thesarit, të cilët edhe kanë vepruar sipas kërkesës sonë dhe kontejnerët janë bartë te Komuna e Prishtinës, kurse veturat dhe pajisjet e TI-së janë larguar/shlyer nga regjistrat tanë.

Proceduralisht i janë nënshtruar të gjithë hapave të paraparë ligjorë dhe ka mbetur vetëm largimi dhe asgjësimi i tyre, duke u bazuar në vjetërsinë e tyre dhe gjendjen aktuale, vlera e tyre në librat kontabël ishte zero.

Si rezultat i kësaj, gjatë vitit 2022, kemi bërë përpjekje të vazhdueshme për gjetjen e alternativave më të mira për largimin fizik të atyre pasurive, të cilat kanë mbetur në gjendje të keqe dhe kanë penguar edhe në punët tjera në pjesën e Arkivës në Hajvali.

SHËNIMET SHPIJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Disa persona dhe kompani kanë parë nga afër gjendjen e atyre pasurive, mirëpo në të shumtën e rasteve kanë kërkuar mjete monetare për largimin e tyre, pasi sipas tyre nuk kanë ndonjë vlerë. Pas atyre përpjekjeve, e kemi trajtuar edhe mundësinë që të paguajmë për këtë shërbim KRM Pastrimi apo kompani të ngjashme.

Së fundmi kemi marrë një përgjigje nga një kompani, respektivisht “A.N.XH. Sekunda”, njëra nga dy kompanitë që i jemi drejtuar më herët me kërkesë me shkrim dhe të cilat merren me materiale të tilla, e cila është zotuar se do t’i merr ato pasuri (mbeturina), do t’i largojë dhe ka paguar kompensimin në vlerën prej EUR 1,220.00 në llogarinë kryesore të MFPT me bllok kodues 10/239/22900/50416/00000/0490 (të hyrat nga shitja e mbeturinave) në këmbim të metaleve që i ka vlerësuar.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 10 TË ARDHURAT E DEDIKUARA

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080:

Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMIFPP-së. Përveç kësaj, pesë përqindje (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMIFPP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë.

Të gjitha të hyrat e realizuara që trajtohen dhe janë për AKP-në, njihen si të hyra të dedikuara. Për detaje, referojuni shënimit shpjegues nr. 10.

Të hyrat e realizuara vetëm për periudhën raportuese janë EUR 2,307,205

	Përshkrimi	Shënime	2022				2021				2020				% e totalit			
			€ '000		€ '000		€ '000		€ '000		€ '000		€ '000		%		2022	
ati1	- Interes i fituar mbi tarifën administrative të AKP	FM	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
ati2	- 5% e shitjeve nga likuidimi dhe qiraja	FM	2,202,869		129		1,163		1,163		1,163		1,163		95.48%		95.48%	
ati3	- 5% nga shitja prej privatizimit	FM	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
ati4	- 5% e të ardhurave të komercializimit	FM	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
ati5	- 5% e të ardhurave të tjera nga NSH nëse ka	FM	7,836		-		-		-		-		-		0.34%		0.34%	
ati6	- nga Fondi Rezervë i AKP-së	FM	15,500		-		95		95		95		95		0.67%		0.67%	
ati7	- nga Llogaria për Deponimin e Ofertës për Privatizim	FM	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
ati8	- nga Tarifa për Dorëzimin e Ofertës për Privatizim	FM	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
ati9	- nga Llogaria për Deponimin e Ofertës në Likuidim	FM	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
ati10	- nga Tarifa për Regjistrim për Likuidim	FM	81,000		7		78		78		78		78		3.51%		3.51%	
ati11	- 5% e interesit në Llogarinë Bankare të Likuidimit	FM	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
ati12	- nga Llogaria për Deponimin e Shqyrtimit të Likuidimit	FM	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
Inkasimet nga përdorimi i telefonisë mobile dhe tjera		Shënimi nr 21.	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
Inkasimet e kapitalit themeltar të paguar më parë		FM	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-
GJITHSEJ			2,307,205		136		1,336		1,336		1,336		1,336		100%		100%	

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

FM – janë shënime nga pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim (FM) janë të prezantuara në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim, përkatësisht të hyrat në llogarinë bankare të tarifës administrative që Agjencia Kosovare administron në Bankën Qendrore të Kosovës.

Nga tërë procesi 2003 - 2022 për të gjitha shitjet dhe të hyrat e tjera (konfiskime të BID depozitave dhe tarifa për pjesëmarrje të tenderëve) gjithsej të hyrat e realizuara në llogarinë bankare të tarifës administrative që AKP-ja e administron janë **50,249,121**. Këto mjete janë inkasuar në llogarinë bankare të tarifës administrative të cilën AKP-ja e menaxhon dhe administron.

Ndërsa sa i përket transferimit të mjeteve në llogarinë e tarifës administrative të cilën Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave e administron të dhënat janë paraqitur si më poshtë.

10.1. TË ARDHURAT E DEDIKUARA PËR TË MBULUAR SHPENZIMET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-SË

Në tabelën e mëposhtme, janë paraqitur shumat e transferuara për buxhetet e viteve 2011 – 2019 sipas vlerës së buxhetuar dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Deri më tani shumat e transferuar për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe operative për buxhetet e AKP-së janë EUR 45,777,947.

NR.	PËRSHKRIMI DHE DATA E TRASFERËVE	PËR BUXHETIN E VITIT	GJITHSEJ
1	Transfer gjatë vitit 2011	2011	1,800,000
2	Transfer me 28 Maj 2012	2012	8,200,000
3	Transfer me 28 Dhjetor 2012	2013	8,048,000
4	Transfer shtesë me 18 Nëntor 2012	2014	2,300,000
5	Transfer shtesë me 15 Janar 2015	2015	5,500,000
6	Transfer shtesë me 15 Janar 2016	2016	6,300,000
7	Transfer shtesë me 20 Janar 2017	2017	6,100,000
8	Transferet shtesë gjatë vitit 2018	2018	6,493,706
9	Transferet shtesë gjatë vitit 2019	2019	1,036,241
10	Transferet shtesë gjatë vitit 2020	2020	0.00
11	Transferet shtesë gjatë vitit 2021	2021	0.00
12	Transferet shtesë gjatë vitit 2022	2022	0.00
GJITHSEJ PAGESAT			45,777,947

Për vitin 2022, buxheti i AKP-së është financuar tërësisht nga Granti Qeveritar. Rrjedhimisht siç është paraqitur në tabelën më lartë nuk kemi transferuar mjete apo nuk kemi financim nga të hyrat e dedikuara.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Mjetet e paraqitura që janë shpalosur më lartë, nga pika katër deri në nëntë, janë transferuar vetëm për ato shuma shtesë të nevojshme për të mbuluar buxhetin e periudhës fiskale, pasi që kemi pasur mjete të pa shpenzuar dhe këto mjete sipas Ligjit të Buxhetit dhe të AKP-së barten në vitin e ardhshme.

Lidhur me bartjen e tepërcave dhe transferimin e mjeteve shtesë për buxhetin e të hyrave të dedikuara Për më tepër, shih shënimin shpjegues nr. 23.

AKP-ja nuk planifikon të hyra si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Thesari i Ministrisë së Financave është kërkuar që të paraqitet si e hyrë vetëm transferi bankar në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit.

SHËNIMI 11 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar Grante nga Donatorët.

Përshkrimi			
		2022	2021
		€ '000	€ '000
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	
		0.00	0.00
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	
		0.00	0.00
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	
		0.00	0.00
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	
		0.00	0.00
Gjithsej		0.00	0.00

SHËNIME TJERA 12

Agjencia nuk është e përfshirë në praninë të depozitave të natyrave tjera.

		2022	2021
		€ '000	€ '000
Natyra e pranimit			
Depozitat e lojërave të fatit		0	0
Depozitat e Komisionit Rregullativ		0	0
Depozitat e Ministrisë së Drejtësisë		0	0
Depozita tjera		0	0
Gjithsej		0	0

SHËNIME 13 PAGESA NGA PALËT E TRETA

Agjencia nuk është e përfshirë në praninë të depozitave të natyrave tjera.

Natyrat e pranimit	2022 € '000	2021 € '000	2020 € '000
Pagat dhe mëditjet	0	0	0
Mallrat dhe Shërbimet	0	0	0
Shpenzimet Komunale	0	0	0
Subvencione dhe Transferet	0	0	0
Gjithsej pagesa nga palët e treta	0	0	0

SHËNIMI 16 TË ARKËTUESHMET

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2022 €	2021 €	2020 €
0000	Shpenzimet e telefonisë fikse dhe mobilë	0.00	0.00	0.00
	GJITHSEJ	0.00	0.00	0.00

SHËNIMET SHPIJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 17 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA

Kodi ekonomik	Kategoria ekonomike	2022		2021		2020	
		< 30 ditë	> 30 Ditë	< 30 ditë	> 30 Ditë	< 30 ditë	> 30 Ditë
11	Paga dhe Shtesa	-	-	-	-	-	-
13	Mallra dhe shërbime	44,536.95	3,028.30	57,924.74	5,008.56	74,060.98	1,065.99
14	Shpenzime komunale	9,170.65	445.48	6,646.52	600.80	6,977.41	611.05
20	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-
30	Shpenzime kapitale	1,700.00	-	-	-	-	-
Gjithsej		55,407.60	3,473.78	64,571.26	5,609.36	81,038.39	1,677.04

Në shumat e obligimeve të papaguara janë të paraqitura sipas datës së pranimit të faturave, për të cilat është raportuar në Thesar të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve si dhe për shpenzimet e vitit 2022, fatura të cilat janë pranuar në vitin 2022 dhe rastet tjera të njohura për AKP-në (fatura që ende nuk janë pranuar). Të dhënat detaje janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 4.

Pjesa më e madhe e faturave që janë paraqitur si detyrime në tabelë janë pranuar gjatë muajit janar 2023, po ashtu kemi edhe fatura që janë pranuar pas përfundimit të afatit për pagesa (24 dhjetor 2022), afat i përcaktuar nga Departamenti i Thesarit, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve.

Gjithsej këto obligime janë EUR 58,881.38 mijë, nga kjo vlerë e përgjithshme e detyrimeve është 55,407.60 obligime që nuk e kanë kaluar afatin prej 30 ditëve ndërsa vlera prej EUR 3,473.78 janë fatura që i kanë tejkaluar afatin e pagesave prej 30 ditëve.

Gjatë muajit janar 2023, pas alokimit dhe rrjedhës së parasë nga Thesari janë bërë zotimet për të gjitha detyrimet e paraqitura më lartë, për arsye që zyrtari shpenzues dhe certifikues ende nuk kanë pranuar qasjen nga Thesari. Andaj deri në periudhën e dorëzimit të pasqyrave financiare nuk kemi arritur që të bëjmë shpenzimi për obligimet e lartë cekura.

SHËNIMI 18 DETYRIMET KONTINGJENTE

Detyrimet kontingjente të AKP-së të cilat kanë të bëjnë me: pagat, kontraktot, mallrat, shërbimet si dhe çështje të tjera lidhur me operimin e përditshëm të Agjencisë (aktivitetet e AKP-së që financohen nga Buxheti i Kosovës -të hyrat e dedikuara, AKP dhe donatorët):

Kategoritë ekonomike	2022	2021	2020
	€ '000	€ '000	€ '000
11 Pagat dhe shtesa	34,674	170,079	362,541
13 Mallrat dhe shërbimet	0	0	(1,549)
14 Shërbimet komunale	0	0	0
20 Subvencione dhe Transferet	0	0	0
30 Shpenzimet kapitale	0	0	0
Gjithsej	34,674	170,079	360,992

*Kërkesa e AKP-së për buxhetin e vitit 2023 për kategorinë e pagave dhe mëditjeve në vlerë prej EUR 5,153,171.10 nuk është aprovuar dhe sipas akteve të emërimit që kanë nëpunës e AKP-së nga 1 janar 2023 do të ketë mjete të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet që rrjedhin nga kjo kategori ekonomike. Mirëpo në rast të ndonjë vendimi nga ndonjë shkallë tjetër e gjykatave të Kosovës në favorin e nëpunësve, atëherë AKP do të ketë mungesë të mjeteve rreth EUR 941,419 për vitin fiskal 2023. Lidhur me historikun e këtij procesi, ju lutem referojuni shënimit 18.1 si më poshtë. AKP po ashtu përmes shkresave dhe kërkesave shtesë buxhetore ka njoftuar MFPT dhe Kuvendin e Kosovës për këtë rrezik në këtë kategori që mund të ballafaqohemi gjatë vitit fiskal 2023.

Rrjedha e ndryshimeve gjatë vitit 2022 është sipas tabelës të mëposhtme:

PËRSHKRIMI	Vlera
Gjendja e detyrimeve kontingjente më 31 Dhjetor 2021	170,079
Në muajin shtator 2019, Drejtori Menaxhues kishte nxjerr vendim për 4 vozitës për ngritje të hapit nga 6-11 në 6-9.	
Mirëpo, ky vendim nuk ka gjetur zbatim nga Ministria e Administratës Publike, respektivisht Ministria e Punëve të Brendshme për arsye të ndryshëm	2,821
Detyrimet kontingjente i akumuluar për periudhën janar – mars 2022 për zyrtarin A.K llogaritja shtesë e 50% e pagës deri në vendim final të gjykatës për zyrtarët që janë në procedurë gjyqësore.	+
*Pagesat e vendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore Prishtinë më datë 4 shkurt 2022 me nr. 51/20. Shih edhe pagesat në shënimin shpjegues nr. 2.3 PAGESA PËR VENDIME GJYQËSORE-TË FORMËS SË PRERË.	3,190
** Vendimi i Këshillit A. nr. 698/2022 kundrejt ankesës për kompensim e pagave	(93,296)
	(48,120)
Gjendja e detyrimeve kontingjente më 31 dhjetor 2022	= 34,674

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

*** Pagesat e vendimit:** Më datën 4 shkurt 2022, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar aktvendimin të formë së prerë me nr. PKR. 51/20 nga Gjykata Themelore për parashkrim absolut të rastit/lëndës.

Sipas këtij aktvendimi, kërkohet kompensimi i pagave prej 50% për të cilat është bërë ndalesë në pagë përderisa ishin në procedurë gjyqësore. Ndalesat në pagë prej 50% janë bërë nga muaji prill 2014 deri në pagat e muajit 31 mars 2022 sipas nenit 69 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-149 të Ligjit për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës dhe sipas vendimit të AKP-së me datën 06 maj 2014 është shqiptuar masa e pezullimit parandalues me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbyesit Civil dhe bazuar në nenin 58 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publik si dhe në zbatim të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e obliguar të bëjë kompensimin e rrogës së pezulluar prej 50% për zyrtarin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit z. A. K. nga data 30 prill 2014 – 31 mars 2022 në shumën prej EUR 93,295.74.

Pagesat prej EUR **93,296** të prezantuar më lartë janë shlyerje e detyrimeve kontingjente që ishin raportuar deri më datë 31 dhjetor 2022 për rastin gjyqësor për A.K:

- EUR 90,207 për periudhën maj 2014 – dhjetor 2021 që janë prezantuar si detyrime kontingjente në pasqyrat financiare 2021; dhe
- EUR 3,088 për periudhën janar – mars 2022 gjendjen e kontigjencës për raportim për vitin 2022;

Pagesat prej EUR **93,296** janë realizuar në muajt maj - qershor 2022 e cila përfshinë pagat neto, tatimet dhe kontributeve pensionale.

**** Vendimi i Këshillit për rastin e N.A. nr. 698/2022 kundrejt ankesës për kompensim e pagave;**

Më datën 26 shtator 2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka hedhur poshtë ankesën e ish-nëpunësi të AKP-së lidhur me kërkesën për kompensimin e pagave dhe kthimin në vendin e punës.

18.1 Shpalosje lidhur me pasigurinë e ngjarjes në të ardhmen varësisht nga vendimi i Gjykatës

Kontesti administrativ i iniciuar nga stafi i AKP-së ndaj vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, sipas padisë A.nr.2993/2022, ndaj vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së për uljen e pagave të zyrtarëve të Agjencisë.

18.1.1. Historiku i ngjarjes lidhur me kontestin administrativ

Bordi i Drejtorëve të AKP-së me vendimin nr. BD-153/9 të datës 29.10.2021 ka marrë vendim për plotësim dhe ndryshim të Rregullores të Pagave për stafin e AKP-së. Qëllimi i plotësimit/ndryshimit të Rregullores të Pagave ishte zbritja e pagave për gjithë stafin e saj. Pas këtij vendimi, një numër i konsiderueshëm i punëtorëve të AKP-së kishin dorëzuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Po ashtu nga një pjesë e stafit, ankesë ishte dorëzuar edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës – tutje DHPGJSK. Dhoma e Posaçme, me datë 1 shkurt 2022 ka nxjerr aktgjykim e tij me numër C-IV-21-0231 me ç'rast ka refuzuar ankesën e nëpunësve të Agjencisë rrjedhimisht ka lënë në fuqi vendimin e Bordit të Drejtorëve për zbritjen e pagave. Ndaj këtij vendimi nëpunësit kanë parashtruar ankesë pranë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme me datë 15 shkurt 2022. Duke pas parasysh situatën se çështja e pagave ishte duke u trajtuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, KPMSHC me datë 7 shkurt 2022 ka nxjerr vendim me të cilin e ka pezulluar çështjen e trajtimit të 150 ankesave të nëpunësve të Agjencisë derisa Dhoma e Posaçme të trajtojë këtë çështje përfundimisht.

Në pajtim me këtë në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 130 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në mbledhjen e datës 30 mars 2022 Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka nxjerr pikë veprimi me anë të cilit e ka pezulluar zbatimin e rregullores se pagave me zbritje derisa çështja të trajtohet përfundimisht nga organet vendimmarrëse përkritazi me ankesën e nëpunësve të Agjencisë.

Në kronologji të kësaj, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës si instancë përfundimtare, me datë 10 gusht 2022 ka nxjerr aktvendimin me numër AC-1-22-0067-A0001 me ç' rast hedhet poshtë si e papranueshme dhe shpallë veten jo kompetent për trajtimin e kësaj lënde në këtë gjykatë. Si rrjedhojë e kësaj, AKP me datë 11 gusht 2022 ka njoftuar KPMSHC që çështja e ankesave të nëpunësve të Agjencisë pranë Dhomës së Posaçme është trajtuar përfundimisht nga kjo gjykatë ku e njëjta ka shpallur veten jo kompetente, dhe se ishin plotësuar të gjitha kushtet ligjore që KPMSHC të vazhdojë t'i trajtojë ankesat e nëpunësve të Agjencisë.

SHËNIMET SHPIJGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Me datë 07 tetor 2022 KPMSHC përmes një e-mail ka kërkuar nga AKP që t'i njoftoj të njëjtit se a ka ndonjë ankese tjetër e cila është duke u shqyrtuar nga ndonjë institucion tjetër në Republikën e Kosovës. Më datë 10 tetor 2022 AKP ka njoftuar KPMSHCK që në bazë të njohurive që ka, nuk ka ndonjë ankese tjetër e cila është në trajtim e sipër pranë ndonjë organi tjetër në Republikën e Kosovës.

Më datë 18 tetor 2022 AKP ka pranuar një e-mail nga KPMSHCK në të cilin konstatohet se do të bëjë aktivizimin e lëndëve dhe brenda afateve ligjore do të shqyrtoj të njëjtat dhe palët në procedurë do të njoftohen sipas rregullativës ligjore.

Në fund të muajit dhjetor 2022 AKP ka pranuar nga KPMSHCK një numër vendimesh lidhur me ankesat ndaj vendimit për zbritje të pagave nga Bordi i Drejtorëve, respektivisht me anë të këtyre vendimeve të Këshillit refuzohen ankesa e punonjësve dhe mbetet në fuqi vendimi i Bordit BD-153-9 i datës 29.10.2021 për aprovim të Rregullores se re për pagat në AKP.

Andaj, si rrjedhojë e tërë kësaj, ndryshimi/ri-kategorizimi i pagave për pozitat e stafit të AKP-së është bërë duke filluar me pagat e muajit janar 2023.

19.3.1 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)

	2022	2021	2020
Klasifikimi i pasurive	€	€	€
Ndërtesat	-	-	112,028
Pajisjet	63,185	52,599	56,046
Automjetet	-	-	8,848
Pasuri i paprekshme	17,870	20,078	18,326
Gjithsej	81,055	72,677	195,248

* janë paraqitur vlerat neto pas zhvlerësimit të realizuar deri më 31 dhjetor 2021

PËRSHKRIMI	Vlera
Gjendja fillestare e vlerës neto të kapitaleve	72,677
* Blerjet gjatë vitit 2022	+
Zhvlerësimi gjatë vitit 2022	-
Vlera neto e kapitaleve më 31 dhjetor 2022	= 81,055
* Blerjet e asetëve prej EUR 34,115 janë pajisje – harduer të TI-së	

Në raportin përmbledhës mbi pasuritë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit jemi zotuar se gjatë vitit 2022 do të evidentohen të gjitha asetet që janë në përdorim dhe në gjendje të rregullt ndërsa pjesa që është jashtë përdorimit dhe jashtë funksionit do të shlyhen nga regjistri dhe do të asgjësohen.

Në përputhje me këtë me datën 05.08.2022 Drejtori Menaxhues ka lëshuar vendimin DM 444/2022 mbi themelimin e komisionit të përkohshëm për verifikim dhe barkodim të asetëve/pasurive të AKP-së në zyrën qendrore. Ekip ky i cili ka evidentuar të gjitha pasuritë/asetet kryesisht UPS, Kompiuter dhe mobileje të cilat janë tërësisht jashtë përdorimi dhe duhen asgjësuar.

Si rezultat i punës së Komisionit departamenti i Administratës ka evidentuar dhe ka bërë ndarjen e asetëve jashtë përdorimit dhe është marr me angazhimin e kompanisë e cila ka përfunduar procesin e asgjësimit në prezencën e komisionit të emëruar në vitin 2021 dhe të komisionit të emëruar në vitin 2022.

Vlen të theksohet se kompania cila ka kryer punën e asgjësimit të asetëve/pasurive të identifikuara për shlyerje gjatë vitit 2022 gjithashtu ka asgjësuar edhe asetet e cekura më poshtë për të cilat AKP ka marrë aprovim vitin paraprak, proces ky që ka ngecur deri më tani pasi që AKP ka pasur vështirësi në gjetjen - angazhimin e një kompanie serioze me kosto optimale:

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

- 15 automjete;
- 9 fotokopje; dhe
- 14 pajisje tjera kapitale të TI-së.

Gjatë vitit 2022 janë asgjësuar gjithsej 550 asete/pasuri ku kostoja historike e tyre kap vlerën prej € 40,913.13 kurse vlera neto ne fund te vitit është € 251.16. Nga kompania që ka kryer asgjësimin e këtyre aseteve në emër të kompensimit ka paguar vlerën € 1,220 në llogarinë kryesore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në MFPT.

Një aset në vlerë prej € 144.00 karrike nuk është regjistruar në vitin 2021 si pasojë e gabimi teknik e cila është regjistruar gjatë muajit Nëntor 2022 pasi që kemi vërejtur mos përputhjen në shumën totale.

Me datën 18.10.2022 Drejtori Menaxhues ka lëshuar vendimin DM 511a/2022 për formimin e Komisioneve regjistrim të rregullt të pasurive të AKP-së për vitin 2022 nga të cilat janë gjeneruar raportet finale mbi pasuritë.

Lista detaje e pasurive kapitale është vendosur në FTP server dhe është dërguar ne MFPT me US, me dorëzimin e Pasqyrave Financiare.

Zhvlerësimi i pasurive:

AKP raporton koston historike, zhvlerësimin dhe vlerën neto të pasurive deri më 31 dhjetor 2022. Të dhënat janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 4.

Agjencia Kosovare e Privatizimit gjegjësisht Departamenti i Financave dhe Buxhetit menaxhimin e aseteve të AKP-së e bënë duke u bazuar në bazën e të dhënave të mirëmbajtur nga vet departamenti, në pa mundësi që të qaset dhe të bazohet në sistemin “E-Pasuria”, nëpërmjet të cilës të gjitha institucionet do të regjistronin, monitoronin dhe kontrollonin asetet e tyre por e cila ka vite që nuk funksionon. Kemi tentuar të bëjmë marrëveshje mbi migrimin e shënimeve dhe implementimin e plotë të sistemit por nuk kemi pasur sukses edhe pse është bërë përpjekjes me dhjetëra herë nga ana e AKP-së që të arrihet një mirëkuptim dhe qasje më e lehtë në sistemin e “E-pasuria”.

19.3.2 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO)

AKP-ja bënë llogaritjen e zhvlerësimit sipas (udhëzimet UA 2009/21 dhe rregullorja 2/2013 e datës 18 Nëntor 2013 e MF-së për menaxhimin e pasurive) ato janë të paraqitura si më poshtë:

- Zhvlerësimi bëhet sipas metodës drejtvizore bazuar në jetë gjatësinë e përdorimit të pajisjes;
- Llogaritja e zhvlerësimit nuk bëhen në muajin e parë të blerjes.

SHËNIMET SHPIJGJESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Meqenëse nuk ka udhëzues nga Ministria e Financave se si të kalkuloheh zhvlerësimet për inventar, ne kemi zhvlerësuar sipas metodës të sipërsëhënuar.

	2022	2021	2020
Klasifikimi i pasurive	€	€	€
Pajisjet dhe mobilet	130,919	154,766	70,214
Gjithsej	130,919	154,766	70,214

PËRSHKRIMI	Vlera		
Gjendja fillestare e vlerës neto të inventarit	154,766		
Korrigjimi	144		
*Blerjet gjatë vitit 2022		+	17,914
Zhvlerësimi gjatë vitit 2022		-	41,244
Zhvlerësimi i të asgjësuarave		-	403
Asgjësimit		-	258
Vlera neto e inventarit më 31 dhjetor 2022	=	130,919	

Të dhënat detaje janë në shtojcën e pasqyrave financiare tabela nr. 3.

Lista detaje e inventarit është vendosur në FTP server dhe është dërguar ne MFPT me US, me dorëzimin e Pasqyrave Financiare.

19.3.3 STOQET

	2022	2021	2020
Klasifikimi i pasurive	€	€	€
Stoqet	8,999	6,500	15,566
Gjithsej	8,999	6,500	15,566

PËRSHKRIMI	Vlera		
Gjendja fillestare e vlerës të stoqeve	6,500		
*Hyrje/blerjet në depo		+	26,826
Daljet/nga depo		-	(24,327)
Vlera e stoqeve më 31 dhjetor 2022	=	8,999	

SHËNIMET SHPIJGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Gjendja e stokeve kryesisht është vetëm material shpenzues administrativ dhe material higjienik. Të gjitha këto mbahen si stoqe në depo. Materialet e shpërndara në zyrat përkatëse, nuk trajtohen si stoqe. Gjithashtu, vlen të theksohet se të gjitha shpenzimet për furnizim për zyrë janë prezantuar në shënimin 3 “Mallra dhe Shërbime”.

Për vitin 2022 hyrje e stokeve në depo është bërë në vlerën totale prej EUR 26,826 dhe atë:

- Material administrativ EUR 18,484; dhe
- Material higjienik EUR 8,342;

SHËNIMI 20 RAPORT PËR AVANCE E PAARSYETUARA

Agjencia nuk ka avance të paarsyetuara.

Data e Lëshimit	Nr. i CPO	Qëllimi	2022
			€
			0.00
			0.00
			0.00
			0.00
Gjithsej			0.00

SHËNIMI 21 RAPORT PËR TË HYRAT VETANAKE TË PASHPENZUARA

Sa i përket realizimit të hyrave dhe financimit të aktiviteteve të AKP-së, ato janë të hyrat e dedikuara dhe janë paraqitur në shënimin shpjegues nr. 23.

Përshkrimi	2022	2021	2020
	€	€	€
Të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar	0.00	0.00	0.00
Të hyrat vetanake të pranuar në këtë vit	0.00	0.00	0.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e mbetur për bartje	0.00	0.00	0.00

SHËNIMI 22 RAPORT PËR BILANCET E PASHPENZUARA TË FONDIT ZHVILLIMOR NË MIRËBESIM

Agjencia nuk ka bilance të pashpenzuara dhe/apo që mund të përdor Fondin Zhvillimor në Mirëbesim.

Përshkrimi	2022 €	2021 €	2020 €
Të hyrat nga Fondit Zhvillimor në Mirëbesim të bartura nga viti i kaluar	0.00	0.00	0.00
Të hyrat nga Fondit Zhvillimor në Mirëbesim të pranuar në këtë vit	0.00	0.00	0.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e mbetur për bartje	0.00	0.00	0.00

SHËNIMI 23 RAPORT PËR TË ARDHURAT E DEDIKUARA

Raporti i të hyrave të dedikuara për vitin 2022 është si më poshtë:

Përshkrimi	2022 €	2021 €	2020 €
Të hyrat e dedikuara të bartura nga viti i kaluar	0.00	0.00	0.00
Të hyrat e dedikuara të pranuar në këtë vit	0.00	0.00	0.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e pa alokuar nga Thesari	0.00	0.00	0.00
Shuma e mbetur për bartje	0.00	0.00	0.00

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 24 RAPORT PËR FONDET E DONATORËVE TË PASHPENZUARA

Agjencia nuk ka pranuar fonde nga donatorët dhe nuk ka fonde të donatorëve të pashpenzuara:

Përshkrimi	2022	2021	2020
	€	€	€
Të hyrat nga donatorët të bartura nga viti i kaluar	0.00	0.00	0.00
Të hyrat nga donatorët të pranuar në këtë vit	0.00	0.00	0.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	0.00	0.00	0.00
Shuma e mbetur për bartje	0.00	0.00	0.00

SHËNIMI 25 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE

Agjencia Kosovare e Privatizimit, në tabelën e mësipërme ka paraqitur numrin e punëtorëve sipas programit buxhetor në Ministrinë e Financave. Për sqarim, ky numër i punëtorëve nuk është vetëm në këtë Departament, por në Departamentet, Njësitë dhe 5 Zyrat Rajonale të AKP-së.

Departamenti	Nr. i punëtorëve në Ligjin e buxhetit	Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2022		Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2021		Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2020	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti i Administratës	249	230	-	240	-	245	-
Gjithsej	249	230	-	240	-	245	-

Rrjedha e ndryshimeve gjatë vitit 2022 të numrit të stafit të AKP-së është sipas tabelës të mëposhtme:

SHËNIMET SHPIJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

PËRSHKRIMI	MESHKUJ	FEMRA	GJITHSEJ
Numri i punëtorëve në fillim të vitit	132	108	240
Punëtorë të ri	1	1	2
Dorëheqje	9	3	12
Pension	0	0	0
Gjithsej punëtorë të AKP-së	124	106	230

SHËNIMI 26 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE JASHTË LISTËS SË PAGAVE

Për vitin raportues dhe dy vitet paraprake, Agjencia nuk ka paguar punëtor të angazhuar jashtë listave të pagave. Pagesat për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të AKP-së, Tatimet dhe Kontributet e këtyre procedohen nga kodi ekonomik punëtorët me kontratë jo në listën e pagave (11400).

Kompensimi për 8 Anëtarëve të Bordit të AKP-së janë pagesa fikse mujore për shërbimet dhe angazhimin e tyre në përputhje në rregulloren për kompensimin e Bordit të Drejtorëve.

Departamenti	Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2022		Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2021		Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2020	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti i Administratës	-	8	-	8	-	8
Departamenti i Shitjes	-	-	-	-	-	-
Departamenti Ligjor	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	8	-	8	-	8

SHËNIMET SHPIJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

SHËNIMI 27 RAPORT PËR NUMRIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË VEÇANTA PËR NDËRMARRIET SHOQËRORE

Departamenti	Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2022		Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2021		Nr. aktual i punëtorëve në fund të dhjetorit 2020	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti i Likuidimit	-	-	-	-	26	-
Njësia e Riorganizimit	-	-	-	-	20	-
Departamenti i Privatizimit	-	-	-	-	9	-
Departamenti i Administratës	-	-	-	-	6	-
Gjithsej	-	-	-	-	61	-

SHËNIMI 28 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Raporti është për periudhën deri më 20 qershor 2022 sipas rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit që entitetet e audituara të raportojnë dy herë në vit përmes raporteve periodike mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit të ZKA-së. Raportimi i radhës bëhet me 15 mars të vitit pasues.

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Koment e
A1.	Paga dhe mëditje	Parregullsi në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Kryesuesi i Bordit, me qëllim të mbarëvajtjes së institucionit dhe zhvillimit të aktiviteteve normale të të gjitha njësive, duhet të siguroj që respektohen kërkesat ligjore në lidhje me transferimet e përkohshme të stafit si	a) Është adresuar çështja e ngritjes së pagave për vozitësit duke anuluar më 4 mars 2022 vendimin e Drejtorit Menaxhues të datës 4 shtator 2019. Çështja e përgjegjësisë së menaxherëve të kontratave do të adresohet në kuadër të Ligjit për	Konsiderohet e zbatuar me anulim të vendimit të datës 04.03.2022	

SHËNIMET SHPIEGUJESË TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Komente
			dhe lidhjen dhe zbatueshmerinë e kontratave	Zyrtarët Publik dhe Rregullores së Qeverisë për Disiplinën e Nëpunësve Publik. b) Sa i përket transfereve të përkohshme, janë rishikuar të gjitha rastet dhe për ato që nuk ka pasur nevojë, nuk u është vazhduar angazhimi. Ndërsa për rastet që janë ende si transfere të përkohshme janë për shkak të nevojës për angazhim duke marrë parasysh mungesat e stafit në departamentet dhe njësitë përkatëse dhe deri në hapjen e procedurave të konkursit këto raste do të mbesin si transfere të përkohshme. Agjencia ka filluar procesin e ristrukturimit të tërësishëm dhe parashihet të adresohen edhe çështjet e transfereve të përkohshme dhe të përhershme.	Deri 31 dhjetor 2022.	

SHËNIMET SHPIJGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Komente
A2.	Menaxhimi Kontratës	Mos penalizmi i operatorëve ekonomik dhe mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit	Kryesuesi i Bordit duhet të rishikoj procedurat të cilat ndikojnë në funksionimin e kontrolleve të brendshme për të identifikuar arsyet e mos zbatimit të kërkesave të kontratës dhe të siguroj që dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.	Më datë 28 shkurt 2022 është marrë vendim nga Zëvendësuesi i Drejtorit Menaxhues (DM 278/2022) që Menaxherët e Kontratave të bëjnë harmonizimin e rregullt mujor të pagesave për kontratat e prokurimit. Kjo nënkupton që çdo devijim nga kontratat duhet të raportohet te Departamenti i Prokurimit, mbikëqyrësit e Menaxherëve të Kontratave dhe te Menaxhmenti.	Zbatohet në vazhdimësi	
B1	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Mos funksioni i sistemit të E - Pasuria	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj vazhdimin e bashkëpunimit aktiv me MPBAP, për eliminimin e mangësive në sistemin e-pasuria, përfshirë edhe bartjen e shënimeve të pasurive jo kapitale.	Edhe gjate këtij viti do të bëjmë përpjekje që ne bashkëpunim me MPBAP të arrihet zbatimi praktik i E-Pasuria. Me gjithë vullnetin tone për funksionimin e këtij sistemi, kjo çështje nuk varet nga ne.	Deri 31 dhjetor 2022 të adresohet prapë nga AKP	

Vërejtje: Disa nga rekomandimet e ZKA-së, për shkak të kompleksitetit të tyre kërkojnë më shumë kohë për adresim të plotë të tyre. Andaj, në tabelën e mësipërme, gjegjësisht tek kolona (Afati për zbatim) e kemi shënuar datën e planifikuar për implementim. Pavarësisht kësaj, ne, po ashtu e kemi shënuar në kllapa "në vazhdimësi", meqenëse kërkohet më shumë kohë për adresimin e tërësishëm të atyre rekomandimeve.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE FONDET NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

I.	PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM.....	7
----	---	---

II.	GIENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM I I	
-----	--	--

III.	SHËNIMET SHPJEGUESE.....	15
------	--------------------------	----

IV.	TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	17
-----	--	----

2.	TË HYRAT NGA SHITJA.....	17
----	--------------------------	----

3.	TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË.....	21
----	---------------------------------------	----

4.	INTERESI I FITUAR	24
----	-------------------------	----

5.	TË HYRAT NGA TARIFA DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE NË TENDERËT E SHITJES.....	25
----	---	----

6.	BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER	25
----	---	----

7.	TË HYRA TJERA.....	26
----	--------------------	----

8.	KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	27
----	---	----

V.	SHPENZIMET/SHPËRNDARJA.....	28
----	-----------------------------	----

9.	20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK.....	28
----	---	----

10.	OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSHP) PËR LIKUIDIMIN E NSH-ve	29
-----	--	----

11.	MALLRA DHE SHËRBIME	31
-----	---------------------------	----

12.	SHPENZIME KOMUNALE	36
-----	--------------------------	----

13.	TATIMET	37
-----	---------------	----

14.	VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE	38
-----	---	----

15.	TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-së	40
16.	SHPENZIME TJERA.....	41
17.	PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve NË LIKUIDIM.....	42
18.	FONDET TRANSFERUAR BUXHETIT TË KOSOVËS	44
VI.	LLOGARITË E ARKËTUESHME	45
19.	NDËSHKIMET NDAJ NSH-ve ME SPIN-OFF SPECIAL.....	46
20.	LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHITJA E ASETETE	47
21.	LLOGARITË E ARKËTUESHME PËR QIRATË.....	49
VII.	LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE 52	
22.	LLOGARITË E PAGUESHME.....	52
23.	DETYRIMET KONTIGJENTE	55
VIII.	PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE..	58
IX.	TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GIENDJA NË BANKAT KOMERCIALE	59
	TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM.....	59
	LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE	59
X.	GIENDJA E FONDEVE TË LIKUIDIMIT TË NSH-ve.....	60
XI.	LLOJET E LLOGARIVE BANKARE	63
XII.	PLANI I VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	65

PASQYRAT FINANCIARE 2022

- PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM
- GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

I. PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2022

Përshkrimi	Shënimi shpjegu es	Gjendja fillestare 1 janar 2022	2022 Hyrje/dalje	Bilanci përfundimtar 31 dhjetor 2022
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE				
	2	777,571,140	6,152,060	783,723,200
Të hyrat nga shitja e aseteve				
Të hyrat nga qiraja	3	52,630,084	4,842,279	57,472,363
Interesi i fituar	4	34,844,700	-	34,844,700
Të hyrat nga tarifa dhe konfiskimet e Bid Depozitave në tenderët e shitjes	5	8,880,964	111,501	8,992,465
Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender	6	-	211,000	211,000
Të hyra tjera	7	7,600,934	181,834	7,782,768
Kapitali themeltar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit	8	1,013,200	-	1,013,200
Gjithsej pranimet		882,541,022	11,498,674	894,039,696
PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË				
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	9	153,553,607	6,673,827	160,227,434
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)	10	16,976,357	429,900	17,406,257
Mallra dhe shërbime	11	22,359,173	1,800,553	24,159,726
Shpenzimet komunale	12	3,054,983	206,836	3,261,819
Tatimet	13	11,157,824	819,098	11,976,922
Vendimet e gjykatave/përmbaruesve (depozita dhe taksa)	14	3,123,978	5,366,632	8,490,610
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	15	45,777,947	-	45,777,947
Të tjera	16	858,303	13,478	871,781
Pagesat ndaj kreditorëve të NSH-ve	17	42,708,400	15,070,985	57,779,385
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	18	398,233,741	-	398,233,741
Gjithsej pagesat/shpërndarja		697,804,313	30,381,309	728,185,622
BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE		184,736,709	(18,882,635)	165,854,074

II. GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2022

Llogaritë bankare të paraqitura më lartë janë llogari bankare që janë hapur në Bankën Qendrore të Kosovës dhe administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Llojet e llogarive bankare	2003 deri		2003 deri		2003 deri	
	31 DHJETOR	2022	31 DHJETOR	2021	31 DHJETOR	2020
Privatizim		909,001		909,006		5,147,701
Likuidim		151,972,261		170,365,010		170,311,888
Para të NSH-ve në mirëbesim		1,759,275		1,360,705		5,781,085
Komercializim		-		-		-
Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët		3,299,797		6,166,654		7,727,783
Depozita nga tenderët e privatizimit		-		-		-
Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim		-		-		-
Depozita nga tenderët e shitjeve me Likuidim		213,190		2,453		2,453
Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim		6,628		1,634		3,249
Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit		25		25		25
Kapitali themeltar i AKP-së		894,783		894,783		894,783
Fondi rezervë i AKP-së		18,042		-		1,237
Donator		8,463		8,463		8,463
Tarifa administrative e AKP-së		2,749,832		393,099		1,209,043
Depozitat Kohor		-		-		-
Të hyrat nga shpronësimet		4,022,777		4,634,877		369,277
GJITHSEJ		165,854,074		184,736,709		191,456,987

1 janar 31 dhjetor 2022	1 janar 31 dhjetor 2021	1 janar 31 dhjetor 2020
(5)	(4,238,695)	(1,753,720)
(18,392,749)	53,122	(67,894,637)
398,570	(4,420,380)	(1,706,907)
-	-	-
(2,866,857)	(1,561,129)	(4,887,915)
-	-	-
-	-	-
210,737	-	(2,750,422)
4,994	(1,615)	(38,851)
-	-	-
-	-	(154,078)
18,042	(1,237)	(39,382)
-	-	-
2,356,733	(815,944)	541,968
-	-	-
(612,100)	4,265,600	(5,019,019)
(18,882,635)	(6,720,278)	(83,702,963)

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2022

PËR FONDET NË MIRËBESIM

III. SHËNIMET SHPJEGUESE

BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik. Në përputhje me SNKSP, këto pasqyra janë prezantuar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Gjithashtu, këto pasqyra financiare i përmbushin obligimet raportuese që dalin nga “Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim” e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011.

Llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme dhe detyrimet kontingjente paraqiten vetëm si shpalosje në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim.

Të gjitha të dhënat financiare të pranimeve dhe pagesave që janë paraqitur në këto shënime janë nga llogaritë bankare të NSH-ve që Agjencia menaxhon dhe administron në Bankën Qendrore të Kosovës.

SUBJEKTI RAPORTUES

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 03/L-067 që ka hyrë në fuqi me 1 korrik 2008 e shfuqizuar me Ligjin nr. 04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 shtator 2011 dhe ndryshim/plotësimet të Ligjit nr. 04/L-115 të datës 7 shtator 2012, të Ligjit nr. 05/L-080 të datës 24 dhjetor 2015 dhe Ligjit nr. 06/L-023 të datës 3 maj 2018.

Në pajtim me Ligjin mbi themelimin e AKP-së, aktiviteti i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore – NSH, nëpërmjet metodave të “spin off-it”, qiradhënie, administrimi, ristrukturimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, menaxhon ndërmarrjet shoqërore në Kosovë dhe i mban këto ndërmarrje në mirëbesim. AKP është e ngarkuar me “ruajtjen dhe rritjen” e vlerës së NSH-ve dhe aseteve të tyre brenda dhe jashtë Kosovës.

Periudha raportuese për pasqyrat financiare është prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2022. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raportet që paraqesin të dhënat financiare nga data 1 korrik 2003 deri më 31 dhjetor 2022.

Për vitin fiskal 2022 janë gjithsej 28,609 transaksione (hyrje/dalje) të kategorizuar në regjistrin kontabël.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve mban mbledhje të rregullta mujore në mënyrë që t’i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit.

Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 8 të Ligjit nr. 06/L-023.

Kuvendi i Kosovës, në seancën plenare më datë 27 maj 2021 ka shkarkuar Bordin e Drejtorëve të AKP-së. Ndërsa në seancën plenare të datës 6 gusht 2021 ka emëruar Bordin e ri të Drejtorëve të AKP-së. Bordi i ri i Drejtorëve i përbërë prej 8 anëtarësh kanë mandat 4 vjeçar në përputhje me nenin 9 të ligjit nr. 06/L -023.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur 7 tetor 2021 kishte emëruar z. Avni Jashari si Zëvendësues i Drejtorit Menaxhues nga data 7 tetor 2021 deri në vendimin e ardhshëm. Emërimi i z. Jashari si Zëvendësues i Drejtorit Menaxhues ka skaduar më 4 korrik 2022 si rezultat i emërimit të Drejtorit Menaxhues. Z. Jashari me pozitë të tij të rregullt në AKP është zv. Drejtor Menaxhues – Likuidimit, AKP.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka emëruar z. Arben Limani në pozitën Drejtor Menaxhues me efekt nga data 5 korrik 2022 sipas Ligjit nr. 06/114 për Zyrarët Publik dhe procedurës të rekrutimit. Z. Arben Limani ka mandat katër vjeçar nga data 5 korrik 2022 deri me 4 korrik 2026.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura. Raporti vjetor paraqet të gjitha detajet e aktiviteteve dhe informatave financiare dhe jo financiare për vitin fiskal 2022.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË

AKP menaxhon dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi kolektiv i urdhër-transferëve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve.

VALUTA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro. Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.


DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim me datën e deklaratës të nënshkruar nga: Arben Limani - Drejtor Menaxhues dhe Adem Selishta - Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

IV. TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE

2. TË HYRAT NGA SHITJA


PËRSHKRIMI	2022 vs	
	VITI 2022	VITI 2021
Shitja e aseteve	4,700,369	63,375
Pranimet nga shpronësimet	1,367,261	4,725,796
Shitjet me Negocim Direkt	30,420	1,307,462
E drejta në pronësi banesore	54,010	301
GJITHSEJ	6,152,060	6,096,934
		14,822,298
		1%
		(58)%



- Në tabelën në anën e majtë, paraqiten bilancet e hyrjeve/daljeve në llogaritë bankare të NSH-ve përkatëse për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2022.
- Shitjet e aseteve** – janë asetet e tenderuar gjatë valëve të privatizimit.
 - Pranimet nga shpronësimeve** - asetet që janë shpronësuar dhe atyre që janë në proces nga ana e Qeverisë së Kosovës.
 - Shitjet e aseteve përmes metodës të negocimit direkt** - në përputhje me paragrafin 1.4 të nenit 18 të shtojcës të Ligjit bazik nr. 04/L-034 dhe rregullores për “Shqyrtimin e Aseteve me Karakter Specifik dhe Shitja e tyre me Negocim Direkt”, AKP ka filluar procesin e shitjes përmes kësaj metode. Këto rregulla përcaktojnë të drejtat dhe obligimet se si kategorizohen asetet si “asete me karakter specifik” dhe procedurat lidhur me aplikimin e atyre që kanë të drejtën për blerjen e aseteve me karakter specifik.
 - Të hyra nga bartja e së drejtës banesore** janë pagesat nga bartja e të drejtës banesore të Ndërmarrjeve Shoqërore. Këto pagesa realizohen në përputhje me Ligjin nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave dhe Ligjin nr. 04/L-247 për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-061.

2.1. SHITJET E ASETEVE PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT

Grafiku



Raporti i pagesave të pranuar për realizimin/nënshkrimin e kontratave për tre vitet e fundit

Pranimet	KONTRATA TË NËNSHKRUARA		
	2022	2021	2020
Pranimet gjatë vitit 2017	-	-	305,000
Pranimet gjatë vitit 2018	-	-	418,660
Pranimet gjatë vitit 2019	-	-	3,405,992
Pranimet gjatë vitit 2020	-	3,150	8,469,480
Pranimet gjatë vitit 2021	63,375	-	-
Pranimet gjatë vitit 2022	4,590,814	-	-
GJITHSEJ	4,654,189	3,150	12,599,132

Në grafikun në anën e majtë janë paraqitur të dhënat dhe krahasimet për tre vitet e fundit sa i përket pagesave të pranuar dhe vlera e të cilave janë nënshkruar kontratat brenda atij viti për shitjen e aseteve përmes valëve të privatizimit.

Siç vërehet, për vitin 2022, për shitjen e aseteve përmes valës të privatizimit kemi pranuar pagesa në vlerën totale prej EUR 6,152,060 për shitje të aseteve për valën 24-25 (tenderuar vite me parë), valës 55-60 të tenderuara gjatë vitit 2022 si dhe shitja e aseteve të paluajtshëm.

Ndërsa, vlera totale e kontratave të nënshkruara - shitje të realizuara është EUR 4,654,189 nga pagesat e pranuar në total EUR 6,152,060. Diferenca është në proces si rezultat i prerjes të vitit fiskal.

Gjithashtu vlen të theksohet se nga muaji mars 2020 deri në qershor 2022 nuk ka pasur valë të shitjeve. Kjo për shkak të kufizimeve të pandemisë, por pastaj edhe me vendimin e Qeverisë që të pezullohet përkohësisht procesi i valëve të privatizimit.

Për vitin 2020, është realizuar vetëm një valë e shitjes, vala 54. Vlera e kontratave të nënshkruara/shitje të realizuara vetëm për valën 54 e tenderuar gjatë vitit 2020 është EUR 1,867,530. Pjesa tjetër EUR 10,731,602 (12,599,132-1,867,530) është për valët e privatizimit të realizuara në vitet paraprake.

Procesi i shitjes ka rifilluar gjatë muajin qershor 2022 me valën (55 deri në valën 60) dhe të hyrat e realizuara nga shitjet të kontratave të nënshkruara vetme për këto valë është EUR 4,018,189.

2.2. PRANIMET E MJETEVE NGA QEVERIA PËR SHPRONËSIMIN E ASETEVE

Ndërmarrjet Shoqërore	Vlera	Komente
MIT101 – Jugobanka	364,872	20% e shumës të totale të shpronësimit prej EUR 1,824,360. Prona është shpronësuar për nevojat e institucionit Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PRN011 - Drenica	84,200	20% e shumës të totale të shpronësimit prej EUR 421,002. Prona është shpronësuar për nevojat e institucionit Komuna e Drenasit
PRN165 - GLLOGOVCI CIKATOVA E RE	103,590	20% e shumës të totale të shpronësimit prej EUR 517,952. Prona është shpronësuar për nevojat e institucionit Komuna e Drenasit
PRN170 - Jugopetroll	123,390	20% e shumës të totale të shpronësimit prej EUR 616,950. Prona është shpronësuar për nevojat e institucionit Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PRZ022 – Ndërmarrja e Pyjeve	248,000	20% e shumës të totale të shpronësimit prej EUR 1,240,000. Prona është shpronësuar për nevojat e institucionit Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PRZ008 – OBP Mirusha	33,946	20% e shumës të totale të shpronësimit prej EUR 169,725. Prona është shpronësuar për nevojat e institucionit Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
PRN029 – Kooperative Bujqësore Përparimi	409,263	20% e shumës të totale të shpronësimit prej EUR 2,046,314.50. Prona është shpronësuar për nevojat e institucionit Komuna e Podujevës
GJITHSEJ	1,367,261	

2.3. SHITJET E ASETETE ME NEGOCIM DIREKT

Përshkrimi	Kontrata të nënshkruara					Pagesa në proces	Pagesa të pranuar në total
	A	B	C	D	E=Σ(A:D)		
	2022	2021	2020	2019			
<i>Pranimet</i> gjatë vitit 2018	-	-	15,334	397,611	-	-	412,945
<i>Pranimet</i> gjatë vitit 2019	-	-	70,281	2,837,533	-	-	2,907,814
<i>Pranimet</i> gjatë vitit 2020	-	340,439	5,619,923	-	70,797	70,797	6,031,159
<i>Pranimet</i> gjatë vitit 2021	105,154	1,172,590	-	-	29,728	29,728	1,307,472
<i>Pranimet</i> gjatë vitit 2022	11,180	-	-	-	19,240	19,240	30,420
GIITHSEJ	116,334	1,513,029	5,705,538	3,235,144	119,765	119,765	10,689,810

Tabela e paraqitur më lartë paraqet raportin ndërmjet pagesave të pranuar ndër vite dhe kontratat e nënshkruara në vitet përkatëse. Janë nënshkruar vetëm dy kontrata në vlerën totale prej EUR 116,334 nga procesi i iniciuar në vitet paraqara.

Vlen të përmendet se gjatë vitit 2022 nuk ka pasur aktivitet të shitjes të aseteve përmes negociimit direkt. Kjo sipas udhëzimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së i cili kishte për qëllim draftimin e rregullores së re lidhur me këtë procedurë të shitjes. Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka aprovuar rregulloren e re për shitjen e aseteve me negociim direkt.

Ndërsa shitjet e realizuara/kontrata të nënshkruara gjatë vitit 2021 prej EUR 1,513,029 përbëjnë totalin e 101 aseteve të shitura/kontratave të përfunduara. Siç është shënuar në tabelën më lartë, vlera prej EUR 1,513,029 përbëhet nga pagesat e vitit 2020 EUR 340,439 dhe pagesat e vitit 2021 prej EUR 1,172,590.

3. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020	2022 vs		2003 deri 31 dhjetor 2022
				2021	2020	
Qiratë në llogaritë e NSH-ve në tranzicion	262,542	415,269	679,662	(36.78)%	(61.37)%	16,545,117
Qiratë në llogaritë e NSH-ve në likuidim	4,579,737	4,715,085	2,524,978	(2.87)%	81.38%	35,905,928
Qiratë nga komercializimi	-	-	-	0.00%	0.00%	5,021,318
GJITHSEJ	4,842,279	5,130,354	3,204,640	(5.62)%	51.10%	57,472,363

Në përgjithësi, dhënia e aseteve me qira për këto NSH janë: lokalet, toka bujqësore, pikat e shitjes të derivateve, depot dhe të tjera.

- **Qiratë e NSH-ve në tranzicion** janë për periudhën para se NSH të hyjë në likuidim;
- **Qiratë në llogaritë e NSH-ve në likuidim** janë gjatë periudhës për NSH-të për të cilat janë në proces të likuidimit; dhe
- **Qiratë nga NSH e komercializuar** - Në këtë pozicion janë të paraqitura bilanci e pranimeve për kontratat e periudhës sa NSH ka qenë e komercializuar dhe të nënshkruara gjatë vitit 2000 nga UNMIK. Vlera e tërësishme e inkasimeve, nga viti 2003 deri në datën raportuese është EUR 5,021,319. Nga data 16 qershor 2012, AKP-ja nuk ka realizuar qira përmes metodës të komercializimit, sepse këto asete të NSH-ve ose janë shitur ose janë në proces të likuidimit.

Në krahasim me vitin 2021, kemi 5.62% më pak inkasim të të hyrave të qirave. Në vitin 2021, inkasimi ka qenë më i madh për shkak të inkasimeve të borxheve të vitit 2020. Nëse i referohemi pasqyrave financiare të vitit 2021, kemi zvogëlim të llogarive të arkëtueshme prej EUR 151,876 në krahasim me vitin 2020. Shtu këtu që gjatë vitit 2022 asetet e lëshuara me qira për NSH-të “Rilindja” tani më janë shpronësuar dhe nuk NSH-të “Rilindja” nuk kanë me aktivitet të hyra të qiradhënies.

Më poshtë janë paraqitur ndarazi tabletat e të hyrave të qirave për NSH në tranzicion dhe ato në likuidim duke i listuar disa NSH me të hyra të mëdha.

3.1. QIRAJA E INKASUAR PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE NË TRANZICION

PËRSHKRIMI	2022	2021	2020	2022 Vs		KOMENTE
				% 2021	% 2020	
NSH Jugopetrol	-	-	105,272	(100)%	(100)%	Ka hyrë në likuidim më 26 shkurt 2021. Shih edhe shënimin nr. 3.2
NSH Virxhinia	-	2,687	27,548	(100)%	(100)%	Ka hyrë në likuidim më 18 janar 2021. Shih edhe shënimin nr. 3.2
NSH Ina Trgovina	-	317,633	443,323	(100)%	(100)%	Ka hyrë në likuidim më 18 janar 2021. Shih edhe shënimin nr. 3.2
RTP	-	10,000	57,590	(100)%	(100)%	Ka hyrë në likuidim më 18 janar 2021. Shih edhe shënimin nr. 3.2
NSH Metaliku	116,824	43,766	22,619	166.93%	416.49%	Kemi dhënie te aseteve te reja me qira por kemi edhe një avans te paguar prej 23,471 e cila pagese ka ndikuar drejtpërdrejtë ne rritjen e te hyrave ne vitin 2022. Në vitin 2023 ky avans do te reflekton ne te hyra me te vogla ne vitin 2023.
Metaliku Fab e Eneve	101,114	31,679	2,905	219.18%	3380.69%	Kontratë të re të qirasë bazuar ne vendimin e Bordit te Drejtoresve te AKP-se dhe ku tani te hyrat janë me te mëdha se me kontratat paraprake
NSH Liria	11,446	2,700	2,000	323.93%	472.30%	Dy asete te lëshuara me qira ku njërin aset përpos pagesave të vitit të fundit kemi pranuar edhe të tri viteve paraprake bazuar ne Udhëzimin për trajtimin e uzurpatoreve
Newco AgroKosova	22,461	-	-	100%	100%	Agrokosova nuk ka pasur ne vitin paraprak te hyra nga qiraja por e kemi menaxhuar vetëm një periudhe te shkurtër tre mujore
NSH tjera në tranz.	10,697	6,804	18,405	57.22%	(41.88)%	
GJITHSEJ	262,542	415,269	679,662	(36.78)%	(61.37)%	

Ndërmarrjes së Re "Agrokosova Holding" me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e 31 janarit 2022 për shkak të mos përmbushjes së marrëveshjes së zotimeve iu janë tërhequr aksionet. Pas marrjes së aksioneve ndërmarrja është vendosur në Administrim Direkt të AKP-së dhe janë zgjedhur Bordi i Përkohshëm Menaxhues, Drejtori Menaxhues dhe janë punësuar punëtorët bazuar në kërkesat e paraqitura nga Bordi dhe Menaxhmenti i ndërmarrjes. Gjatë periudhës së menaxhimit të ndërmarrjes nga AKP-ja janë zhvilluar një numër i madh aktivitetsesh që janë lidhë me mbrojtjen e verës e cila ka qenë në rezervar si dhe aktivitetet që janë lidhë mu kultivimin dhe mbrojtjen e kulturave të vreshtave dhe kulturave tjera pemëtarë dhe bimore. Blerësi ka bërë ankesë/padi në vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së në DHPGJS dhe ka kërkuar vendosjen e masës së sigurisë kundër vendimit të Bordit të AKP-së ku në shkallë të parë të Gjykatës iu është refuzuar ankesa e blerësit, pas kësaj Blerësi ka bërë ankesë në shkallën tjetër dhe ku nga Shkalla e dytë e DHPGJS është aprovuar masa e sigurisë ndaj vendimit të Bordit për këtë ndërmarrje sipas të cilës masë deri në vendim marrje përfundimtare kjo ndërmarrje do të menaxhohet nga Blerësit. Nga momenti i vendosjes së masës së sigurisë në maj të vitit 2022 ndërmarrja më nuk administrohet dhe monitorohet nga AKP-ja.

3.2. QIRAJA E INKASUAR PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE NË LIKUIDIM

PËRSHKRIMI	2022	2021	2020	2022 vs		KOMENTE
				% 2021	% 2020	
Grand Hoteli	559,442	486,303	215,517	15.04%	159.58%	1. Rilindja Shtypshkronja- Në vitin 2022 ka ardhur deri te zvogëlimi i inkasimit nga qiraja për shkak të largimit të shumë qiramarrësve/shpronësimi i aseteve të ndërmarrjes. 2. Urata - në vitin 2022 ka një rritje të inkasimit në krahasim me vitin 2021 për arsye të lëshimit të aseteve të reja me qira, ndërsa në vitin 2021 ka pasur zvogëlim(largim) të qiramarrësve. 3. Bankkos- inkasimet ne vitin 2020 kanë qenë më të ultë për arsye të pandemisë ku sipas vendimit të Qeverisë secili qiramarrës ka qene i liruar nga 3 muaj nga pagesa e qerasë. Ndërsa viti 2022 ka rënie te dukshme për arsye se 3 asete te Bankkos-it janë shitur 4. Auto Prishtina – gjatë vitit 2020 dhe 2021 ka ndikuar pandemia në funksionimin e bizneseve/organizatave dhe prandaj inkasimi ka qenë më i dobët. Ndërsa periudha e vitit 2022 veprimtaria e bizneseve është hapur dhe kanë qenë me efikas në pagesën e borxheve të qirave. 5. Mekanizimi - gjatë vitit 2020 në mungesë të numrit Unik nuk ka pasur mundësi të inkasohen të hyrat, dhe pas marrjes së numrit Unik në vitin 2021 është inkasuar borxhi i grumbulluar. Ndërsa në vitin 2022 kemi shkëputje të kontratës nga ana e qiramarrësit. 6. Jugopetroll - Ka hyrë në likuidim më 26 shkurt 2021 - shih shënimin nr. 3.1. Ndërsa për vitin 2022 kundrejt 2021 kemi ulje si rezultat i inkasimit të borxhit në vitin 2021 për vitet e mëparshme. 7. Ina Trgovina - Ka hyrë në likuidim më 26 shkurt 2021 dhe në llogari të tranzicionit ka inkasim EUR 317,633 - shih shënimin nr. 3.1. 8. Lavërtari - Në vitin 2020 ka inkasim përmes përmbaruesit të borxhit pastaj për vitet 2021 dhe 2022 kemi të hyra të rregullta 9. Bujqësia Fushë Kosovë - zvogëlimi i të hyrave të qirave për vitin 2022 krahasuar me 2020, ka ndodhur sepse disa parcela që kanë qenë nën kontrata të qiradhënies dhe janë shitur me negocim direkt. Po ashtu gjatë vitit 2020 dhe vitit 2021 ka pasur ri-programim të borxhit paraprak dhe se pagesat të jenë më të larta gjatë vitit 2021 sepse në vitin 2022 është paguar vetëm fatura mujore! 10. Liria Prizren Në vitin 2020 ka inkasim përmes përmbaruesit të borxhit 11. Jugobanka - Inkasim i borxhit në vitin 2021 për shkak të pengesave procedurale nga Thesari i Kosovës për qiramarrësin/institucion.
Tregu – Prishtinë	648,759	745,829	713,986	(13.02)%	(9.14)%	
ABC Genci	21,998	27,858	5,300	(21.04)%	315.06%	
Lux	122,700	109,224	88,701	12.34%	38.33%	
Rilindja Grafike ¹	113,185	210,070	143,809	(46.12)%	(21.29)%	
Rilindja Tregt. Librare	93,894	110,287	96,104	(14.86)%	(2.30)%	
Urata ²	48,282	29,683	50,587	62.66%	(4.56)%	
Bankos ³	62,702	98,678	44,787	(36.46)%	40.00%	
Auto Prishtina ⁴	139,748	77,217	67,684	80.98%	106.47%	
Mekanizimi ⁵	35,425	127,530	27,526	(72.22)%	28.70%	
IMN Kosova	13,519	32,974	36,453	(59.00)%	(62.91)%	
Germia	41,037	41,575	28,315	(1.29)%	44.93%	
Jugopetroll ⁶	735,823	914,880	193,862	(19.57)%	279.56%	
Ina Trgovina ⁷	837,902	632,633	-	32.45%	100.00%	
Lavertari Blegtori ⁸	30,965	31,355	208,041	(1.24)%	(85.12)%	
Banka e Vojvodinës	53,093	53,093	26,547	0.00%	100.00%	
Duhani	23,675	23,810	21,285	(0.57)%	11.23%	
Magjistrailja	40,024	34,061	33,804	17.51%	18.40%	
Bujqësia F. Kosove ⁹	19,922	29,502	23,807	(32.47)%	(16.32)%	
Përparimi	105,042	94,043	40,940	11.70%	156.58%	
Agrobisernica	26,160	25,901	22,322	1.00%	17.19%	
RTP	72,839	68,001	-	7.11%	100.00%	
Vërzhinia	33,163	31,159	-	6.43%	100.00%	
Liria Prizren ¹⁰	25,082	19,420	41,180	29.16%	(39.09)%	
Mladost Shtërpce	14,206	14,237	11,303	(0.22)%	25.68%	
Ereniku Prodhimtaria	40,912	37,692	29,586	8.54%	38.28%	
Drenica	23,853	24,271	22,260	(1.72)%	7.16%	
Jugobanka ¹¹	32,095	97,613	25,833	(67.12)%	24.24%	
NSH tjera në likuidim	564,290	486,186	305,439	16.06%	84.75%	
GUITHSEJ	4,579,737	4,715,085	2,524,978	(2.87)%	81.38%	

4. INTERESI I FITUAR

Viti	Interesi i fituar në llogari rrjedhëse	Interesi i fituar në afatizime (depozita kohor)	GJITHSEJ
2003	35,790	-	35,790
2004	228,337	-	228,337
2005	631,651	-	631,651
2006	3,898,373	-	3,898,373
2007	9,175,729	-	9,175,729
2008	11,585,047	-	11,585,047
2009	1,295,862	-	1,295,862
2010	342,621	308,730	651,351
2011	290,869	4,394,852	4,685,721
2012	126,734	2,380,145	2,506,879
2013	-	-	-
2014	-	144,960	144,960
2015	-	5,000	5,000
2016-2022	-	-	-
GJITHSEJ	27,611,013	7,233,687	34,844,700

Të hyrat nga interesi janë:

- interesi i fituar nga llogaritë rrjedhëse në Bankën Qendrore të Kosovës. Për informatën e juaj, nga Korrik 2012, norma e aplikuar e interesit nga BQK është **zero %**;
- interesi bankar i fituar nga afatizimi për periudhat nga 1 muaj deri në 12 muaj i një pjese të mjeteve nga llogaritë bankare të fondeve në mirëbesim. Nga Korriku i vitit 2015 nuk ka të hyra nga interesi.

Gjithsej interesi i përgjithshëm i fituar nga viti 2003 deri në datën raportuese është **EUR 34,844,700** në të gjitha llogaritë bankare të hapura në BQK. **Për vitin fiskal 2022, nuk ka pasur të hyra nga interesi për shkak të normave të cilat nuk janë pozitive.**

Sipas nenit 19B të ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-115 dhe me ligjin nr. 05/L-080 është paraparë që fondet teprice, fondet e mbetura dhe fondet e përkohshme, të gjitha të ardhurat e mbledhura nga Agjencia që mbahen në mirëbesim mund të investohen në instrumentet në vijim:

- Llogari rrjedhëse që paguan interes apo depozitë të afatizuar në Bankën Qendrore të Kosovës; dhe
- Letra me vlerë të borxhit të emetuara nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Kosovës ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

5. TË HYRAT NGA TARIFA DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE NË TENDERËT E SHITJES

PËRSHKRIMI	SHUMA
Gjendja më 1 janar	8,880,964
Tarifa për pjesëmarrje në tender	90,601
Kthimet e tarifës administrative/anulim tenderi apo raste tjera	(4,600)
*Konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve	25,500
Gjithsej të hyrat gjatë vitit në llogari për AKP	111,501
Gjendja më 31 dhjetor	8,992,465

Janë të hyra të realizuara për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Këto të hyra përfshijnë të hyra nga tarifat për paraqitjen e tenderëve dhe **konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve, të cilët nuk i kanë përmbushur kushtet e pagesës**. Këto të hyra inkasohen në llogaritë bankare, të cilat AKP, më përpara i ka hapur për qëllime të mbarëvajtjes të aktiviteteve operacionale dhe procedurale. Llogaritë janë si më poshtë:

- Tarifa për dorëzimin e ofertave të privatizimit;
- Tarifa për dorëzimin e ofertave të likuidimit; dhe
- Fondi Rezervë i AKP-së.

Këto të hyra janë inkasimet në llogari bankare të tarifës për dorëzimin e ofertave të likuidimit por që nuk janë alokuar në tërësi në llogari të tarifës administrative për shkak të mbylljes të vitit fiskal dhe nevojës për likuiditet bankar në këto llogari. Në ndërlidhje shih dhe shënimin nr. 15.

6. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER

PËRSHKRIMI	SHUMA
Gjendja më 1 janar	0.00
BID Depozitat e paguara nga ofertuesit për tender	3,729,200
Kthimi i BID Depozitave ndaj Ofertuesve të pasuksesshëm	(3,146,494)
Bartje e BID dep. në llogari të NSh-ve (nënshkrimi i kontratave)	(356,206)
*Konfiskimet e Bid depozitave nga llogaria e bid depozitave	(15,500)
Gjithsej bilanci i pranimeve gjatë vitit	211,000
Gjendja më 31 dhjetor	211,000

Janë të hyra nga BID depozitat e ofertuesve që kanë marrë pjesë në tender dhe për të cilët ende nuk ka përfunduar procesi i shitjes. Me përfundim të procesit të shitjes, bilanci bankar do të jetë zero, sepse me nënshkrimin e kontratave, këto mjete si BID depozita, si pjesë e vlerës së blerjes, transferohen në llogari të NSh-ve përkatëse, për të cilat janë shituar asetet. Këto të hyra gjenerohen në llogaritë bankare, të cilat AKP, më përpara i ka hapur për qëllime të mbarëvajtjes të aktiviteteve operacionale dhe procedurale. Llogaritë janë si më poshtë:

- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të privatizimit;
- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të likuidimit;

7. TË HYRA TJERA

PËRSHKRIMI	2022	2021	2020	2022 vs % 2021		% 2020	
Gjendja më 1 janar	7,600,934	7,452,604	7,352,098				
Inkasimet ditore në para të gatshme nga aktiviteti për NSH Tregu	4,909	1,500	2,664	227.27%	84.27%		
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSH ABC Genci	27,201	14,632	7,910	85.90%	243.88%		
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSH Grand Hotel	81,515	38,040	20,495	114.29%	297.73%		
Inkasimet nga llogari komerciale pasi që NSH ka hyrë në likuidim	2,570	-	43	100.00%	5876.74%		
Pranimet nga debitorët e NSH	42,178	51,194	2,181	-17.61%	1833.88%		
Marrëveshje për shfrytëzimin e minierave të Mim Golesh	13,088	41,349	67,213	-68.35%	-80.53%		
Nga përmbarimi i lëndës, borxhe të paguara për aktivitetin e NSH	9,270			100.00%	100.00%		
Të tjera	1,103	1,615	-	-31.70%	100.00%		
Gjithsej për periudhën	181,834	148,330	100,506	22.59%	80.92%		
Gjendja më 31 dhjetor	7,782,768	7,600,934	7,452,604				

Tabela më lartë paraqet gjendjen e inkasimeve nga viti 2003, për vitin aktual si dhe gjendjen me 31 dhjetor 2022.

Të hyrat tjera përfshijnë

- **Inkasimet ditore** – para të gatshme në të mirë të llogarive të NSH-ve përkatëse kanë të bëjnë me mjetet që pranojnë gjatë aktivitetit ditor për të hyrat si: bifet në kuadër të NSH, shitja e biletave, shërbimeve apo të tjera tek NSH të tilla si ABC Genci, NSH Grand Hotel si dhe NSH Tregu. Këto NSH janë në likuidim, llogaritë e të cilave i menaxhon dhe administron AKP;
- Marrëveshje për shfrytëzimin e minierave të Mim Golesh;
- Shitja e mallrave dhe shërbimeve;
- Dividenta dhe shitja e aksioneve;
- Transferimi i mjeteve nga llogaritë bankare të NSH-ve të cilat kanë qenë aktive dhe kanë pasur mjete në llogaritë e bankave komerciale; dhe
- NSH-të e paraqitur si kreditor për pretendimet e saj (Debitorët e NSH-ve).

8. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 04/L-034, Agjencia ka hapur llogarinë bankare për kapitalin themeltar. Gjithsej vlera e kapitalit themeltar është EUR 10 milion, ndërsa shuma e transferuar nga Qeveria është EUR 1 milion. Pjesa e mbetur prej EUR 9 milion mund të kërkohet nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së në kohën dhe në shumën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë.

Më poshtë janë të paraqitura detajet e kapitalit themeltar për të gjitha transaksionet nga viti 2003 deri në **datën raportuese**:

- **Të hyrat në llogarinë e kapitalit prej EUR 1,132,172**

- Të hyra nga pagesa e kapitalit themeltar prej EUR 1,013,200. Pagesa është realizuar nga Qeveria e Kosovës. Pagesa e kapitalit është bërë më 2 dhjetor 2003;
- Të hyrat nga interesi prej EUR 118,972. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 4.*

- **Pagesat nga llogaria e kapitalit prej EUR 237,389**

- Pagesat e vendimeve të Gjykatave prej EUR 237,380. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 14.*
- Shpenzimet bankare prej EUR 9. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 16*

- **Gjendja bankare në fund të periudhës 894,783**

V. SHPENZIMET/SHPËRNDARJA

9. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020	2003 31 dhjetor 2022
Llogari të privatizimit	-	-	314,342	76,621,084
Llogari të likuidimit	2,746,334	2,073,919	8,063,369	34,075,701
Llogari në mirëbesim për punëtorët e NSH-ve	3,927,493	1,628,130	8,123,696	49,530,649
GIJTHSEJ	6,673,827	3,702,049	16,501,407	160,227,434

Për periudhën raportuese, shuma prej EUR 6,673,827 është shpërndarë nga 57 ndërmarrje Shoqërore dhe janë gjithsej 8,816 punëtorë që ka përfutur nga kjo shpërndarje.

Ndërsa nga tërë procesi i shpërndarjes gjatë viteve 2003-2021 kanë përfutur gjithsej 51,830 punëtorë.

Vlerat e prezantuara në tabelën e paraqitur më lartë janë mjete që janë transferuar në llogari të BSPK për 20% e punëtorëve përmes llogarive:

- Llogarive të privatizimit - 20% nga shitja përmes privatizimit të ndërmarrjeve të reja të ndodhura kohë më parë;
- Llogarive të likuidimit - 20% nga shitja e aseteve të mbetura përmes likuidimit;
- Llogarive të likuidimit – mjete të pranuar sipas marrëveshjeve për shpronësimin e aseteve nga Qeveria dhe institucionet relevante; dhe
- **Llogarive në mirëbesim për punëtorët e NSH-ve** – mjete të mbajtura në mirëbesim vetëm për rastet që ka ankesa gjyqësore për listat e shpërndarjes.

LLOGARITË NË MIRËBESIM PËR PUNËTORËT E NSH-ve janë llogari bankare që janë hapur në Bankën Qendrore të Kosovës dhe administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Këto llogari bankare për NSH-të përkatëse janë hapur për qëllim të mbajtjes të parave në mirëbesim në emër të punëtorëve vetëm për rastet kur ka ankesa kundrejt listave për shpërndarje. Pjesa e pa transferuar e 20%-it vetëm për rastet që ka ankesa mbahen në mirëbesim dhe shpërndahen nga këto llogari me aprovimin final të listave të punëtorëve nga Gjykata. Gjendja e mjeteve në llogarit bankare në mirëbesim për punëtorët e NSH-ve është EUR 3,299,797 sipas datës 31 dhjetor 2022. Me shqyrtimin e kërkesave të 20% nga Gjykata, do të bëhet shpërndarja e tyre.

10. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSHP) PËR LIKUIDIMIN E NSH-ve

Raporti i pagesave nëpër vite ndaj Ofruesve të Shërbimeve Profesionale

VITET	1		2		3		4=1+2+3		5		6=4+5	
	KONTRATA BAZË		ANEKS KONTRATA		FIKSE		Gjithsej Deloitte		Curtis Fikse		Gjithsej	
	FIKSE	VARIABLE	FIKSE	ANEKS	FIKSE	ANEKS	Gjithsej Deloitte	Curtis	FIKSE	ANEKS	Gjithsej	
2012	1,228,009	-	-	-	-	-	1,228,009	-	-	-	1,228,009	
2013	1,228,009	2,781,117	-	-	-	-	4,009,126	-	-	-	4,009,126	
2014	491,204	3,277,988	-	-	-	-	3,769,192	-	-	-	3,769,192	
2015	245,602	1,458,973	-	-	-	-	1,704,575	-	-	-	1,704,575	
2016	1,731,916	1,566,112	415,000	-	-	-	3,713,028	-	-	-	3,713,028	
2017	-	-	996,000	-	-	-	996,000	-	-	-	996,000	
2018	-	-	581,000	-	-	-	581,000	-	-	-	581,000	
2019	-	-	-	-	-	-	-	136,309	-	-	136,309	
2020	-	-	-	-	-	-	-	480,868	-	-	480,868	
2021	-	-	-	-	-	-	-	358,250	-	-	358,250	
2022	-	-	-	-	-	-	-	429,900	-	-	429,900	
GJITHSEJ	4,924,740	9,084,190	1,992,000	16,000,930	1,405,327	17,406,257						

Raporti i pagesave sipas kontratave ndaj Ofruesve të Shërbimeve Profesionale

Kontraktori	Lloji i pagesave	Vlera e kontraktuar	Pagesa	% e pagesave
Deloitte	kontrata bazë - variable	13,003,564	9,084,190	70%
	Kontrata bazë fikse	4,924,740	4,924,740	100%
	Aneks kontrata fikse	1,992,000	1,992,000	100%
Curtis	Kontrata bazë fikse	2,499,000	1,405,327	56%

GJITHSEJ 22,419,304 17,406,257 78%

Pagesat variable – janë pagesa të realizuara për secilin vendim të aprovuara/refuzuara të kërkesave të kreditorëve ndaj NSH-ve.

Pagesat fikse janë pagesa ndaj OSHP-së për kryerjen e shërbimeve sipas kushteve të kontraktuara. Pagesat fikse janë aplikuar në tri kontrata: kontratën bazë me “Deloitte” (pagesa çdo TM); aneks kontratën me “Deloitte” (pagesa mujore); dhe kontratës bazë me “Curtis” (pagesa mujore).

1. Pagesat ndaj Deloitte

Nga viti 2012 si ofrues i shërbimeve profesionale ka qenë i angazhuar “Deloitte Central Europe Limited” nëpërmjet kontratës bazë 11 korrik 2012 – 9 korrik 2016 dhe aneks kontratës 8 gusht 2016 – 7 gusht 2018. Kontrata bazë ishte EUR 19.9 milion (13+4) dhe aneks kontrata prej EUR 1.9 milion.

2. Pagesat ndaj Curtis

Me përfundimin e kontratës me “Deloitte”, është angazhuar kontraktori tjetër “Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton L.L.C”. Periudha e angazhimit është pesëvjeçare (5), nga 1 korrik 2019 deri me 30 qershor 2024 në vlerën EUR 2,499,000.

10.1 Shënim lidhur me pagesat e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OSH):

Në bazë të nenit 20 të ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-115, me ligjin nr. 05/L-080 dhe me vendim të Bordit të Drejtorëve:

a) *Tarifa fikse e Autoritetit të Likuidimit paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin e caktimit të saktë të koston fikse proporcionalisht për secilën ndërmarrje shoqërore në likuidim, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria bankare e ndërmarrjes në likuidim;*

b) *Tarifa variabile (për kërkesat e shqyrtuara) e Autoritetit të Likuidimit dhe koston tjera të paraqitura në koston 1.1 dhe 1.3 të nenit 40.1 të shtojcës së ligjit nr. 04/L-034 paguhen nga fondet e ndërmarrjes në likuidim. Në rast se ende nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit, atëherë tarifa variabile paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.*

10.2. GARANÇIONI BANKAR

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar sigurimin e ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës nga Konzorciumi “Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo, Shkup dhe Grant Thornton L.L.C.”; rr. Rexhep Mala, Prishtinë për “Angazhimi i Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OSH) për procesin e likuidimit për të gjitha Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet nën administrimin e AKP-së” (me numër të prokurimit: 239-18-9399-2-1-1).

Detajet e garancionit bankar janë si vijon: data e garancionit është 26 Qershor 2019, shuma e garancionit 249,900.00, emri i bankës që ka lëshuar garancionin është Raiffeisen BANK, Prishtinë Kosovë.

11. MALLRA DHE SHËRBIME

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Pagesat ndaj palëve të jashtme	1,832,153	2,371,692	2,147,691
Kompensimi i tarifës administrative	(31,600)	(46,002)	0.00
Gjithsej	1,800,553	2,325,690	2,147,691
Krahasimet ndërmjet vitit 2022 me vitet 2021 dhe 2020			
	ndryshimi %	(525,137) (22.58)%	(347,138) (16.16)%

PËRMbledhje e Pagesave NDAJ PALËVE TË JASHTME 2022	SHUMA
Ofruesit e Shërbimeve dhe pagat e punëtorëve (NSH Virxhinia, Metaliku etj.)	1,282,520
Shpenzimet e përfaqësimit për arbitrazh ndërkombëtar për Newco MIM Golesh	134,500
Shpenzime për aktivitetit e NSH Grand, furnizime për zyre, pije, rregullime, etj.	35,458
Shërr. Prof. - Angazhimi i përbaruesve/përfaqësime ligjore dhe ekspertizë ligjore	24,746
Qiraja e paguar nga NSH Tregu (për hapësirat e përbashkëta)	36,000
Shërbime për furnizim me filma dhe shërbime të festivalit Prifest për ABC Genci	10,032
Pagesat e shërbimeve administrative për NSH Ndër. e Re Agrokosova	12,137
Blerja e materialit dhe paisjeve për mirëmbajtje të hapësirave të arkivave	5,089
Huazim i mjeteve për NSH Inex Sharr	48,610
Ngrohje qendrore (Termokos) për NSH Grand Hotel	61,856
Shpenzime të përkthimit dhe Komisioni i Pavarur i Minierave për MIM Golesh	1,628
Shpallje dhe Publikimet në gazeta vendore dhe ndërkombëtare për NSH-të	17,334
Dërgesa postare	9,855
Për NSH Furnizim me material/zyre, pastrim të hapësirave, abonim, rregullime, etj.	24,875
TVSH, Tatimet, Trustet Pensionale për OSH-të nga tarifa për NSH-të përkatëse	63,233
Shërbime komunale - rryma dhe uji të paguara nga tarifa administrative	10,435
Shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit	5,437
Shpenzimet nga paraja e imët për Zyrat Regionale	47,208
Provizione për ruajtjen e artikujve në Bankën Qendrore të Kosovës	1,200
GIJTHSEJ	1,832,153

Në përgjithësi në këtë kategori përfshihen pagesat për: ofruesve e shërbimeve për NSH në Likuidim dhe Pagat e Punëtorëve – NSH në tranzicion; qiraja, shpenzime për reklamim, shërbime profesionale dhe mirëmbajtja dhe ruajtja e aseteve.

Ulja e shpenzimeve kundrejt vitit 2021 është kryesisht rezultat i ndëprerjes të angazhimeve të OSH-ve por edhe të pagesave të arbitrazhit ndërkombëtar që janë bërë në vlerën prej EUR 405,080 për rastin e Ndërmarrjes së Re Sharrcem.

Ndërsa në krahasim me vitin 2020, ulja e shpenzimeve kryesisht është si rezultat i pagesave të arbitrazhit ndërkombëtar që janë bërë në vitin 2020 në shumën prej EUR 564,500 për rastin e Ndërmarrjes së Re Sharrcem.

1. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shembull në vitin 2022, shuma prej EUR 31,600 paraqitet si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndërsa në anën tjetër është paraqitur si shpenzim (plus) në kategorinë e shërbimeve publike, taksave gjyqësore etj. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSH-ve përkatëse dhe pastaj kjo llogari kompensohet nga llogaritë këtyre e NSH-ve.

PAGESAT NDAJ PALË TË JASHTME

Sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim ndaj palëve të jashtme, ato janë paraqitur në tabelën e dytë në anën e majtë. Këto pagesa janë realizuar nga llogaritë e NSH-ve në tranzicion, likuidim dhe tarifa administrative e Agjencisë.

11.1. PAGESAT NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMEVE DHE PAGAT E PUNËTORËVE PËR NSH NË TRANZICION

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE TË REALIZUARA

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020	2022 vs	
				2021	2020
Paga të punëtorëve	174,674	64,598	156,348	170.40%	11.72%
Ofrues të Shërbimeve si roje	475,300	616,046	448,279	(22.85)%	6.03%
Ofrues të Shërbimeve për shërbime tjera	632,546	1,042,940	743,524	(39.35)%	(14.93)%
GJITHSEJ	1,282,520	1,723,584	1,348,151	(25.59)%	(4.87)%

PËRMBLEDHJE E NUMRIT TË OSH-ve TË ANGAZHUAR

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020	2022 vs	
				2021	2020
Pagat dhe Bordi i Agrokosova	132	-	-	100%	100%
Paga të punëtorëve	12	18	59	(33.33)%	(79.66)%
Ofrues të Shërbimeve si roje	159	202	155	(21.29)%	2.58%
Ofrues të Shërbimeve për shërbime tjera	182	269	211	(32.34)%	(13.74)%
GJITHSEJ	485	489	425	(0.82)%	14.12%

Angazhimi i ofruesve të shërbimeve bëhet në përputhje me rregulloren për angazhimin e OSH-ve. Përveç rregullores, për rastet e NSH-ve në likuidim, këto shpenzime janë të lejuara sipas kornizës buxhetore të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve. Gjithsesi, vlen të theksohet se përveç kornizës buxhetore të llojeve të shpenzimeve të lejuara, me aprovim të Bordit caktohet edhe kufiri maksimal i shumës së buxhetuar për shpenzim për 29 kode të planit kontabël të fondeve në mirëbesim. Sipas procedurës, për të angazhuar Ofrues të Shërbimeve për NSH përkatëse, përparësi kanë ish-punëtorët e atyre Ndërmarrjeve Shoqërore. Sa i përket OSH-ve të angazhuar si roje në të gjitha NSH-të, nga viti 2016, si pjesë strategjike e Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxhmentit të AKP-së është paraparë që ruajtja e aseteve të bëhet nëpërmjet angazhimit të OSH-ve dhe jo nëpërmjet operatorëve ekonomik. Ky veprim ka rezultuar me efekt pozitiv në kursimet e mëdha buxhetore për NSH-të përkatëse krahasuar me periudhat e mëhershme.

Po ashtu, vlen të theksohet se në muajin dhjetor 2021 është marrë vendim që me përfundimin e periudhës të angazhimit të mos ju vazhdohet angazhimi i 164 OSH-ve. Vlera totale e kursimit për ndërprerjen e angazhimit është EUR 717,540. Po ashtu në qershor 2022, nuk iu është vazhduar kontrata edhe 41 OSH-ve me kursime EUR 217,980. Numri prej 485 në vitin 2022 e përbënë edhe numri prej 132 punëtorëve të angazhuar të Ndërmarrjes të re Agrokosova për periudhën e përkohshme të administrimit nga AKP.

Gjithsesi detaje janë paraqitur në faqen tjetër.

PËRMBLEDHJE E NUMRIT TË OSH-ve TË ANGAZHUAR

Lista sipas disa NSH-ve me shpenzime mbi EUR 4,000 të realizuara gjatë vitit 2022 dhe ato të prezantuara në vitin 2021 dhe 2020 për Ofresit e Shërbimeve dhe Paga

Emri i NSH-së	SHUMA 2022	SHUMA 2021	SHUMA 2020	2022 vs 2021		2022 vs 2020		Numri i OSH-ve	
				Shuma	%	Shuma	%	2022	2021
Mim Golesh	62,997	145,041	127,388	(82,044)	(56.57)%	(64,391)	(50.55)%	19	42
NSH Virxhinia	17,236	44,763	22,907	(27,527)	(61.49)%	(5,671)	(24.76)%	7	19
NSH Metaliku Fabrika e Enëve	13,789	13,718	3,155	71	0.52%	10,634	337.05%	4	6
NSH Metaliku	22,263	22,000	2,896	263	1.20%	19,367	668.75%	7	7
*Ndërmarrja e re AgroKosova	135,848	-	-	135,848	100.00%	135,848	100.00%	132	0
Jugopetrol	6,980	13,960	9,065	(6,980)	(50.00)%	(2,085)	(23.00)%	3	3
Tregu- likuidim	172,644	288,865	294,573	(116,221)	(40.23)%	(121,929)	(41.39)%	55	93
Hotel Grand	306,934	305,779	309,184	1,155	0.38%	(2,250)	(0.73)%	81	75
ABC Genci	65,624	68,136	63,933	(2,512)	(3.69)%	1,691	2.64%	15	15
Morava Partesh	7,256	14,422	12,661	(7,166)	(49.69)%	(5,405)	(42.69)%	4	4
Zarije Bujic	11,805	14,165	12,574	(2,360)	(16.66)%	(769)	(6.12)%	4	4
Lola Shterpce	26,198	24,470	23,238	1,728	7.06%	2,960	12.74%	7	8
FAM VITI	14,859	14,905	13,182	(46)	(0.31)%	1,677	12.72%	4	5
Hotel Brezovica	13,819	12,667	11,619	1,152	9.09%	2,200	18.93%	4	4
Xim Strezovci	28,603	28,331	25,322	272	0.96%	3,281	12.96%	8	8
Transkosova	-	-	6,656	-	0.00%	(6,656)	(100.00)%	0	0
Shpezëtaria	6,909	13,818	12,352	(6,909)	(50.00)%	(5,443)	(44.07)%	2	4
IMN Kosova	-	31,877	34,162	(31,877)	(100.00)%	(34,162)	(100.00)%	0	10
Rilindja shtyp.	-	-	25,047	-	0.00%	(25,047)	(100.00)%	0	0
Perparimi	4,653	27,984	28,941	(23,331)	(83.37)%	(24,288)	(83.92)%	2	8
Bankos	4,769	38,341	40,307	(33,572)	(87.56)%	(35,538)	(88.17)%	2	9
Lavertari Blegtori	16,128	18,472	17,572	(2,344)	(12.69)%	(1,444)	(8.22)%	5	5
IGK Ballkan	21,304	26,485	27,636	(5,181)	(19.56)%	(6,332)	(22.91)%	7	8
NSH Unimont	10,364	12,955	12,667	(2,591)	(20.00)%	(2,303)	(18.18)%	3	4
Shar Drvoexport	14,970	12,667	11,756	2,303	18.18%	3,214	27.34%	4	4
Sharrcem	-	7,433	17,920	(7,433)	(100.00)%	(17,920)	(100.00)%	0	1
Ina Trgovina	11,563	36,452	45,510	(24,889)	(68.28)%	(33,947)	(74.59)%	10	16
RTP	2,443	4,759	7,393	(2,316)	(48.67)%	(4,950)	(66.96)%	1	1

EUP ENGINEERING	2,327	5,429	9,147	(3,102)	(57.14)%	(6,820)	(74.56)%	1	2	3
Eximkos	-	13,572	13,960	(13,572)	(100.00)%	(13,960)	(100.00)%	0	3	3
Ratar	2,327	18,613	7,344	(16,286)	(87.50)%	(5,017)	(68.31)%	1	4	4
Farmakos	3,415	13,480	5,543	(10,065)	(74.67)%	(2,128)	(38.39)%	3	4	4
Agromorava	-	13,960	-	(13,960)	(100.00)%	-	0.00%	0	3	0
Jugoterm	4,838	8,397	1,152	(3,559)	(42.38)%	3,686	319.97%	4	4	2
Lahor Shterpcë	14,970	12,101	-	2,869	23.71%	14,970	100.00%	4	4	0
Lux	-	18,845	-	(18,845)	(100.00)%	-	0.00%	0	4	0
Ereniku Industria	14,899	31,947	-	(17,048)	(53.36)%	14,899	100.00%	7	11	0
Ereniku Prodhimtari Primare	-	7,954	1,879	(7,954)	(100.00)%	(1,879)	(100.00)%	0	3	3
Bouite Mine Voljak	50,130	51,314	-	(1,184)	(2.31)%	50,130	100.00%	14	17	0
IMF Kosova	-	28,077	-	(28,077)	(100.00)%	-	0.00%	0	6	0
Ramiz Sadiku	2,327	37,932	7,256	(35,605)	(93.87)%	(4,929)	(67.93)%	1	8	2
Germia	9,306	44,972	4,265	(35,666)	(79.31)%	5,041	118.19%	4	10	4
Urata	6,909	23,266	7,708	(16,357)	(70.30)%	(799)	(10.37)%	3	5	2
Fabrika e Municionit	13,243	1,727	-	11,516	666.82%	13,243	100.00%	4	3	0
OSH për më shumë NSH	99,145	-	-	99,145	100.00%	99,145	100.00%	58	0	0
NSH tjera	58,726	149,533	70,281	(90,807)	(60.73)%	(11,555)	(16.44)%	25	35	29
					Raste të transferuara ndërmjet NSH-ve			(34)	0	(10)
GIITHSEJ PAGESAT	1,282,520	1,723,524	1,348,151		GIITHSEJ Numri i OSH-ve			485	489	425

***Ndërmarrjes së Re "Agrokosova Holding"** me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e 31 janarit 2022 për shkak të mos përmbushjes së marrëveshjes së zotimeve iu janë tërhequr aksionet. Pas marrjes së aksioneve ndërmarrja është vendosur në Administrim Direkt të AKP-së dhe janë zgjedhur Bordi i Përkohshëm Menaxhues, Drejtori Menaxhues dhe janë punësuar punëtorët bazuar në kërkesat e paraqitura nga Bordi dhe Menaxhmenti i ndërmarrjes. Gjatë periudhës së menaxhimit të ndërmarrjes nga AKP-ja janë zhvilluar një numër i madh aktivitetsesh që janë lidhë me mbrojtjen e verës e cila ka qenë në rezervar si dhe aktivitetet që janë lidhë mu kultivimin dhe mbrojtjen e kulturave të vreshtave dhe kulturave tjera pemëtarë dhe bimore. Blerësi ka bërë ankesë/padi në vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së në DHPGJS dhe ka kërkuar vendosjen e masës së sigurisë kundër vendimit të Bordit të AKP-së ku në shkallë të parë të Gjykatës iu është refuzuar ankesa e blerësit, pas kësaj Blerësi ka bërë ankesë në shkallën tjetër dhe ku nga Shkalla e dytë e DHPGJS është aprovuar masa e sigurisë ndaj vendimit të Bordit për këtë ndërmarrje sipas të cilës masë deri në vendim marrje përfundimtare kjo ndërmarrje do të menaxhohet nga Blerësit. Nga momenti i vendosjes së masës së sigurisë në maj të vitit 2022 ndërmarrja më nuk administrohet dhe monitorohet nga AKP-ja.

11.2. SHPENZIMET E PARASË SË IMËT

PËRSHKRIMI	Avanset	Shpenzimet	Mjetet e kthyer
ZR e Pejës	4,000	1,612	2,388
ZR e Prishtinës	5,000	4,148	852
ZR e Gjilanit	3,000	850	2,150
ZR e Mitrovicës	3,000	542	2,458
ZR e Prizrenit	5,000	2,152	2,848
Taksa gjyqësore	40,000	37,904	2,096
GJITHSEJ – PARAJA E IMËT	60,000	47,208	12,792
** ARKA PËR UDHËTIME ZYRTARE	6,600	5,437	1,163
GJITHSEJ	66,600	52,645	13,955

Paraja e imët e dhënë në avans ka të bëjë me shpenzimet e vogla për NSH-të përkatëse. Avanset tërhiqen nga llogaria e tarifës administrative në fillim të vitit dhe sipas kërkesave shtesë nga ZR-të. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të vogla të tilla si taksa gjyqësore, taksa për certifikata të pronësisë, shpenzime të nevojshme të vogla për mirëmbajtjen e aseteve dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të NSH-ve në likuidim.

**Paraja e imët e dhënë në avanset për udhëtime zyrtare kanë të bëjnë me shpenzimet jashtë vendit. Këto shpenzime janë për përfaqësime në Gjykata për mbrojtjen e aseteve që gjenden jashtë vendit. Llogaritjet e shumës për udhëtime jashtë vendit bëhet sipas rregullave të Ministrisë së Financave dhe procedurës të aprovuar nga AKP për udhëtimet zyrtare jashtë vendit.

12. SHPENZIME KOMUNALE

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Pagesat ndaj palëve të jashtme	202,422	221,229	184,150
Kompensimi i tarifës administrative	4,414	11,992	0.00
Gjithsej	206,836	233,221	184,150
Krahasimet ndërmjet vitit 2022 me vitet 2021 dhe 2020	ndryshimi %	(26,385) (11.31)%	22,686 12.32%

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Shpenzime për furnizim me ujë	16,839	12,059	4,703
Rrymë	107,626	121,945	90,265
Pastrimin e mbeturinave	73,012	81,580	85,309
Shërbimet e telekomunikimit	4,945	5,645	3,873
Gjithsej	202,422	221,229	184,150

Kanë të bëjnë me pagesat e realizuara për shërbimet publike (rrymë, ujë, telefoni dhe shërbimet e telekomunikimit) për Ndërmarrjet Shoqërore në tranzicion dhe në Likuidim që kanë aktivitete të përditshme.

Ujja e shpenzimeve komunale kundrejt vitit 2021 është kryesisht si rezultat i kompensimit të tarifës administrative që është më e madhe në vitin 2021 në krahasim me vitin 2022. Kështu që duke parë pagesat reale ndaj shërbimeve komunale prej EUR 202,422, atëherë shpenzimet janë ulur prej 8.5%. Ndërsa në krahasim me vitin 2020, shpenzimet janë më të mëdha për shkak se gjatë vitit 2020 ishte vit i pandemisë dhe për disa NSH ka pasur pezullim të aktiviteteve si rezultat i masave qeveritare.

1. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Për vitin 2022, shuma prej EUR 4,414 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e komunalive ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSH-ve përkatëse.

13. TATIMET**PËRSHKRIMI VITI 2022 VITI 2021 VITI 2020**

Pagesat ndaj palëve të jashtme	815,845	3,313,319	776,016
Kompensimi i tarifës administrative	3,253	1,544	0
Gjithsej	819,098	3,314,863	776,016
Krahasimet ndërmjet vitit 2022 me vitet 2021 dhe 2020	ndryshimi %	(2,495,765) (75.29)%	43,082 5.55%

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	595,985	696,981	512,967
Tatimi nga të hyrat e realizuara/qiratë	43,261	43,545	40,056
Kontributet pensionale - Trusti	95,121	132,059	115,278
Tatimi në të ardhurat personale	35,566	51,580	41,822
Tatimi në Pronë – Komunave	45,912	1,223	65,893
Urdhër-vjelja nga ATK	-	2,387,931	-
Gjithsej	815,845	3,313,319	776,016

Ulja e shpenzimeve kundrejt vitit 2021 është kryesisht si rezultat i ekzekutimit të urdhër-vjeljeve tatimore nga ATK në llogaritë bankare të NSH-ve “Kosovatrans”. Urdhër vjelja është realizuar në vitin 2021. Me vendim të Bordit të AKP-së, këto NSH kanë kaluar në pronësi të komunave përkatëse dhe i është ndërruar statuti juridik nga NSH në Ndërmarrje Publike. Mjetet kanë qenë në llogari bankare në BQK, të cilat AKP i ka administruar më përpara, por me ndërrimin e statutit si ndërmarrje publike, mjetet kanë qenë të destinuar për t’u bartur në llogari të komunave përkatëse. Gjatë kësaj periudhe të tranzicionit, ATK ka lëshuar urdhër-vjeljet tatimore si rezultat i borxheve tatimore që kishin këto ish-NSH. Gjithsesi, ATK do të realizonte urdhër-vjeljet tatimore edhe në llogaritë bankare të komunave që do të hapeshin për “Kosovatrans” si Ndërmarrje Publike.

Po ashtu në krahasim me vitin 2021 kemi ulje të shpenzimeve në tatimin në të ardhura personale dhe kontributet pensionale. Kjo si rezultat i ndërprerjes/mos vazhdimit të kontratave të OSH-ve – shih shënimin shpjegues nr. 11.1.

2. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Për vitin 2022, shuma prej EUR 3,253 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e tatimeve ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSH-ve përkatëse.

14. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Pagesat ndaj palëve të jashtme	5,347,349	200,744	386,286
Kompensimi i tarifës administrative	19,283	12,421	-
Gjithsej	5,366,632	213,165	386,286
Krahasimet ndërmjet vitit 2021 me vitet 2020 dhe 2019	ndryshimi %	5,153,467 2,417.60%	4,980,346 1,289.29%

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Taksa Gjyqësore	340	3,755	5,520
Ekspertizat për Gjykatë	-	912	1,267
*Ekzekutimi i pagesave nga përmbaruesi privat	3,500,632	-	154,077
**Ekzekutimi i pagesës ndaj palës me vendim të Gjykatës	1,864,486	-	422
Depozitë për (kthimet - nga) Gjykata	(18,109)	196,077	225,000
Gjithsej	5,347,349	200,744	386,286

Detajet janë të paraqitura në faqen tjetër.

Shënim detaj

*** Ekzekutimi i pagesave nga përmbaruesi privat** Më datën 29 dhjetor 2022 nga BQK është bërë ekzekutimi i urdhrit përmbarimor p.nr 001/20 i mjeteve bankare nga llogaria e NSH në likuidim Newco Llamkos Steel. Vlera e ekzekutimit nga BQK është gjithsej 3,500,632. Ky ekzekutim i pagesës është në kundërshtim me nenin 10 të shtojcës të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. AKP, në ditën që është ekzekutuar urdhri përmbarimor, ka njoftuar me ngjarjen në fjalë gjitha palët: BQK, Prokuroria, Gjykata, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe Oda e Përmbaruesve. Më 30 dhjetor 2022 AKP ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ka bërë kërkesë për ngrirjen e përkohshme të llogarive bankare të përmbaruesit privat. Më 4 janar 2023 Prokuroria Speciale ka lëshuar “Urdhër për të parandaluar tërheqjen e mjeteve nga llogaria bankare” të përmbaruesit privat si dhe avokatit të kreditorit. Më 6 janar 2023 Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special ka lëshuar “Urdhër Ndalues të përkohshëm për Ngrirje të Aseteve”. Më 6 janar dhe 10 janar 2023 AKP ka dërguar në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat I. M. Më 10 janar 2023 Ministria e Drejtësisë e ka suspenduar përmbaruesin privat dhe ka filluar procedurën disiplinore. Më 24 janar 2023 Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special ka mbajtur seancën e shqyrtimit publik lidhur me Urdhërin Ndalues të datës 6 janar. Presim aktvendimin e Gjykatës se a do të vazhdohet urdhri ndalues apo do të lirohen llogaritë bankare. Afati për vendimin e gjykatës është 5 shkurt 2023. Deri në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të fondeve në mirëbesim, ne nuk kemi ende informata lidhur me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

**** Ekzekutimi i pagesës ndaj palës me vendim të Gjykatës** - Shuma prej EUR 1,864,486 është paguar sipas vendimit të Gjykatës të Arbitrazhit Ndërkombëtar në favor të palës lidhur me procesin e arbitrazhit për Sharrcem. Shuma prej EUR 1,864,486 përbëhet sipas vendimeve të dispozitivit EUR 1,355,857 (1,350,087 + EUR 5,770 interesi) si dhe EUR 408,630 (EUR 406,891 + EUR 1,739 interesi). Çështja nr. 2020-02 ka qenë në Arbitrazh Ndërkombëtar të iniciuar nga pala lidhur me padinë ndaj AKP-së për Ndërmarrjen e Re “Sharrcem” Hani i Elezit kundrejt vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së me nr. BD- 110/14. Bordi i AKP-së në mbledhjen e 23 nëntor 2018 kishte vendosur se lidhur me përmbyshjen e zotimeve për investime kapitale bazuar në raportin e auditorit të pavarur, pala duhet të paguaj shtesë EUR 9,441,768 e llogaritur si çmim i blerjes së aksioneve siç parashihet edhe me kontratën e shitjes. Shuma prej EUR 9,441,768 e kërkuar sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve është e shpalosur edhe në shënimin shpjegues nr. 20. Pala kundrejt vendimit të Bordit të Drejtorëve kishte paraqitur padi pranë Arbitrazhit Ndërkombëtar.

KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Gjatë vitit 2022, shuma prej EUR 19,283 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e vendimeve dhe taksave të Gjykatave ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSH-ve përkatëse.

15. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-SË**MJETET E TRANSFERUAR NË MINISTRI TË FINANCAVE**

PËRSHKRIMI	PËR BUXHETIN	SHUMA
Transferet për buxhetet 2011-2018		
Transferet	2019	44,741,706
Transferet	2020	1,036,241
Transferet	2021	0.00
Transferet	2022	0.00
		0.00

Gjithsej**45,777,947****RAPORT I TË HYRAVE TË DEDIKUARA PËR VITIN 2022**

PËRSHKRIMI	SHUMA
Gjendja më 1 janar	
	47,941,916
Alokimi i mjete. nga llog. tarifës për pjesë. në tender	
	96,500
Alokimi i 5% e vlerës të shitjeve të aseteve	
	192,719
Alokimi i 5% i të hyrave nga qiraja	
	2,017,986
Gjithsej të hyrat e AKP-së për vitin	
	2,307,305

Gjendja më 31 dhjetor**50,249,121****1. Mjete të transferuara në Ministri të Financave**

Tabela në anën e majtë nuk paraqet bilancin e të hyrave të dedikuara të realizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, por paraqet shumat e transferuara nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së prej EUR 43,977,947 si dhe fondit rezervë prej EUR 1,800,000. Mjetet janë transferuar në Ministri të Financave për buxhetet vjetore të AKP-së.

Për shkak se nuk ka pasur mjete të mjaftueshme, për buxhetin 2020 dhe 2021 nuk kemi transferuar mjete dhe se tërë buxheti i AKP-së është financuar nga Granti Qeveritar sipas ligjit për buxhetin të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

2. Raport i të hyrave të dedikuara për vitin 2022

Janë të gjitha mjetet e inkasuara në llogari të tarifës administrative nga tarifa për pjesëmarrje në tender, 5% e shitje të kontratave të nënshkruara si dhe 5% e të hyrave të qirave.

Totali i transferuar në llogari të tarifës administrative të AKP për vitin 2022 nga 5% të shitjeve të aseteve është EUR **2,307,305 dhe atë**

- EUR 188,739 (3,774,780.00*5%); nga shitja e aseteve përmes likuidimi dhe aseteve tjera;
- EUR 3,980 (79,600*5%) nga negociimit direkt; dhe
- EUR 2,017,986 nga 5% e të hyrave nga qiraja janë ndarë për periudhën 2003 – 30 qershor 2022 sipas vendimit të Drejtorëve të AKP-së; dhe
- EUR 96,500 alokimi i mjeteve nga tarifa për pjesëmarrje në tender. Lidhur me këtë referojuni shënimin nr. 5.

Gjithashtu në ndërlidhje me këtë çështje, ju lutem referojuni shënimit shpjegues nr. 2.1 dhe 2.3.

Të hyrat gjithsej EUR 50,249,121 minus EUR 43,977,947 si dhe minus EUR 3,521,342 përbëjnë gjendjen e mbetur të llogarisë EUR 2,749,832. Shuma prej EUR 3,521,342 janë shpenzimet tjera.

16. SHPENZIME TJERA

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Pagesat ndaj palëve të jashtme	8,827	19,278	13,228
Kompensimi i tarifës administrative	4,651	20,044	-
Gjithsej	13,478	39,322	13,228
Krahasimet ndërmjet vitit 2022 me vitet 2021 dhe 2020	ndryshimi %	(25,844) (65.72)%	250 1.89%

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHME

PËRSHKRIMI	SHUMA
Shp. nga paraja e imët në avans për shpenzime të vogla	3,041
Shpenzime bankare/tarifa për transaksion	5,786
Gjithsej për vitin 2022	8,827

2. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Gjatë vitit 2022, shuma prej EUR 4,651 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e shpenzimeve tjera ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Ulja e shpenzimeve tjera kundrejt vitit 2021 është kryesisht si rezultat i ndryshimit të politikës të NSH Newco Grand. Nga viti 2022, shpenzimet e vogla i mbulojnë nga arka e të hyrave dhe mbajtje e arkës ndarazi të shpenzimeve. Po ashtu ndikim ka patur edhe niveli i kompensimit të tarifës administrative.

Gjithashtu, ka shpenzime të avanseve për udhëtime zyrtare jashtë vendit dhe shpenzimet e parave të imëta që janë paraqitur në kategorinë mallra dhe shërbime tek shënimet shpjegues nr. 10, për shkak se ato janë paguar nga llogaria e tarifës administrative. Në momentin kur të kompensohet llogaria, atëherë, do të paraqiten si shpenzime në këtë kategori.

Këto shpenzime përfshijnë avanset për udhëtime zyrtare të Zyrtarëve Ligjor dhe Zyrtarëve të Rastit dhe përfaqësues të NSH në likuidim (përfaqësime gjyqësore jashtë territorit të Kosovës) shpenzime e parave të imëta nga llogaritë e NSH-ve si dhe pagesat e tarifave për transaksionet dalëse nga llogarit bankare të fonde në mirëbesim që i aplikon BQK.

17. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve NË LIKUIDIM

RAPORTI I PAGESAVE NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020	GJITHSEJ	
				2011 - 2022	
Paga punëtorëve	3,443,770	2,626,782	4,563,328	23,104,798	
ATK	1,450,865	824,917	444,584	8,459,541	
Trusti	277,722	576,484	322,413	3,738,222	
Tatimi në pronë	718,051	259,417	100,238	2,412,948	
Komunalit	948,825	1,726,069	110,526	3,958,651	
Kreditor të tjerë	8,231,752	1,862,512	1,668,300	16,105,225	
Gjithsej	15,070,985	7,876,181	7,209,389	57,779,385	

SHUMA E RAPORTET E APROVUARA DHE GIENDJA E TYRE E PAGESAVE

VITI	SHUMA	PAGESA	Diferenca
2010	21,853	21,853	-
2011	23,289	23,289	-
2016	17,414,433	17,383,544	30,889
2017	6,821,550	6,780,651	40,899
2018	2,339,526	2,317,618	21,908
2019	3,906,238	3,840,021	66,217
2020	5,766,047	5,648,660	117,387
2021	8,410,295	8,250,786	159,509
2022	15,264,462	13,512,963	1,751,499
Gjithsej	59,967,695	57,779,385	2,188,310

1. RAPORTI I PAGESAVE NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve

Tabela në anën e majtë paraqet bilancin e pagesave për tre vitet e fundit si dhe totalin e realizuar nga viti 2011 deri me 31 dhjetor 2022.

2.SHUMA E RAPORTEVE TË APROVUARA DHE GIENDJA E TYRE E PAGESAVE

Tabela në anën e majtë paraqet shumën e raporteve për shpërndarje të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve nga viti 2010 deri më 31 dhjetor 2022.

Shumat e papaguara për raportet e viteve 2016-2021 janë kryesisht rezultat i mungesës i të dhënave të sakta për llogarit bankare. Për këto raste deri me tani, Autoriteti i Likuidimit dhe Zyrtarët e Rastit nuk kanë arritur në gjetjen e kontakteve të tyre në mënyrë që të ju mundësohen pagesat.

Ndërsa për vitin 2022 kryesisht kanë mbetur pa u proceduar vendimet e dhjetorit 2022 dhe apo ndonjë kërkesë kreditore që kanë mbetur pa u procesuar për pagesë.

Gjatë vitit 2022 janë aprovuar gjithsej 49 raporte të shpërndarjes në vlerën e përgjithshme EUR 15,264,462.

Lidhur me shumat e papaguara të raporteve të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve për NSH-të përkatëse janë prezantuar në janë shpalosur në shënimin nr. 23.2.

Lidhur me diferencën totale të shumës të papaguar prej EUR 2,188,310 - Për secilin pagesë të shumës të aprovuar ndaj kreditorit hiqet shuma e transaksionit bankar prej 0.30 apo 1.30 (mbi EUR 10,000) dhe *gjendja reale e obligimeve në total* është raportuar tek llogaritë e pagueshme meqenëse nga totali i shumës janë ndaluar tarifat bankare dhe raste tjera.

INFORMATË

SHUMA		KOMENTE
525,976		Raportet e shpërndarjes për vitin 2021 të raportuara në PF 2022 prej EUR 8,410,295 në krahasim me ato që janë raportuar në PF 2021 në shumën prej EUR 8,936,271 janë shkak të katër raporte të anuluar të shpërndarjes së përkohshme për kreditorët (GJI103 D.T.P. Mladost - Prizren, PEJ040 Ag Coop "Ujmir" - Pejë, PEJ139 17 Nëntori - Pejë dhe PRN026 Plastika - Prishtinë) të cilat janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e muajit dhjetor 2021. Mirëpo për shkak të disa gabimeve teknike në kalkulim në rastet kur kreditorët kanë dalë në pension apo kanë vdekur si dhe për pagesat ndaj ATK-së dhe Trustit, prej të cilave dy nga këto katër raporte janë dërguar për aprovim nga Bordi i Drejtorëve si raporte të korrigjuara për kreditorët në muajin janar 2022, një raport i korrigjuar për kreditorët është dërguar për aprovim nga Bordi i Drejtorëve në muajin prill 2022 dhe një raport i korrigjuar për kreditorët është dërguar për aprovim nga Bordi i Drejtorëve në muajin shtator 2022.
976		Për arsye të emrit dhe mbiemrit të njëjtë të dy kreditorëve, gjatë realizimit të pagesës në vlerë prej EUR 976.20, një kreditor ka përfituar më shumë për NSH "Trasing". Kreditori është njoftuar që t'i kthej mjetet dhe njëkohësisht janë marrë masat ligjore për rastin në fjalë.
3,194		Në Mars të vitit 2015, BQK-ja ka ekzekutuar urdhrin e përbaruesit privat në shumën 3,194 për NSH në likuidim "Malishgani Klinë". AKP-ja ka marrë të gjitha hapat ligjor dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve. Të gjitha institucionet relevante janë njoftuar për rastin në fjalë.
2,460		Në fund të dhjetorit 2017, të hyrat prej EUR 2,460 për NSH Grand për shfrytëzimin e sallës nga AKP-ja, gjatë ekzekutimit të pagesës janë konfiskuar nga ATK-ja. Kjo si rezultat i marrëveshjes në mes të ATK-së dhe Thesarit, nëpërmjet të cilës, përmes sistemit automatikisht ekzekutohen pagesat në të mirë të ATK-së.
56,580		Gjithashtu, në vitin 2017 jemi njoftuar se, ATK-ja ka konfiskuar mjetet prej EUR 56,680 që është dashur të paguaj institucioni i Kosovës për shfrytëzimin me qira të asetit të NSH Mekanizimi. Mjetet janë konfiskuar në vitin 2016. Mënyra e konfiskimit të mjeteve është ngjashëm si në rastin e sipër shënuar më lartë.
1,564,137		Mjete të bllokua/rezervuara nga BQK: • për NSH në likuidim "IDGJ Tobacco" EUR 620,866; • për NSH në likuidim "Pasuria Bujqësore Ferizaj" EUR 6,341; • për NSH në likuidim "Jugoterm" EUR 192,357; • për NSH në likuidim "Liria Bardhosh" EUR 35,618; • për NSH në likuidim "Agroprodukti Kamenice" EUR 3,395; • për NSH në likuidim "Agrokultura" EUR 85,337; • për NSH në likuidim "Rilindja Grafike" EUR 620,223 • për NSH në likuidim "Newco Llamkos Steel" 5,004,058.18 sipas urdhrit përbarimor shih shënimin nr. 14 ; dhe • për NSH në likuidim "IMN Kosova" 126,028.81

Përveç urdhrit përbarimor, mjetet e rezervuar në BQK janë si rezultat i vendosjes së barrës tatimore mbi asetet e NSH-ve. AKP ka nënshkruar një "Marrëveshje të Mirëkuptimit" me ATK për trajtimin e barrës tatimore, por për rastin në fjalë është vendosur që të trajtohet deri në vendimin e Dhomës të Gjykatës Supreme të Kosovës.

18. FONDET TRANSFERUAR BUXHETIT TË KOSOVËS

VITI	Fondet Tepricë	Fondet e mbetura	Fondet e përkohshme	TOTALI
2012	28,934,282	-	-	28,934,282
2015	61,310,629	-	-	61,310,629
2017	-	325,664	-	325,664
2018	-	42,226,452	43,920,006	86,146,458
2019	-	2,208,220	147,793,750	150,001,970
2020	-	53,738	71,422,445	71,476,183
2021	-	38,555	-	38,555
2022	-	-	-	-
Gjithsej	90,244,911	44,852,629	263,136,201	398,233,741

Fondet e transferuara në buxhetin e Kosovës janë:

1. Fondet Tepricë sipas nenit 19.3.3 të Ligjit bazik nr. 04/L-034;
2. Fondet e mbetura sipas nenit 4, paragrafi 3.2.6 të Ligjit nr. 06/L-023 për plotësim dhe ndryshim; dhe
3. Fondet e përkohshme sipas nenit 4, paragrafi 3.2.7 të Ligjit nr. 06/L-023 për plotësim dhe ndryshim të Ligjit 04/L-034 ka hyrë në fuqi në muajin maj 2018.

Nëpërmjet tabelës në anën e majtë, pasqyrohen llojet e fondeve të transferuara Buxhetit të Kosovës nga viti 2012 deri më 31 dhjetor 2022.

VI. LLOGARITË E ARKËTUESHME

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Ndëshkimet me Spin-Off Speciale	29,318,296	29,318,296	31,033,785
Nga shitja e aseteve dhe tjera	8,692,937	16,985,925	16,754,600
Nga shpronësimi i aseteve të NSH-ve	0.00	0.00	4,927,417
*Të hyra nga qiraja	16,088,543	15,933,447	16,085,323

Gjithsej

54,099,776 62,237,668 68,801,125

*Për vitin 2021 korrigjim të shënimeve në përputhje me detajet e shpalosura shënimin shpjegues nr. 22

TË SHPALOSURA

Ndëshkimet financiare të shpalosura në shënimin shpjegues nr. 19
Llogaritë e arkëtueshme nga shitjet e aseteve në shënimin shpjegues nr. 20
Llogaritë e arkëtueshme nga të hyrat e qirasë në shënimin shpjegues nr. 21

Llogaritë e arkëtueshme janë obligimet e papaguara nga palët e treta ndaj Agjencisë për rastet si më poshtë:

- pjesët e papaguara nga valët e privatizimit/likuidimit dhe shitjeve përmes negocimit direkt;
- ndëshkimet financiare për valët e “spin off-ve special”;
- Shpronësimi i aseteve; dhe
- qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSH-ve.

Të gjitha këto të dhëna janë të paraqitura nga Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje, Zyrat Regjionale përmes Departamentit të Koordinim të Rajonal, Departamenti i Shitjes dhe Njësia për Negocim Direkt.

Ashtu siç është paraqitur edhe në fillim të shënimeve shpjeguese, sa i përket llogarive të arkëtueshme janë paraqitur vetëm si shpalosje në këto pasqyra, pasi që pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme.

19. NDËSHKIMET NDAJ NSH-ve ME SPIN-OFF SPECIAL

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Grand Hotel	8,822,315	8,822,315	8,822,315
Xim Strezovc	7,298,171	7,298,171	7,298,171
MIIM Golesh	8,447,812	8,447,812	8,447,812
Agrokosova Holding	3,579,998	3,579,998	3,579,998
Llambkos	0.00	0.00	1,715,489
Famipa Prizren	1,170,000	1,170,000	1,170,000
Gjithsej	29,318,296	29,318,296	31,033,785

Janë ndëshkimet në vlerë monetare ndaj blerësve për zotimet e dhëna për disa Ndërmarrje të Reja, që përveç çmimit të ofertës, ofertuesit kanë dorëzuar dhe ofertat lidhur me investimet për këto Ndërmarrje.

Shitjet janë realizuar edhe me kushte të tilla si: vazhdimi i operimit të aktivitetit të NSH-ve, me investimet e zotuar dhe numrin e punëtorëve. Këto raste kanë qenë “Shitjet me Kushte të Veçanta” dhe shitjet me “Spin Off Special”. Deri më tani, ndëshkimet financiare të aplikuara për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet për NSH-të e paraqitur sipas tabelës në anën e majtë.

Për vitin 2021 ndryshimet janë vetëm tek rasti i NSH Llambkos. AKP ka bërë kërkesë kreditore për ndëshkimet financiare për Ndërmarrjen e Re “Llambkos” në vlerë prej 1,715,488.79, por që kjo kërkesë është refuzuar nga Administratori Falimentues, Gjykata Themelore si dhe me vendimin përfundimtar nga Gjykata e Apelit e Kosovës.

20. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHITJA E ASETEVE

PËRSHKRIMI	2022	2021	2020
Gjendja më 1 janar	16,985,925	16,754,600	23,853,484
Pagesat e realizuara të LL/A të viteve paraprake	(220,545)	(361,413)	(5,872,284)
Anulim/tërheqja nga shitjet të tenderuar LL/A	0.00	(111,001)	(2,064,677)
Llogari të arkëtueshme të reja gjatë vitit	1,369,325	360,782	838,077
Arbitrazhi i fituar për MIM Golesh	-	342,957	-
Vendimi i Arbitrazhit – shënimi shpjegues 14	(9,441,768)	-	-
Gjithsej ndryshimet në vit	(8,292,988)	231,325	(7,098,884)
Gjendja më 31 dhjetor	8,692,937	16,985,925	16,754,600

Ndryshimet kundrejt vitit 2021

1.1 Vendimi i Arbitrazhit - Për Ndërmarrjen e Re “Sharrcem” Hani i Elezit, Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar ka vendosur në favor të palës sipas vendimit në çështjen nr.2020-02. Pala kishte dorëzuar ankesë kundrejt vendimit të Bordit të Drejtoreve të AKP-se në mbledhjen e 23 nëntor 2018 ka vendosur (BD- 110/14) qe vlera e mos përmbushjes së zotimeve për investime kapitale prej 9,441,768, bazuar në raportin e auditorit të pavarur, të llogaritet si çmim i blerjes së aksioneve siç parashihet edhe me kontratën e shitjes. Shih edhe shënimin nr. 14.

1.2 Llogari të arkëtueshme të reja gjatë vitit Po ashtu, nga muaji qershor 2022 është filluar me procesin e valëve të shitjes dhe llogaritë e reja gjatë vitit kanë të bëjnë me valën e fundit të shitjes dhe që është ende në procedurë të procesit për nënshkrimin/realizimin e kontratave.

Lista detaje e të gjitha llogarive të arkëtueshme është prezantuar në faqen tjetër.

Llogaritë e arkëtueshme përmes valëve të privatizimit dhe shitjes përmes negociimit direkt janë llogari që **potencialisht mund të inkasohen**, meqenëse për këto raste nuk është përfunduar ende procesi i nënshkrimit të kontratave. Ashtu siç është thënë edhe me lartë, llogaritë e arkëtueshme në këtë rast paraqiten vetëm si shpalosje e informacioneve në pasqyrat financiare dhe mundësitë e inkasimit të tyre në të ardhmen.

Përveç rasteve të pezulluara - aprovimin nga Bordi, rastet që nuk realizojnë pagesat ju konfiskohet BiD depoziti. Pjesa e konfiskimit të BiD depozitave është trajtuar në shënimin shpjegues nr. 5.

PËRMBLEDHJE – PËRSHKRIMI I LLOGARIVE TË ARKËTUESHME TË BARTURA NGA VITI 2021 DHE ATO NË VITIN 2022:

Periodha	Shuma	Përshkrimi	Statusi
BARTURA NGA VITET PARAPRAKË	321,111	Privatizim Vala 37 për Agrokosova Offices	Masë të përkohshme
	223,223	Privatizim Vala 43 për Punëtoria Iliria	Masë të përkohshme
	72,800	Likuidim 20 për asetin e NSH Lavërtari Blegtori	Masë të përkohshme
	70,777	Likuidimi 29 për NSH Rekreators, njësia 34	Masë të përkohshme
	1,800,000	Likuidimi 35 për NSH Gërmia, njësia 43	Masë të përkohshme
	112,456	Likuidimi 35 për NSH Zetatrans, njësia 47	Masë të përkohshme
	478,325	Likuidimi 35 për NSH Lavërtari Blegtori, njësia 55	Masë të përkohshme
	19,890	Likuidimi 37 për NSH Agromorava, njësia 7	Masë të përkohshme
	161,200	Likuidimi 42 për Njësia nr. 16 - Lux Lokali "Nashe Dete"	Pezullim
	531,550	Likuidimi 45 Njësia nr. 75 - NSH Lavërtaria-Blegtoria - Tokë bujqësore në Trepetincë 4	Masë të përkohshme
	425,425	Likuidimi 47 Njësia nr. 114 - NSH Lavërtaria-Blegtoria - Tokë bujqësore në Petrovë 1	Masë të përkohshme
	388,888	Likuidimi 49 Njësia nr. 101 - Visoko Commerce Shitorja nr. 2	Masë të përkohshme
	163,000	Likuidimi 51 Njësia nr. 05 - IMK Toka në Shtime (Lot A)	Pezullim
	1,555,778	Likuidimi 51 Njësia nr. 71 - Auto Moto Lipjan	Pezullim
	342,957	Vendimi i arbitrazhit ndërkombëtar për NSH MIM Golesh në favor të AKP-së	Në proces
	120,190	Ka pasur vendim Bordi për aprovimin e shitjes por në proces ka ardhur Masë e përkohshme nga DHPGJS.	Masë të përkohshme
	536,045	Shitjet e aseteve me negociim direkt të bartura nga vitet e kaluara	
2022	1,032,101	Ofertat e pranuar nga procesi i valës 59 dhe 60 të shitjes	
	231,110	Likuidimi 57 Njësia nr.21: Investbanka Lokali në Mitrovicë	Masë të përkohshme
	106,111	Likuidimi 58 Njësia nr.32-NSH Zhupa Reqane-Prona në Lubinje e Epërme 1	pezullim
8,692,937		GIITHSEJ	

21. LLOGARITË E ARKËTUESHME PËR QIRATË

VITI	1	2	3	4=2-3	5=1+4	krahاسيمي %
	31 dhjetor 2021	Rritjet në vitin aktual	Zvogëlimet vitet paraprake	Ndryshimi për vitin	TOTALI	
					31 dhjetor 2022	
ZR Prishtina	12,639,243	176,202	(150,157)	26,045	12,665,288	
ZR Pejë	690,583	96,958	(13,939)	83,019	773,602	6.58% ↓
ZR Mitrovicë	1,106,524	67,303	(11,647)	55,656	1,162,180	24.08% ↑
ZR Gjilan	1,438,029	1,320	(10,697)	(9,377)	1,428,652	4.58% ↑
ZR Prizren	59,068	1,718	(1,965)	(247)	58,821	0.67% ↓
					58,821	1.46% ↓
Gjithsej	15,933,447	343,501	(188,405)	155,096	16,088,543	3.83% ↓

Llogaritë e arkëtueshme pothuajse janë të njëjta me ulje prej 0.97% e krahasuar me vitin 2021. Me këtë vërehet se llogaritë e arkëtueshme këto vitet e fundit nuk kanë tendencë rritje. Po ashtu tregues i kësaj është edhe procesi/vlera e padive që është afërsisht i njëjtë si në vitin 2021. Vlen të theksohet se në vlerën totale të padive kryesisht përbëhet me 85.35% nga 5 qiramarrësit e mëdhenj me ndaj të cilëve është iniciuar procedura gjyqësore apo me 70.46% të llogarive të arkëtueshme.

Rastet e 5 qiramarrësve të mëdhenj që përbëjnë vlerën totale të llogarive të arkëtueshme janë paraqitur në tabelën në anën e djathtë.

Po ashtu, në faqen tjetër janë përshkruar disa NSH nëpër regjione që kryesisht kanë ndikuar në uljet dhe rritjet e llogarive të arkëtueshme përgjatë vitit 2022.

Pesë qiramarrësitë e mëdhenjë me obligime ndaj NSH-ve

- **8,708,328** - faturimi ndaj Kosova Petrol për asetet e NSH Jugopetrol dhe Ina Trgovina. Faturimi është për periudhën shkurt 2000 - 30 prill 2016 (fatura e parë e lëshuar në vitin 2014) Rasti është në procedurë gjyqësore;
- **702,861** - faturimi "AL Petrol" për shfrytëzimin e pompave të benzinës të INA Trgovina. Ndaj "AL – Petrol" çështja është në procedurë gjyqësore, në shkallën e parë ka fituar AKP;
- **813,376** - faturimi ndaj "Industria e Naftës INA D.D. Zagreb" për shfrytëzimin e pompave të benzinës të NSH INA Trgovina;
- **669,029** - faturimi ndaj NPTSH Sharr Betelingsungs për të cilët është ngritur padi por që ende nuk ka përfunduar procesi gjyqësor;
- **442,000** - faturimi ndaj Komuna e Mitrovicës, Organizata BAC, Biblioteka nder komunale, Oda Ekonomike e Kosovës, OJQ 7 Arte. Faturimi është sipas llogaritjes nga 1 mars 2011 deri më 31 dhjetor 2021. Rasti është në procedurë gjyqësore.

Listim i shkurtër i NSH-ve që kanë pasur impakt të lartë të ndryshimeve në nivel të regjioneve

Llogaritë e arkëtueshme						
2022	2021	ndryshimi	% e ndryshimit	Ndërmarrja shoqërore	ZR	Komente
159,440	201,425	(41,985)	(20.84)%	Auto Prishtina	Prishtina	Inkasim të Borxheve të viteve paraaprake.
22,995	34,082	(11,087)	(32.53)%	Perparimi	Prishtina	Inkasim të Borxheve të viteve paraaprake.
169,964	216,170	(46,206)	(21.37)%	Jugopetrol	Prishtina	Inkasim të Borxheve të viteve paraaprake.
285,796	200,520	85,276	42.53%	NewCo Grand Hotel Shpk	Prishtina	Si rezultat i qiradhëniesve të reja me çmime dhe qiramarrës të ri gjatë vitit 2022 ka rezultuar në rritjen e II/a si rezultat i prerjes të periudhës fiskale 2022
28,246	19,029	9,217	48.44%	Barnatoret e Prishtinës	Prishtina	Si rezultat i qiradhënies të reja me çmime dhe qiramarrës të ri gjatë vitit 2022 ka rezultuar në rritjen e II/a si rezultat i prerjes të periudhës fiskale 2022. Ka pagesa në vitin 2023 të këtij II/a të
35,789	24,746	11,043	44.63%	Izolimi	Prishtina	Si rezultat i qiradhënies të reja me çmime dhe qiramarrës të ri gjatë vitit 2022 ka rezultuar në rritjen e II/a si rezultat i prerjes të periudhës fiskale 2022. Shuma prej EUR 11,043 është paguar në janar 2023.
122,917	129,173	(6,256)	(4.84)%	N.T. 17 Nentori	Gjilan	Dy raste janë të përmbaaruara, të paguara tërësisht. Ndërsa, pjesa tjetër e pagesave është bërë pjesërisht nga debitorët e tjerë.
5,210	13,358	(8,148)	(61.00)%	K.B. Drenica	Mitrovica	Në këtë ndërmarrje ka kontrata vjetore për toka bujqësore dhe arkëtimi i të hyrave fillon nga sezoni vjeshtor (01 Tetor e tutje). Pasi që aneks kontratat kanë skaduar, për shkak të distancës së ZR Mitrovicë dhe Drenas, aneks kontratat po nënshkruhen e pastaj po shpërndahen pas pagesave të qirasë, që shpesh bëhen në fillim të vitit vijues. Disa borxhe ende kanë ngelur në përmbarim.
354,878	340,060	14,818	4.36%	Lux	Mitrovica	Korrigjim dhe harmonizim i listës së borxheve kryesisht për dy raste për borxhe paraaprake
77,362	67,759	9,603	14.17%	Cycavica	Mitrovica	Janë shtuar LL/A pasi gjykata ka refuzuar apelin e vendimit të DHPGJS për një borxh ndaj NSH-së. Rasti në përmbarim.
644,748	606,749	37,999	6.26%	Jugobanka	Mitrovica	Rritja e borxhit për vitin 2022 për asetin e pa liruar nga Komuna e Mitrovicës për të cilin është në proces gjyqësor me AKP lidhur me tjetërsimin e pronës
72	3,606	(3,534)	(98.00)%	Ereniku - Industria	Peja	Inkasim përmes përmbauesve lidhur me qiramarrësit që janë në vonesë

31,638	36,004	(4,366)	(12.13)%	Ereniku - Prodhimtaria Primare	Peja	Inkasim i qirave dhe rasteve të dërguara në përmbarim
182,861	124,695	58,166	46.65%	Bauxite Mine Volljak	Peja	Qiramarrës të parregullt si dhe një rast i dërguar në vitin 2016 në Gjykatë Themelore Prizren-dega Malishevë për të cilin AL ka marr vendim dhe e ka transferuar tek përmbaruesi privat. Për këtë rast nuk kemi pasur informata dhe jemi njoftuar nga Gjykata lidhur me këtë lëndë.
21,331	5,696	15,635	274.49%	NT Agimi	Peja	Aktgjykim i Gjykatës për qira të papaguara, të cilin e kemi dërguar për ekzekutim në përmbarim.
R 16,048	540	15,508	2871.85%	17 Nentori	Peja	Aktgjykim i Gjykatës për qira të papaguara, të cilin e kemi dërguar për ekzekutim në përmbarim

VII. LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

22. LLOGARITË E PAGUESHME

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale	-	-	-
Obligimet ndaj kërkesave kreditore	2,188,310	2,511,192	1,454,607
Mallra dhe Shërbime	131,611	184,702	110,817
Gjithsej	2,319,921	2,695,894	1,565,424

Obligimet e papaguara janë të paraqitura në tri shtylla:

- Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit);
- Mallrat dhe Shërbimet; dhe
- Obligimet ndaj Kërkesave të Kreditorëve.

23.1. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE PËR PROCESIN E LIKUIDIMIT

Obligime ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale nuk ka sepse janë ekzekutuar të gjitha kërkesat/faturat e dorëzuara nga Menaxheri i Kontratës për shërbimet e pranuar dhe të aprovuara nga Komiteti Drejtues i Likuidimit. Pagesat përfshijnë periudhën deri më shërbimet e muajit nëntor 2022. Ndërsa sa i përket shërbimeve të muajit dhjetor 2022, sipas procedurës ato njihen apo bëhen të pranueshme pasi që aprovohet raporti nga Komiteti i Likuidimit. Neni 16.1 i Kushteve të Veçanta të Kontratës parasheh që faturat duhet të lëshohen nga OSHP me rastin e dorëzimit të raportit mujor për muajin paraparak. Pagesat mujore bëhen me rekomandim të Menaxherit të Kontratës për aprovim të raportit mujor nga Komiteti Drejtues i Likuidimit brenda 30 ditëve kalendarike duke filluar nga dita kur lëshohet fatura dhe protokollohet në AKP. OSHP ka dorëzuar faturën dhe raportin mujor për dhjetor 2022 më datën 10 janar 2023.

Me përfundimin e kontratës me “Deloitte”, është angazhuar kontraktori tjetër “Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton L.L.C”. Periudha e angazhimit është pesëvjeçare, nga 1 korrik 2019 deri me 30 qershor 2024.

Sa i përket kontraktimit të parë “Deloitte” të gjitha janë përfunduar në vitin 2018. Lidhur me OSHP, referojuni edhe shënimit shpjegues nr. 10.

Tre fatura për periudhën gusht 2019, korrik 2021 dhe gusht 2021 janë refuzuar për pagesë meqenëse nuk kanë përmbushur shërbimet sipas kushteve të kontraktuara. Më në detaje, për këto janë paraqitur si *shënim* tek pjesa e detyrimeve kontigjente, përkatësisht shënimin nr. 24.

23.2. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE

Përshkrimi	Shuma
Obligimet më 1 janar	2,511,192
Rregullime të bilancit fillestar	9,617
Anulim i raporteve të shpërndarjes	(525,976)
Shuma e paguar gjatë vitit 2022 për vitet paraprake	(1,558,022)
Shuma e aprovuara të shpërndarjes 2022	15,264,462
Pagesat nga shumat e aprovuara të shpërndarjes 2022	(13,512,963)
Obligimi më 31 dhjetor	2,188,310

Ashtu siç është përmendur edhe në shënimin shpjegues nr. 17, obligimet e papaguar janë pagesat e përealizuara ndaj kreditorëve të NSH-ve sipas vendimit për shpërndarje të Bordit të Drejtorëve. Kryesisht shumat e papaguara të raporteve të viteve paraprake janë për rastet të cilat ka pasur mungesë të informacioneve të llogarive bankare.

Obligimi i paraqitur në shënimin shpjegues nr. 17 prej EUR 2,188,310 paraqet gjendjen e pagesave nga e cila janë zbritur tarifat bankare në secilin transaksion bankar aty ku aplikohen tarifa bankare nga BQK. Tarifa bankare në planin kontabël kategorizohen në shënimin nr. 16 dhe të cilat gjatë tërë procesit të shpërndarjes janë EUR 7,837. Shto këtu 3,311 që kërkojnë korrigjim (një pagesë e dyfishtë prej EUR -976.50 dhe EUR 4,287.78 që duhet korrigjuar nga raporti i shpërndarjes)

Pagesat për raportet e vitit 2022

Raportet e shpërndarjes janë aprovuar duke filluar nga janari 2022. Janë gjithsej 49 raporte të shpërndarjes të aprovuara dhe më poshtë janë listuar NH që kanë vlera të mëdha:

- NSH PMN Sharr, vlera totale e aprovuar EUR 8,250,608 dhe është realizuar shpërndarja në 93%;
- NSH 19 Qershori, vlera totale e aprovuar EUR 476,478.77 dhe është realizuar shpërndarja në 98%;
- NSH Plastika, vlera totale e aprovuar EUR 215,415.50 dhe është realizuar shpërndarja në 97%;
- NSH Autoshtëpia Mustafë Rexhepi, vlera totale e aprovuar EUR 329,815.36 dhe është realizuar shpërndarja në 95%;
- NSH Fapol, vlera totale e aprovuar EUR 229,778.52 dhe është realizuar shpërndarja në 100%;
- NSH NHT Pashtriku, vlera totale e aprovuar EUR 440,523.12 dhe është realizuar shpërndarja në 100%;
- NSH Tefik Çanga, vlera totale e aprovuar EUR 964,443.25 dhe është realizuar shpërndarja në 81.50%;
- NSH Morava e Binçes, vlera totale e aprovuar EUR 552,061.51 dhe është realizuar shpërndarja në 98%;
- NSH Radusha, vlera totale e aprovuar EUR 393,334.08 dhe është realizuar shpërndarja në 99%;
- NSH Eurometal, vlera totale e aprovuar EUR 268,445.6 dhe është realizuar shpërndarja në 93%;
- NSH Industrial Batteries Factory "Trepça", vlera totale e aprovuar EUR 244,167.57 dhe është realizuar shpërndarja në 98%;
- NSH Dukagjini Industry for construction material, vlera totale e aprovuar EUR 287,139.58 dhe është realizuar shpërndarja në 97%;
- NSH KB Kosova, vlera totale e aprovuar EUR 387,623.17 dhe është realizuar shpërndarja në 100%;
- NSH Duhani, vlera totale e aprovuar EUR 257,029.58 e aprovuar në dhjetor 2022
- NSH Deva, vlera totale e aprovuar EUR 406,735.75 e aprovuar në dhjetor 2022

RRJEDHA E NDRYSHIMEVE NGA VITI PARAPRAK

Përshkrimi	Shuma	Renditja
Obligimet më 1 janar 2022	184,702	1
Korrigjim i bilancit fillestar	(452)	2
Pagesat e realizuara gjatë vitit 2022	(169,734)	3
Obligimet e bartura nga vitet paraprake	14,517	4=1-2-3
Obligimet gjatë vitit aktual	117,095	5
Gjithsej	131,611	6=4+5

PËRSHKRIMI I DETYRIMEVE

Përshkrimi	Shuma
Shërbime Juridike	2,836
Tatimi në pronë	11,680
Kontributet pensional të OSh & punët e NSH – dhjetor 2022	19,113
Paga dhe Ofrues shërbimesh për muajin dhjetor 2022	5,310
Shërbime komunale (rrymë, ujë dhe mbeturina) për NSH-të	8,234
Shërbime për furnizim me filma për ABC Genci	1,848
Shërbime te telekomunikimit	204
Shpenzime për ngrohje qendrore të NSH Grandi	10,487
Taksa gjyqësore dhe tjera	381
Tatimet ne burim (paga) ne te ardhura personale	7,222
Tatimi mbi vlerën e shtuar	56,217
Tatimi në fitim	8,079
Gjithsej	131,611

Kryesisht paraqiten shpenzimet për ofruesit e shërbimeve të cilët angazhohen për NSH-të përkatëse, shërbimet për ruajtjen e aseteve, shpalljet në gazeta për shitjen e aseteve përmes likuidimit, shpalljet lidhur me njoftimet për kërkesat e kreditorëve, qiraja, shërbimet publike dhe të tjera.

Obligimet e bartura nga vitet paraprake

- Janë dy fatura në shumën totale prej EUR 2,836 për shërbimet e avokaturës në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës lidhur me përfaqësimin në procesin gjyqësor për pronën e NSH “Industria e Mishit”. Pagesat janë ndalur dhe nuk janë ekzekutuar sepse gjatë vitit 2018 për arsye se shërbimet e kontraktuara me avokatin në fjalë kishin përfunduar;

- Tatimi në pronë prej EUR 11,680 për Komunën e Prishtinës për pronat e NSH ABC Genci. ABC Genci në vazhdimësi ka pasur vështirësi me mjete bankare dhe rrjedhimisht këto obligime kanë mbetur pa u paguar.

23. DETYRIMET KONTIGJENTE

RAPORTI PËRMBLEDHËS I DETYRIMEVE KONTIGJENTE

PËRSHKRIMI	VITI 2022	VITI 2021	VITI 2020
Gjendja fillestare me 1 janar	7,481,680	8,541,556	8,662,408
Konteste apo raste të reja	14,228	0.00	45,436
Kosto shtesë për kontes. paraprake		0.00	-
Të bartura nga llog. e pagueshme		0.00	-
Raste të fituara nga AKP	(33,000)	(2,494)	(26,247)
Raste të humbura		0.00	(113,794)
Raste të Korrigjuara		(975,526)	(26,247)
Raste të bartura		(36,420)	-
Shpalosje		(45,436)	
Gjendja më 31 dhjetor	7,462,908	7,481,680	8,541,556

Mundësia	Ullët	7,194,623	7,227,623	8,248,585
	Mesëm	-	-	-
	Lartë	268,285	254,057	292,971

NDRYSHIMET KUNDREJT VITIT 2021

Detajet e shpalosura për ndryshimet për vitin 2021 dhe vitin 2020 janë në Pasqyrat Financiare për vitin 2021 dhe vitin 2022.

Ndërsa, në këtë pjesë do të paraqiten ndryshimet gjatë vitit 2022 në krahasim me vitin 2021.

1. Konteste apo raste të reja

Ndërsa, rasti C-II-15-0635, i cili ka të beje me kompensimin e pagave të papaguara nga NSH, me aktgjykimin e shkallës së parë gjykata ka vendosur në favor të paditësit me të cilën e paditura obligohet për shumën prej 13.124. 64 Euro, me kamate 10%, shuma e përfaqësimit 1.104,00 Euro. Por, vendimi nuk konsiderohet i formës së prere për shkak të ankesës, deri në vendosjen e shkallës së dytë në këtë çështje gjyqësore.

2. Raste të fituara nga AKP

Rasti C-III-13-0325, është rast i fituar nga AKP-ja, pasi që padia e paditësit është hedhur poshtë nga gjykata e shkallës së dytë dhe është hequr nga tabela e detyrimeve kontingjente.

LISTA DETAJE E TË GJITHA RASTEVE TË DETYRIMEVE KONTIGJENTE

NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	PERIUDHA	MUNDËSIA	Vlera
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbarues P. nr. 397/2015, kompensim në shumë prej 2.640 Euro	bartur 2017	e lartë	2,640
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-09-0135, shpenzime procedurale, në shumë prej 1,500 Euro	bartur 2017	e lartë	1,500
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-08-0095 - Padia për humbjen e fitimit, kompensimit në shumë prej 14,478.50 si dhe avokatin në shumën prej 365,04 Euro.	bartur 2017	e lartë	14,844
Kompensim	Aktgjykimi SCC-06-0348, NSH Ratko Mitrović	bartur 2017	e lartë	122,994
Kompensim	Aktgjykimi Cnr. b190/2007 NSH Auto Prishtina	bartur 2017	e lartë	35,725
Kompensim	Aktgjykimi Cnr. 185/2009. për NSH Ujmiri në likuidim	bartur 2017	e lartë	70,000
Kompensim	aktgjykim AC-II-12-0006 për NSH Agrokultura	bartur 2017	e lartë	2,296
Kompensim	Sipas aktgjykimit AC-I-17-0257, agjencia është e obliguar t'i paguaj shpenzimet procedurale	bartur 2017	e lartë	203
Kompensim	Sipas aktgjykimit C-II-17-0069, AKP-ja është e obliguar t'i paguaj shpenzimet e përfaqësuesit të ankesit.	bartur 2017	e lartë	655
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-III-15-1026, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit për shfrytëzimin e lokalit afarist.	2018	E ultë	174,891
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-I-17-0033, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit për pronën.	2018	E ultë	2,985,945
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-II-13-0325, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit për pronën.	2018	E ultë	84,000
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-III-17-0211, pretendon që AKP-ja, në emër të borxhit për mos pagesën e shërbimeve.	2018	E ultë	41,828
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-I-16-0005, pretendon që AKP-ja, në emër të dëmit material dhe jo-materiale.	2018	E ultë	280,000
Kompensim	RAST I FITUAR NGA AKP Paditësi përmes padisë së tij C-I-16-0016, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit të pagave të papaguara. 2018 ultë 33,000			
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-II-16-0662, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit të paguaj të papaguara.	2018	E ultë	2,100
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij SCC-11-0158, pretendon që AKP-ja, në emër të	2018	E ultë	975,526

NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	PERIUDHA	MUNDËSIA	Vlera
	kompensimit të pronës.			
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-III-16-0125, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo-material.	2018	E ultë	150,000
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-IV-12-0020, pretendon që AKP-ja të bëjë, kthimin e depozitës.	2018	E ultë	7,100
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-I-12-0055, pretendon që AKP-ja, në emër të mospërbushjes së kontratës.	2018	E ultë	138,126
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-III-17-0623, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit të pagave të papaguara.	2018	E ultë	6,300
Kompensim	Aktgjykimi SCC-05-0010, AKP-ja detyrohet për pagesën e 1,200 EUR.	2018	E lartë	1,200
Kompensim	Aktgjykimi C-IV-14-3940, AKP-ja, detyrohet që paditësit t'ia kthej depozitën.	2018	E lartë	2,000
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-III-17-0013, pretendon që AKP-ja, në emër të mos përbushjes së kontratës.	2018	E ultë	2,331,089
Fatura	Fatura të gazetës të papaguara që më parë janë ndaluar për shkak të tejkalimit të vlerës të kontratës, por që blerësi i ri i kompanisë nuk ka shprehur interesin që të pranojë këto pagesa. Këto obligime në pasqyrat financiare 2017 kanë qenë të prezantuara si obligime por që kalojnë në detyrime kontingjente.	2018	E ultë	323
Fatura	Faturë e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 2011-2012. Këto obligime në pasqyrat financiare 2017 kanë qenë të prezantuara si obligime por që kalojnë në detyrime kontingjente.	2018	E ultë	17,160
Kompensim	Aktgjykimi C-II-15-0635, paditësi pretendon kompensimin e pagave.Me aktgj, e shkalles pare aprovohet padia e paditësit ne vlere prej 13.124.64 Euro, me kamate 10%, dhe shumen prej 1.104.00 Euro.	2022	e lartë	14,228
Kompensim	Aktgjykim C-IV-15-5448, për shpenzime të procedurës.	2019	E ultë	235
Fatura	OSHP kërkon ende që të paguhet një faturë të cilën e kanë dorëzuar për pagesë për muajin gusht 2019. Për këtë periudhë AKP nuk ka paguar sipas arsyeve që i ka shpalosur në raportet shqyrtuese të raporteve OSHP-së. Fatura 19-300-000128 e datës 6 shtator 2019 për periudhën 1-31 gusht 2019 prej EUR 45,436.			
Fatura	OSHP kërkon që të paguhet një faturë të cilën e kanë dorëzuar për pagesë për muajin korrik 2021. AKP nuk ka paguar sipas arsyeve që i ka shpalosur në raportet shqyrtuese të raporteve OSHP-së. Fatura 21-300-000137 e datës 6 gusht 2021 është EUR 30,000.			
Fatura	OSHP kërkon që të paguhet një faturë të cilën e kanë dorëzuar për pagesë për muajin gusht 2021. AKP nuk ka paguar sipas arsyeve që i ka shpalosur në raportet shqyrtuese të raporteve OSHP-së. 21-300-000148 e datës 7 shtator 2021 është EUR 30,000.			

VIII. PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE

Sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të vitit 2012, në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit dhe NSH've tjera, atëherë pagesat realizohen përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim. Gjithashtu, pagesat nga llogaria e tarifës administrative dhe kompensimi i kësaj llogarie nga NSH'të në likuidim është në pajtueshmëri dhe me nenin 20 të ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-115 dhe ligjin nr. 05/L-080.

SHUMA		
393,099		
Gjithsej mjetet e paguara ndaj OSHP'së sipas kontratës me OSHP [shënimin shpjegues nr. 10]	-	(429,900)
Blerja e materialit dhe paisjeve për mirëmbajtje të hapësirave të arkivave [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(5,089)
Shpenzime për dërgesa postare [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(9,856)
Huazim i mjeteve për NSH Inex Sharr [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(48,610)
Pagat dhe pagesat e OSH-ve [shënimin shpjegues nr. 11.1]	-	(506,549)
Pagesat e shërbimeve administrative për NSH Ndër. E Re Agrokosova [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(12,137)
Për NSH Furnizim me material/zyre, pastrim të hapësirave, abonim, rregullime, etj [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(2,012)
Provizione për ruajtjen e artikujve në Bankën Qendrore të Kosovës [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(1,200)
Shërbime komunale - rryma dhe uji të paguara nga tarifa administrative [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(10,436)
Shërbime për furnizim me filma dhe shërbime të festivalit Prifest për ABC Genci [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(1,523)
Shpallje dhe Publikimet në gazeta vendore dhe ndërkombëtare për NSH-të [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(16,219)
Shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit dhe nga paraja e imët për Zyrat Regionale [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(52,645)
TVSH, Tatimet, Trustet Pensionale për OSH-të nga tarifa për NSH-të përkatëse [shënimin shpjegues nr. 11]	-	(63,233)
Provizione bankare [shënimin shpjegues nr. 16]	-	(1,094)
Kompensimi i tarifës administrative nga llogaritë e NSH-ve për të cilat janë bërë pagesa më përpara	+	1,210,031
Të hyrat për 5% dhe tjera për Agjencinë Kosovare të Privatizimit – [shënimin shpjegues nr. 15.1]	+	2,307,205
Gjendja bankare e llogarisë së tarifës administrative më 31 Dhjetor 2022		
2,749,832		

IX. TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE

TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Janë transaksione bankare ndërmjet llogarive bankare të fondeve në mirëbesim në BQK. Shkurtimeisht janë paraqitur si më poshtë:

1. Barten e BID depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likudimit për në llogaritë përkatëse të NSH-ve në likuidim. *Këto raste trajtohen dhe janë të paraqitur në shënimin nr. 6. Gjithsej bilanci i transaksioneve për vitin 2022 është EUR 371,706.*
2. Të hyrat e realizuara transferuara për tarifën administrative prej EUR 2,307,205 nga 5% i tarifës administrative, konfiskimi i BID depozitave si dhe tarifa për pjesëmarrje në tenderë. *Këto raste trajtohen dhe janë të paraqitur në shënimin nr. 15;*
3. Transferimin e mjeteve nga llogaritë tjera (privatizim dhe tranzicion) për në llogairitë e NSH-ve në likuidim. Gjithsej shuma e transferuar është EUR 4.60.
4. Transferimin e shumave të pa shpërndara si pjesë e 20% për në llogarinë në mirëbesim për punëtorët e NSH-ve. **Gjatë periudhës raportuese**, gjithsej shuma e transferuar për punëtorët në llogari që mbahet në mirëbesim nga AKP është EUR 1,060,654. Këto mjete do të shpërndahen apo

janë shpërndarë pas shqyrtimit të ankesave nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE

Është vetëm një llogari bankare në të cilën ka mjete bankare që AKP-ja mbanë në Procredit Bank dhe NLB Bankë:

1. Garancioni bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 64,466.50 për licencën sipas rregullores të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës;
2. Garancioni bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 12,450.00 për licencën sipas rregullores të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.

X. GJENDJA E FONDEVE TË LIKUIDIMIT TË NSH-ve

Gjendja e të hyrave dhe pagesave në llogaritë bankare të NSH-ve në likuidim nga viti 2003 deri më 31 dhjetor 2022 si më poshtë:

Gjithsej të hyrat prej EUR	711,646,319
Gjithsej Shpenzimet/shpërndarja prej EUR	559,674,058
Gjendja e llogarive bankare në likuidim	151,972,259

RAPORTI I TË HYRAVE NË LLOGARITË BANKARE TË NSH-ve NË LIKUIDIM

NR.	LLOJI I TË ARDHURAVE	PËRSHKRIMI I TË HYRAVE	VLERA
1	Shitje e aseteve	i1 - Shitje gjatë likuidimit	165,417,886
2	Shitje e aseteve	i3 - Depozita të transferuara nga llogaria e depozitës së tenderëve	15,267,169
3	Shitje e aseteve	i1b - Pagesa nga shpronësimi i asetit	9,248,284
4	Shitje e aseteve	i1a - Shitjet e banesave	322,699
5	Shitje e aseteve	i1c - Pagesa nga shitja me negociim direkt	10,689,802
6	Qiraja	i12 - Të ardhura nga qiraja	35,905,928
7	Interesi	i2 - Interesi i fituar	8,388,625
8	Të ardhura tjera	i4 - TVSH hyrëse	532,714
9	Të ardhura tjera	i8 - Transferimi i depozitave të parave të gatshme	23,029
10	Të ardhura tjera	i13 - Të ardhura tjera	1,024,740
11	Të ardhura tjera	i9 - Transferim nga llogaritë bankare të NSh-ve	867,337
12	Të ardhura tjera	i10 - Pranimet nga debitorët e NSh-ve	204,263
13	Nga shitja të Nder. Reja	i6 - Transferimi i 75% nga shitjet me privatizim	445,962,229
14	Llogari tranzicion BQK	i7 - Transferimi i parave të NSh-ve në mirëbesim	17,791,614
GJITHSEJ TË HYRAT NË LLOGARITË BANKARE TË NSH-vë NË LIKUIDIM			711,646,319

RAPORTI I TË PAGESAVE/SHPËRNDARJESË NGA LLOGARTË BANKARE TË NSH-ve në LIKUIDIM

NR	SIPAS LIGJIT NR. 04/L-034	PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE (plani kontabël detajet e shpenzimeve të kategorizuar sipas renditjes të mëposhtme janë në faqen tjetër)	VLERA
1	Rreg. për punëtorët	Mjetet që u takojnë punëtorëve (20%) nga shitjet me likuidim	44,051,354
2	neni 21 i AKP-së i Ligjit nr. 04/L-034	Tarifa administrative e Agjencisë (5% e shitjeve të likuidimit dhe interesit në llogaritë bankare)	11,944,630
3	40.1.1	Kostot e Shitjes ose Përndryshe Realizimi i pronës ose asetëve si dhe shpenzimet e likuidimit	1,333,908
4	40.1.3.1	Shpenzimet Gjyqësore	2,423,799
4	Ekzekutim nga përbaruesi privat në kundërshtim me nenin 10 të shtojcës të Ligjit		4,132,322
5	40.1.3.2	Shpenzimet e Administratorit, Autoritetit të Likuidimit dhe Këshilltarëve tjerë	16,898,688
6	40.1.3.3	Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe asetëve	3,953,418
7	40.1.3.4	Shpenzimet për vazhdimin e operacioneve të Ndërmarrjes	12,298,565
8	40.1.3.4	Shpenzimet të likuidimit: Paguesa e tatimeve (Tatimi i të Ardhurave Personale, Tatimi i Pronës, TVSH etj.)	6,624,247
9	40.1.4	Kreditorët e siguruar për ato raste që janë realizuar nga sigurimi i atyre asetëve	389,682
10	40.1.5	Kreditorët e asetëve specifike duke përfshirë pronën e paluajtshme	89,122
11	40.1.6.1	Kreditorët e pagave për 3 muaj pagat bruto dhe pensioni	3,711,508
12	40.1.6.2	Kreditorët: pagesat për pushim nga puna të papaguara në fillim të Likuidimit	5,303,962
13	40.1.7	Kreditorët e pasiguruar	47,760,493
14	40.1.8	Kreditorët - Pronarët, aksionarët, themeluesit, pjesëmarrësit ose partnerët në NSH	524,618
15	Shih shënimin nr. 18	Fondet Tepricë, Fondet e Mbetura dhe Fondet e përkohshme transferuar Buxhetit të Kosovës	398,233,742
GJITHSEJ PAGESAT NGA LLOGARTË BANKARE TË NSH-ve NË LIKUIDIM			559,674,058

Më poshtë janë detajet e të gjitha kodeve detaje të pagesave të cilat në tabelën më lartë janë përmbledhur sipas numrave rendor

RENDITJA	PËRSHKRIMI	VLERA
1	e2 - Transferim tek punëtorët (BSPK)	34,075,701
	e3 - Transferim tek llogaritë në mirëbesim për punëtorët	9,975,652
2	e4 - Tarifa administrative e agjencisë (5% e shitjeve me likuidim)	11,572,647
	e4a - Tarifa Administrative e Agjencisë (5% e interesit në llogarinë bankare të likuidimit)	371,982
3	e1 - Shpenzimet bankare	37,331
	e6 - Shpenzime për reklamim	764,446
	e7 - Kostoja e shitjes për likuidim të aseteve	101,339
	e8 - Gjëra për zyrë, shpenzime të vogla zyre dhe posta	280,238
	e9 - Magazininim, transportim i dokumenteve të NSh-ve	10,160
4	e11 - Shpenzimet e imta të MBYLLURA - Shpenzime aktuale për kosto të vogla likuidimi	140,396
	e14 - Shpenzime për gjykatë	2,423,799
5	e14a - ekzekutimi i pagesave nga përmbaruesi	4,132,322
	e16 - Ofrues Profesional të Shërbimeve (Autoriteti i Likuidimit)	16,898,688
6	e21 - Shërbime për mirëmbajtje të aseteve	46,795
	e22 - Shërbime për mbrojtje të pronës dhe aseteve	3,906,623
7	e17 - Ofrues të shërbimeve (pagesa bruto)	1,504,397
	e18 - Ofrues të shërbimeve (pagesa neto)	5,717,290
	e25 - Qiraja e paguar (bruto)	299,819
	e26 - Qiraja e paguar (neto pas tatimit mbi qiranë)	35,736
	e20 - Shërbime profesionale	1,042,027
8	e27 - Mallra	192,889
	e29 - Shërbime	856,461
	e30 - Ujë	193,552
	e31 - Rrymë	1,643,917
	e32 - Mbeturina	696,761
9	e33 - Telekomunikacion (Internet, telefon)	51,650
	e24 - Udhëtime zyrtare	64,066
10	e19 - Tatimi në të ardhura personale për OSH	1,081,052
	e34 - Tatimi që mbahet mbi qiranë e paguar	2,995
	e35 - Tatimi i paguar për qiranë e pranuar	88,249
	e36 - Tatimi komunal në pronë	809,717
	e38 - Tatimi i korporatës	484,576
11		
12		
13		
14		

9	e39 - TVSH paguar ATK-së	4,108,561
	e39a - Urdhër-vjelje nga ATK nga llogaritë e likuidimit	49,098
	e41 - Kreditorë të siguruar/e42kërkesat pronësore	389,682
	e43 - Pagat (neto) kreditorë preferencialë 3 paga	3,275,286
	e44 - Tatimi në ardhurat personale (kreditorë preferencialë 3 paga)	111,804
	e45 - Kontribute për pension (për kreditorë preferencialë 3 paga)	324,417
	e46 - Pagesa për ndërprerje të punësimit (neto) kreditorë preferencialë	4,779,215
	e47 - Tatimi në të ardhura personale (pagesa për ndërprerje të punës kreditorë preferencialë)	146,878
	e48 - Kontributi për pension (për pagesë të ndërprerjes së punës për kreditorë preferencialë)	377,868
	e49 - Pagat (neto) kreditorë të pasiguaruar	14,717,219
10	e50 - Tatimi në të ardhura personale (pagat e kreditorëve të pasiguaruar)	1,317,843
	e51 - Kontribute për pension kreditorë të pasiguaruar	3,035,629
	e52 - Kreditorët e pasiguaruar - Huazimet	458,326
	e53 - Avanset e pranuarua në para të gatshme nga NSh-të - kreditorë të pasiguaruar	451,239
	e54 - Furnizues vendorë kreditorë të pasiguaruar	5,013,182
	e55 - Furnizues ndërkombëtarë kreditorë të pasiguaruar	46,760
	e56 - Tatimi në pronë - kreditorë të pasiguaruar	2,411,194
	e57 - Tatimi mbi qiranë kreditorë të pasiguaruar	77,024
	e58 - Tatimi i korporatës kreditorë të pasiguaruar	618,078
	e59 - TVSH kreditorë të pasiguaruar	5,610,812
11	e60 - Tatimi i paragjykuar kreditorë të pasiguaruar	729,812
	e61 - Rryma kreditorë të pasiguaruar	1,566,022
	e62 - Ujë kreditorë të pasiguaruar	2,131,203
	e63 - Mbeturina kreditorë të pasiguaruar	193,495
	e64 - Telekomunikim dhe Internet kreditorë të pasiguaruar	107,804
	e65 - Kreditorë tjerë të pasiguaruar	9,274,851
	e66 - Kërkesa të pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve, partnerëve në NSh	613,741
	e0 - Fondet Tepricë për Qeverinë e Kosovës - neni 19.3.3 i Ligjit të AKP-së	90,244,911
	Fondet e përkohsme transferuar Buxhetit të Kosovës	263,136,201
	e67 - Fondet e mbetura për Qeverinë e Kosovës	44,852,630
12		
13		
14		

XI. LLOJET E LLOGARIVE BANKARE

1. **LLOGARITË E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për të mbajtur të ardhurat e privatizimit/shitjes sipas nenit 8 deri në nënshkrimin e kontratave të shitjes. Pas nënshkrimit të kontratave të shitjes, bëhen këto veprime: pagesat për 20%-in e punëtorëve; transferimi i tarifës administrative (5% e shitjes) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 75% e çmimit të shitjes transferohen në llogarinë e likuidimit.

2. **LLOGARITË E Nsh-ve NË TRANZICION** - Mban paratë e Nsh-ve në mirëbesim në rastet kur Agjencia vendos që Nsh-ja nuk ka resurse për të mbajtur këto para ose kur rrethanat nuk e lejojnë për të vepruar ndryshe për shkak të specifikave të Nsh-ve (rasti i statuseve të pa përcaktuara të Nsh-ve e të ngjashme).

3. **LLOGARITË E LIKUIDIMIT** - Përdoren për Nsh-të pasi që kanë hyrë në likuidim. Të gjitha llogaritë bankare e Nsh-ve mbyllen dhe gjendja e tyre bankare transferohet në këto llogari.

4. **LLOGARITË E KOMERCIALIZIMIT** - Mban shumat e qirave të mbledhura gjatë procesit të komercializimit të Nsh-ve, pra të kontratave të nënshkruara para privatizimit të Nsh-ve dhe ato kontrata të koncesionit ose dhënies me qira që nënshkruhen pas themelimit të Agjencia Kosovare të Privatizimit. Pas përfundimit të kontratës së komercializimit bëhen këto

veprime: transferimi i tarifës administrative (5% e qirave të paguara gjatë komercializimit) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 95% e të ardhurave nga komercializimi transferohen në llogarinë e likuidimit, nëse nuk parashihet ndryshe.

5. **LLOGARITË E PARAVE NË MIRËBESIM PËR PUNËTORËT** - Mban paratë në mirëbesim në emër të punëtorëve që janë transferuar nga llogaritë e privatizimit dhe likuidimit. Këto para janë pjesa e mbetur e 20%-it që iu takon punëtorëve në rastet kur më parë është bërë shpërndarja e parakohshme e 20% e të ardhurave nga shitjet sipas nenit 8 dhe 20% e të ardhurave nga shitja sipas nenit 9 të Ligjit të Agjencisë.

6. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për mbajtjen e depozitave të paguara nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit mbi AKP-në. Kjo është një llogari e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitin e ofertës ofertuesit jo fitues (të pasuksesshëm). Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për Ndërmarrjen e Re që shitet.

7. **TARIFAT PËR TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të

ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.

8. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për shitjet sipas nenit 9 për mbajtjen e depozitave të paguar nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjen e pasurive të NSH-ve që janë në likuidim. Kjo është një llogari bankare e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitën ofertuesit të pasuksesshëm. Depozita e ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për NSH në likuidim.

9. **TARIFAT PËR TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 9 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.

10. **DEPOZITAT E KOMISIONIT TË RISHIKIMIT TË LIKUIDIMIT** - Ka mbajtur depozitat e paguara nga parashtresit për ankesat në procesin e likuidimit të dorëzuara në ish-Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Pas kthimit të depozitave siç parashihet në nenin 24.4 të ligjit të Agjencisë, kjo llogari do të mbyllet.

11. **LLOGARIA E KAPITALIT THEMELTAR** - Mban pagesën në kapital nga Buxheti i Kosovës mbi themelimin e Agjencisë

12. **LLOGARIA E FONDIT REZERVË TË AKP-SË** - Para se të hyjë në fuqi ligji i ri për 5% e tarifës administrative është mbajtur për të përdorur të ardhurat vetanake të AKP-së për depozitat e

konfiskuara nga shitjet e privatizimit, likuidimit, transferimin e tarifave për shitjet përmes privatizimit dhe likuidimit, interesin e fituar në llogaritë e depozitave dhe tarifave për pjesëmarrjen në tenderët e shitjes përmes privatizimit apo likuidimit.

13. **LLOGARI E DONATORIT** - Mban paratë e donatorëve në rastet kur donatorët kërkojnë që paratë e tyre të kanalizohen përmes llogarive bankare të Agjencisë.

14. **LLOGARIA E TARIFËS ADMINISTRATIVE** - Në këtë llogari transferohet tarifa administrative e Agjencisë. Në periudha të ndryshme, Agjencia transferon gjendjen në këtë llogari bankare në llogarinë e specifikuar nga Ministria e Financave për të mbajtur të ardhurat e dedikuara nga tarifatat administrative të Agjencisë.

15. **LLOGARIA E DEPOZITAVE KOHOR** - Janë llogaritë bankare të depozitave kohor në të cilat transferohet mjetet për afatizim për periudha të ndryshme (deri në një vjet). Nëse ka norma të interesit pozitive që oferton BQK-ja, atëherë sipas marrëveshjes AKP afatizon këto mjete në Bankën Qendrore të Kosovës.

16. **LLOGARIA E SHPRONËSIMEVE** – llogari për qëllim të administrimit dhe operimit me pagesa e shpronësimeve nga institucionet relevante. Të gjitha institucionet kanë mundësi që pagesën ta përfundojnë menjëherë pa ndjekur procedurat e Thesarit për regjistrimin si furnitorë të NSH-ve. Mjetet që pranohen në këtë llogari, nga AKP-ja transferohen në llogaritë përkatëse të NSH-ve, prej nga është shpronësuar aseti.

XII. PLANI I VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Raporti është për vitin 2022 për raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të vitit 2020 për fondet në mirëbesim

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
I.	Të hyrat nga shitja	Çështja A1 - Mos respektimi i Afateve për pagesën e detyrimit financiar	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të shtoj kontrollin e brendshëm lidhur me arkëtimin e të hyrave nga shitja e aseteve me negocim direkt si dhe të ndërmerr veprimet e duhura në rastet kur pagesat nuk arkëtohen brenda afateve.	a) Do të dërgohet memorandumi për Bordin e Drejtorëve që të merret autorizimi për shtyrjen e afatit të pagesave për këto raste të vonesave. b) Do të raportohet në baza kuartale në Bordin e Drejtorëve për rregullsinë e pagesave lidhur me shitjet direkte. c) Amandamenti i rregullores ku do të siguroj që palëve të ju ofrohen mundësitë që të përfundojnë pagesat dhe si rrjedhojë mundësohet nënshkrimi i kontratave për bartjen e pronësive gjatë procesit me negocim direkt; si dhe Amandamenti i rregullores ku do të specifikohen të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren për rastet kur edhe pas ofrimit të mundësive/lehtësirave palët nuk hyjnë në negocim direkt.	Njësia e Negocimit Direkt Menaxhmenti	a) 30 shtator 2022 b) në baza tremujore

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
2.	Mallra dhe Shërbime	Çështja A2 - Mangësi në realizimin e pagesave për shërbime	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor, si dhe të respektohen vendimet e bordit dhe kërkesat tjera në realizimin e pagesave.	Në të ardhmen sa i përket përpilimit të planit të pagesave, ato do të planifikohen konform planit të seancave dhe pranimit të shërbimeve. Kjo për arsye se Firma ligjore ka dorëzuar raportin e shërbimeve dhe faturën me vonesë dhe pagesat nga AKP janë bërë brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturës. Arsyeja se përse faturat janë dorëzuar jo sipas planit të pagesave qëndron në atë se dinamika e punës është përcaktuar kryesisht nga seancat e arbitrazhit dhe rrjedhimisht edhe raportet e punës dhe faturat janë dorëzuar pas përfundimit të seancave. Mbajtja e seancave është bërë sipas kufizimeve/masave të Covid-19.	Njësia e Kërkesës për iniciimin e prokurimit (respektivisht menaxherit të kontratës) Departamenti i Prokurimit.	Në vazhdimësi për secilën kontratë të prokurimit
3.	Llogaritë e arkëtueshme	Çështja B1 – Arkëtimi me vonesë i të hyrave nga qiratë	Bordi i Drejtorëve të AKP-së përmes Drejtorit Menaxhues duhet të siguroj që mekanizmat e kontrollit, e monitorojnë dhe i shtojnë kontrollin tek qiramarrësit që vonohen në kryerjen	Janë ndërmarrë veprime shtese ne rritjen e monitorimit në kohë reale, e cila ka filluar te aplikohet nga TM3 i vitit 2022. Do të vazhdohet që qiramarrësit e parregullt të dërgohen te Përmbaruesit Privat. Ndërsa, qiramarrëseve me vonesë	Autoriteti i Likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore – Departamenti i Koordinimit Rajonal të AKP-së dhe Menaxhmenti	Proces, ne vazhdimësi

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
4.	Të hyra nga qiraja		e pagesave të qirasë në mënyrë që arkëtimin i të hyrave të bëhet me kohë.	më dhe që nuk kanë historiat të mirë të pagesave dhe kanë vonesa, konform rregullores nuk do t'iu vazhdohet kontrata.		
4.	Të hyra nga qiraja	Çështja A3 - Ndryshimi i çmimit të qirasë, pa miratim të bordit	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të siguroj se kontrollet e vendosura bazuar në rregullat në fuqi, janë duke u zbatuar. Monitorimi i aktiviteteve të autoritetit të likuidimit të fuqizohet me qëllimin që çdo ndryshim i çmimit të qirasë të përcillet paraprakisht, për miratim të Bordit.	Edhe pse sipas raporteve ky ka qene vetëm një rast si rezultat i një gabimit teknik, andaj e njëjta është adresuar dhe është korrigjuar kontrata pasi që është vërejtur për gabimin e lëshuar. Me nënshkrimin e kontratës, palët janë dakorduar dhe do të paguajnë mjetet shtesë për të kompensuar zbritjen për ata muaj. Në rast të mos pagesave shtesë, atëherë do të ndërmerren veprime konform rregullores për qiradhënie. Po ashtu do të shtohet/sigurohet një mekanizëm që çdo çështje që inicohet/trajtohet nga OSHP – AL të jetë nën vijë të komunikimit dhe informimit me Zyrtarin e Rastit dhe Menaxherin e Zyrës Rajonale të AKP-së.	Autoriteti i Likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore – Departamenti i Koordinimit Rajonal të AKP-së	30 shtator 2022
5.	Mallra dhe Shërbime	Çështja A4 – Dobësi në menaxhimin e OSH-ve		Kjo e gjetur është e zbatuar tashmë. Për të gjithë OSH-të që	Autoriteti i Likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore –	Në vazhdimësi

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
6.	Mallra dhe Shërbime	Çështja A5 - Mos harmonizim i pagave për OSh	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të sigurohet se kostot e angazhimit sipas Rregullores 06/2021 janë duke u zbatuar, duke pas parasysh pagesën e njëjtë për shërbimin e njëjtë, në të kundërt në pamundësi të zbatimit të këtyre çmimeve të gjendet mundësia e përditësimit të kësaj rregullore, duke pas parasysh implikimet financiare dhe ruajtjen e fondeve të	angazhohen do të kontraktohen sipas dateve të aprovimit të angazhimit të OSH-ve dhe asnjë pagesë nuk do të bëhet për periudhën retroaktive duke i përfshirë edhe rastet që janë kërkesa për vazhdim të angazhimit të shërbimeve. Po ashtu, do të ndërmerren masa ndaj të gjithë AL-ve që dorëzojnë memo për vazhdim/angazhim që përfshijnë raste të periudhave retroaktive.	Departamenti i Koordinimit Rajonal të AKP-së	30 shtator 2022
				Do të bëhet amandamentimi i rregullores me të cilin bëhet specifikimi i kategorive të pagave për pagesën e OSh-ve si dhe për pagesën e OSH-ve për NSH-të që kanë aktivitet operativ. Lidhur me këtë, ne kemi argumentuar që pagat e ndërmarrjeve shoqërore që aktivitet operativ të tilla si ABC Genci, Tregu dhe Newco Grand Hotel apo NSH tjera të ngjashme nuk mund të jenë të njëjta me pagesat e OSH-ve që janë të specifikuara në rregulloren për angazhimin e OSH-ve.	Menaxhmenti	

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
			NSh në likuidim.	Pagat e ABC Genci, Tregu dhe Newco Grand Hotel apo NSH të ngjashme janë të ndryshme për shkak se janë ndërmarrje aktive dhe janë paga të trashëguara para se AKP t'i marrë nën administrim.		

- FUND -